DURIM TAÇE
NGUJIMI I PRESIDENTIT

/triller/

Një triller parodi nga realiteti
i sotëm që të fut dridhmat,
pastaj të bën të nënqeshësh hidhur!

Titulli i veprës:
Ngujimi i Presidentit
Copyright © 2008 nga Durim Taçe

Ky libër është një vepër fantazie. Personazhet dhe vendet e përmendura janë trilluar nga autori dhe përdoren prej tij për t'i dhënë vërtetësi rrëfimit. Çdo ngjashmëri me ndodhi, vende dhe persona realë, të gjallë ose të vdekur, është tërësisht e rastësishme.

Botues
Azam Dauti

Durim Taçe

NGUJIMI I PRESIDENTIT

/Triller/

Shkupi
Shkup, 2008

Familjes,
duke i kërkuar ndjesë
për mungesën,
gjatë kohës që shkruaj!

***P**residenti Tufani, është nisur me eskortën e tij të marrë pjesë në një paradë ushtarake të trupave që shkojnë në një mision ndërkombëtar paqeje. Sulmohet në afërsi të aeroportit ku janë rreshtuar ushtarët dhe kthehet mbrapsht në rezidencën e tij. Ishte paralajmëruar me parë dhe tani i komunikohet përfundimisht nga Shërbimi Informativ se nuk mund të dalë nga shtëpia për një periudhë ta pacaktuar dhe duhet të zbatojë të gjitha rregullat që parasheh ngujimi, sipas një kodi të vjetër zakonor që është rizgjuar në vend, kohët e fundit, madje duke marrë tipare edhe më agresive se në të shkuarën.*

I gjithë shteti vihet në alarm, pasi Presidenti pritet të udhëtojë jashtë vendit, pas një jave, që të firmosë anëtarësimin në Aleancën Ndërkombëtare të Mbrojtjes, që është struktura më e fuqishme ndërkombëtare e sigurisë.

Njeriu që ka kërcënuar Presidentin duket se është identifikuar shpejt, por nuk është e lehtë të neutralizohet. Në terren dërgohen Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe fillon ndjekja e tij.

Ngjarja bëhet objekt hetimi edhe për inspektorin e njohur Ilir Martini, i cili fillimisht merr si të mirëqenë versionin më të përhapur, derisa më pas fillon të dyshojë për një komplot ndaj Presidentit. A do të vërtetohet ky komplot? Çdo të ndodhë me Gegë Toskën, njeriun që kërcënoi Presidentin? Çfarë fshihet pas serisë së vrasjeve të njëpasnjëshme në qytezën Sektor?

Ngërthyer me këto hamendje, lexuesi do të pyesë gjatë edhe se kush është në të vërtetë prokurorja Silva Basha, një figurë që na paraqitet herë si viktimë e agresivitetit mashkullor dhe herë si model i gruas që kërkon të zhvillojë feminilitetin e saj.

Pikëpyetje të tilla do të kërkojnë zgjidhje deri në fjalinë e fundit të këtij trilleri, të ngjyer edhe me një kolorit të gjallë shoqëror të aktualitetit.

Prolog

Njeriu që do qëllojë dëgjon të qeshura dhe e bën gati armën.

Zërat gazmorë, në vend që ta ligështojnë, ta prekin, ta bëjnë të ndërrojë mendje dhe të kthehet sërish në shtëpi, ia cingërisin më keq nervat e lodhura nga një natë e tërë pa gjumë.

Në çast, shpërthejnë edhe rrezet e diellit nga maja e kodrës dhe ai ka një si verbim. Lëshon dy breshëri të shkurtra. Rrapëllimat e kallashnikovit i kthehen të mbytura, të shurdhëta, sa mezi i dëgjon, por bindet që ka mbaruar punë kur i shikon trupat që këputen përtokë si zogj.

Shumëkush e kupton që plumbat janë ndalur në mish. Nuk janë krisma në ajër, janë dy batarè të shkurtra e të ndërprera, pa jehonë, të cilat edhe lugina nuk i thith, as i përcjell larg, thjesht i kthen mbrapsht për veshët e njerëzve.

Bëhen njëmbëdhjetë vjet, këtë pranverë, qëkur njerëzit janë armatosur në masë dhe tanimë veshët e tyre janë mësuar të përcaktojnë, nisur nga krismat, llojet e ndryshme të armëve, largësinë nga qëllohet dhe, atë që është më e rëndësishmja, nëse plumbat kanë mundur të

arrijnë në objektiv, zakonisht, duke depërtuar trupa njerëzish.

Dhe kur ndodh një vrasje e këtij lloji, pasojnë ca klithma të lemerishme vaji, aq të kobshme, sa të kaplon një ndjesi se kjo që po ngjan nuk do të përsëritet më kurrë. Por, për fat të keq, vjen një rast i dytë që përgënjeshtron të parin, më i fortë, më i dhimbshëm. Dhe tani çdokush e ka kuptuar, fatalisht, se është i dënuar ta përjetojë këtë mynxyrë përsëri.

Gegë Toska, që sapo ka përcjellë fëmijët e tij për në shkollë, Donikën njëmbëdhjetë dhe Antonin pesëmbëdhjetë vjeç, për herë të parë këtë të premte marsi, pas një ngujimi të gjatë, është bërë gur aty në prag, bashkë me të shoqen Lezen, pa pasur guxim as të lëvizë përpara, as të presë. Po përcillen me mësuesin e fëmijëve gjatë kohës së ngujimit, Çun Matoshin, me të cilin thuajse kanë bashkëjetuar për gati një vit të tërë.

Ai ka ardhur që herët atë mëngjes, të marrë fëmijët dhe t'i shoqërojë deri në shkollë. I ka ndihmuar me duart e veta, dhjetë minuta më parë, të shtrëngojnë rripat e çantave të rënda në supet e tyre të hajthme, duke u frenuar atyre, padashje, dëshirën për të dalë shpejt nga ajo derë.

I ka lënë, pastaj, të ecin vetëm përpara, i dorëzuar nga këmbëngulja e tyre. Tek e fundit, nuk ka më asnjë rrezik, le të shkëmbejë edhe ai disa fjalë me prindërit, që janë çliruar më në fund nga një barrë kaq e rëndë.

Fëmijët, i ka porositur vetëm që të ecin me kujdes, ngadalë, pa kërcime edhe pse, më parë, u ka bërë një gjimnastikë të lehtë në oborr, me shkrydhje gjymtyrësh dhe hapa të ngadaltë.

Druhej se duke vrapuar, do të pësonin ndonjë ndrydhje këmbësh, nga mungesa e gjatë e lëvizjes.

Mësuesi i dëgjoi krismat dhe ia dha vrapit. Me hapa të rëndë e çuditërisht të heshtur, me një dihatje që përcillej larg në luginë dhe me një kërrusje të sforcuar të trupit, të papërgatitur për të bërë përpara, por i shkapërderdhur, në një mungesë të dukshme baraspeshe, ai eci me ankthin se po bënte vendnumëro.

Disa metra, pas një bërryli rruge, ai ka mundur të shikojë gjithçka.

Gega dhe Lezja vazhdojnë të përballojnë një bosh të brendshëm që po i mbledh kruspull. Nuk është e thënë që këto krisma të kenë lidhje me ta. Vetëmse, ajo heshtja pas tyre sikur po zgjatej ca si shumë. Dikush do kishte klithur me kohë.

Tani, duan të vrapojnë dhe ja ku i gjejnë forcat të ngrihen dhe të ecin. Jo me vrap. Me një çapitje të papërgjegjshme.

Sa shikojnë mësuesin, ndalen. Ai u shfaqet tek bërryli i rrugës prej nga vijnë të gjitha haberet për ta: mban fletoret në dorë... Rrezet e para të diellit, që tashmë derdhen nga maja e kodrës, reflektojnë mbi to gjakun...

Po atë çast, në rrjedhën e lumit, ngjitur me rrugën, një siluetë burri grindet me mjegullën e kuqërremtë të mëngjesit për tu hedhur me çdo kusht matanë. Ata e dëgjojnë pllaqurimën e tij nëpër ujë, pastaj hapat në zhavorr, por nuk kanë asnjë shtysë për të kthyer kokën.

1

Një batalion tjetër

Një batalion tjetër me ushtarë ishte rreshtuar në mjediset e zonës ushtarake të aeroportit ndërkombëtar. Banda kishte filluar me kohë marshet dhe tingujt dëgjoheshin deri në zonën civile të aeroportit, përcjellë me zhurmën e avionëve që ngriheshin dhe uleshin.

Pritej vetëm ardhja e Presidentit të vendit, të cilit do t'i paraqitej forca, përpara se trupat të niseshin për në misionin e ri.

Vendi, siç thuhej rëndom edhe në raportet zyrtare, kishte kohë që përcillte siguri për rajonet e nxehta të botës dhe tani e ndante më pak se një javë nga nënshkrimi i anëtarësimit në ANM, Aleanca Ndërkombëtare e Mbrojtjes, organizmi më i fuqishëm i kohës sonë për sigurinë.

Kaluan dhjetë minuta nga koha e caktuar për paradën e rastit dhe befas u dha urdhri për të marrë avionët.

Parada nuk do të bëhej, nuk do të kishte paraqitje force.

Kuadratet filluan të shthuren si sythat e një trikoje, derisa mbi platformën që, më pas u lag nga një rrebesh i papritur marsi, nuk mbeti më këmbë ushtari.

Ata zunë vend në avionët e mëdhenj transportues.

Aty u përcoll lajmi, gojë më gojë, se eskorta e Presidentit ishte sulmuar.

"A është e vërtetë, që kanë sulmuar Presidentin?" pyeti një ushtar shokun e tij përbri.

"Kështu thonë!" u përgjigj ushtari tjetër.

"Po ne ku po shkojmë, atëherë?" pyeti sërish i pari.

"Në front." u përgjigj i dyti.

Informacionet mbi një kërcënim të mundshëm të jetës së presidentit erdhën pak përpara orës 13, kur ai drekonte i qetë me familjen.

Po në atë çast, njëqind e tridhjetë kilometra larg rezidencës presidenciale, sapo kishte mbaruar edhe dreka mortore, pas varrimit të dy fëmijëve të vrarë në Sektor.

I ati i tyre, Gegë Toska, gjer në atë çast i veshur me një kostum të zi, siç e donte rasti solemn, ishte larguar për në dhomën e tij dhe kishte dalë që andej shpejt, i veshur ndryshe, krejt sportiv. Supeve kishte hedhur një çantë shpine, ndërsa në brez, dukshëm, pa këllëf, kishte ngjeshur pistoletën e tij, me leje, i vetmi objekt që gjithkujt i kujtonte karrierën e tij të shkurtër të oficerit.

Informacioni u përcoll menjëherë nga një agjent i Shërbimit Informativ, pjesëmarrës në ceremoninë mortore, i cili shkoi në banjë dhe e transmetoi mesazhin në zyrat përkatëse. Atje u përpunua me kujdes dhe pas dhjetë minutash të tjera, kur Presidenti po pinte kafen, iu komunikua

këshilltarit të tij, kolonel Arben Bardhit, në formën e një sugjerimi të qartë: Presidenti nuk duhej të merrte pjesë në paradën ushtarake për përcjelljen e trupave në misionin paqeruajtës të radhës.

Kolonel Bardhi ndenji gjatë duke biseduar me president Tufanin në tryezën e tij rrethore, aty ku kreu i shtetit pëlqente të organizonte bisedat kokë më kokë, me synimin që gjithkush të ndjehej i barabartë. Kuptohet, që me këshilltarët e tij nuk ruante distancë, aq më pak me kolonel Bardhin, njeriun që e kishte zgjedhur vetë, një eksponent i njohur i reformës në forcat e armatosura.

Përfundimi i bisedës ishte një konkluzion thuajse i njëzëshëm: Presidenti do të merrte pjesë në paradën ushtarake. Ky vendim ishte i formës së prerë. Një vendim krejt i kundërt me atë që i këshillonin shërbimet sekrete.

Shpura presidenciale ishte nisur në orën 16 e 2 minuta, nën masa të rrepta sigurie. Ishin marrë masa për një përforcim shtesë me trupa të Gardës së Republikës, që do t'i shtoheshin forcës së zakonshme të sigurisë.

Gjithçka kishte shkuar për mrekulli, deri në daljen nga autorruga A1, përveç faktit që Presidenti dukej shumë i zymtë.

Sapo kishin hyrë në kthesën rrethore që të fut në rrugën e aeroportit, ishin dëgjuar menjëherë disa të shtëna, të cilat dukej se vazhdonin, duke ndjekur drejtimin e akrepave të orës.

Nga makina presidenciale kishin rënë copëra xhamash. Kish patur një ndalesë të menjëhershme, por shpejt qe marrë vesh se, plumbat kishin thyer vetëm pasqyrat, pa depërtuar dot në xhamat e blinduara të dritareve.

Makina presidenciale kishte vazhduar rrethrrotullimin e saj, duke u rifutur edhe një herë

në autorrugën A1, tani në drejtim të kryeqytetit. Mjetet ushtarake të Gardës e patën përshkuar kthesën ngadalë për të gjetur qitësin e mundshëm, por qenë urdhëruar të mos ndalonin.

Ishte marrë vendimi që të ndiqej makina e Presidentit, pa bërë shumë zhurmë, mundësisht pa asnjë të shtënë, si kundërpërgjigje.

Presidenti qe kthyer në rezidencën e tij dhe nuk i kishte thënë asnjë fjalë gruas dhe dy fëmijëve. Qe mbyllur në zyrën e tij, i zhytur përsëri në leximin e shtypit të ditës, duke kërkuar çdo fjalë të shkruar mbi vrasjen e dy fëmijëve, atje larg në qytezën veriore.

Nuk kish mundur të dëgjonte asgjë nga rrëmuja që kish nisur nëpër korridore. I buçisnin veshët nga krismat. I vinin lëmsh në kokë, të ngatërruara, të shtënat e thata të pistoletës, pak më parë, me breshëritë e kallashnikovit, shoqëruar herë me thyerje pasqyrash dhe herë me rënkime fëmijësh...

Disa minuta më vonë, pat ngritur kokën për herë të parë dhe kishte parë një siluetë burri në dritare. Ishte ngjethur një çast. 'Mos, ky është vërtet fundi', kishte menduar një çast. Tjetri e pat përshëndetur me një mistri në dorë.

Kishte qenë njëri nga muratorët që e patën sjellë t'i mbyllte dritaren.

Kështu, kishin filluar ditët e ngujimit të Presidentit.

2

Takim në një zyrë të Parlamentit

Diku, në një zyrë të Parlamentit të vendit, po organizohej një takim midis këshilltarit të Presidentit për sigurinë, kolonel Arben Bardhi dhe këshilltarit të Kryeministrit, Dr.Pandi Pisha. Merrte pjesë edhe deputeti Nosh Gjetani, anëtar i Komisionit të Sigurisë në Parlament.

Pritej që kolonel Bardhi të njoftonte zyrtarisht mbi sulmin ndaj Presidentit, edhe pse të pranishmit kishin dijeni, në vija të përgjithshme, për sa kishte ndodhur atë pasdite, vetëm tre orë më parë. Sigurisht, gjithçka ishte mbajtur e fshehtë për median, dhe do të bëhej e pamundura që të mos filtronte asnjë lajm, për sa kohë kjo do të gjykohej e nevojshme.

Ishin ulur të tre rreth një tryeze të rrumbullakët, me shishet e ujit plot dhe gotat bosh përpara.

Koloneli hoqi kapelën, e vuri mbi gjunjë dhe u hodhi nga një shikim të shpejtë dy të pranishmëve.

“Nuk kam ende në dorë një raport zyrtar mbi atë që na ndodhi sot tek dalja nga autorruga A1, kur po merrnim drejtimin e aeroportit. Prandaj, kjo që po ju them mund të ngjajë më shumë me një dëshmi.”

Koloneli hetoi fytyrat e bashkëbiseduesve, vlerësoi shkallën e tyre të vëmendjes, pa pretenduar ende ndonjë shenjë reagimi. U kujtua që nuk kishte thënë ende asgjë, çfarë reagimi priste!

“Ishte ora katër e një çerek e pasdites”, vijoi koloneli. “Di vetëm se u qëlluam. Ishin të shtëna pistolete, nga sa kuptova unë. Për fat, pa pasoja. U thyen dy pasqyrat e krahut të limuzinës presidenciale, plumbat nuk depërtuan dot xhamat e mjetit të blinduar.”

Vëmendja e bashkëbiseduesve u mpreh më shumë tani. Frazat e shkurtra, intonacioni i tij, paralajmëronin që koloneli kishte ndërmend të komunikonte diçka tjetër që, me dukej, paskësh më shumë rëndësi se vetë sulmi ndaj eskortës së Presidentit!

“Mbetet për t’u verifikuar e gjitha kjo, madje tanimë nga një perspektivë ende më serioze”, vijon ai.

“Çfarë ka ndodhur tjetër, zoti kolonel Bardhi? A mund të ketë ngjarje më serioze se kjo për një shtet? Sulmohet eskorta e Presidentit, qëllohet makina e tij dhe i kërcënohet direkt jeta”, ndërhyn Dr.Pisha gjithë padurim.

“Pikërisht, më duhet t’u njoftoj se kërcënimi ndaj jetës së tij vazhdon.”

Tani koloneli pati mundësi të vërente shndërrimin e plotë të fytyrave të tyre.

“Ndërkohë që flasim”, vijoi ai, “instancat përkatëse të sigurisë sapo janë njoftuar se,

Presidenti i vendit tanimë është ngujuar brenda rezidencës së tij dhe rrezikon të mos marrë pjesë edhe në nënshkrimin e ANM-së. Ju e dini sa serioze është kjo në planin e interesave shtetërore, kur protokolli parashikon që, pa firmën e tij, anëtarësimi i vendit mund të shtyhet për një datë tjetër. Dhe, hapini veshët mirë. Tani nuk është fjala më për ato artikujt e shtypit, kohët e fundit, ku shkruhet për një ngujim të Presidentit, në mënyrë figurative, ku kritikohet bllokimi i nismave të tij ligjore nga Parlamenti dhe Qeveria. Jo, tani izolimi i tij është real. Shërbimet tona informative njoftuan, një orë më parë, se Presidenti duhet të ngujohet. Ata zotërojnë të dhëna për një kanosje direkte të jetës së tij dhe të familjes."

"Të ngujohet Presidenti? Si ka mundësi?" ndërhyn deputeti Gjetani. "E kush i ka çuar fjalë të ngujohet?"

Deputeti Nosh Gjetani është nga më të informuarit në lidhje me konfliktet që ndodhnin për shkak të gjakmarrjes. Vetë vjen nga një zonë ku kjo dukuri është më e përhapur se gjetiu dhe këtë çështje e ka ngritur disa herë edhe në Kuvend. Ka marrë pjesë edhe në hartimin e një ligji të posaçëm, dy vjet më parë, që, për fat të keq, nuk ka gjetur dot zbatim.

"Shërbimi Informativ njofton se, bllokimi i vajtjes sonë për në aeroport, është marrë si thyerje e rregullave të ngujimit, që sipas tyre qenkësh komunikuar që katër orë më parë. Mirëpo, Presidenti thotë se nuk di t'i ketë çuar fjalë njeri të ngujohet, as nuk mban mend të ketë ndonjë hakmarrje të vjetër në rrethin familjar a në fisin e tij. Për ne, shenja e parë ishin plumbat që ranë mbi makinën presidenciale, derisa na detyruan të ndaleshim. Hollësitë për këtë rast i zotëron

Shërbimi Informativ, por me sa di unë, edhe ata nuk kanë shumë informacion".

"Presidenti duhet liruar me çdo kusht! Është absurde ta mendosh! Ky është një kapitullim i plotë", përplasi grushtin mbi tavolinë, Dr. Pisha, si ata burrat e shtetit që kanë përgjegjësi të mëdha mbi supe.

"Mbase, duhet t'u rikthehemi atyre masave që kemi propozuar me kohë. Duhet të kalohet Paketa Ligjore Antikrim në Parlament. Ajo parasheh edhe krijimin e Forcës së Sigurisë Kombëtare, FSK. Këtu, nuk ka vend për ironi, por është rasti ta themi se, krahas forcës ndërkombëtare, pra ushtarëve tanë që shërbejnë nëpër botë, na duhet të krijojmë edhe një forcë sigurie kombëtare."

"Mos t'i hyjmë edhe një herë këtij diskutimi pa bukë. Kryeministri është kundër atyre propozimeve dhe ju e dini mirë arsyen. Ai nuk do të pranonte kurrsesi që ta paraqesim vendin realisht si në gjendje të jashtëzakonshme, të tërheqim vëmendjen e të huajve në problemet tona të brendshme në këtë fazë kritike të integrimit të vendit në strukturat ndërkombëtare. Vendi është në një situatë normale dhe ne duhet të veprojmë me ligjet që kemi në fuqi!", replikoi Dr.Pisha.

Dëgjohet sinjali i një mesazhi në celular. Deputeti i hedh një sy, kërkon ndjesë dhe ngrihet e del.

"Atëherë, i bie që të presim. Mirë, familjet e ngujuara, janë të detyruara të presin, sipas kësaj logjike. Ja, të presin sa të integrohet vendi. Veçse, e keni lexuar raportin e fundit, besoj, vjen nga ndërkombëtarët, siç e keni qejf ju. Janë 1720 familje në ngujim, prej tyre 870 fëmijë që shkojnë në shkollë. Hajt, po e lëmë për një çast këtë çështje. Po Presidentit si do t'ia bëjmë?"

“Do ta lirojmë me çdo kusht!” vuri dorën në ballë Dr.Pisha.

“Tani ky është një fakt kokëfortë! Të gjithë duhet të reflektojmë.”

Kolonel Bardhi ngrihet nga vendi dhe fillon të rregullojë uniformën.

“Më duhet të largohem tani, që të marr masat e rastit. Presidenti ka dhe dy fëmijë që shkojnë në shkollë. Do edhe tre muaj të mbarojë viti mësimor, se jemi në mes të marsit. Duhet kontaktuar edhe ndonjë mësues i trajnuar për fëmijë në ngujim”.

Këtu ndalon pak dhe nënqesh hidhur.

“Për fat, Qeveria këtë rast e ka parashikuar! Ministria e Arsimit ka plan mësimor për fëmijët në ngujim!”

“Do të ishte mirë të mos kishte fëmijë në ngujim, po përderisa ka, ata do të shkollohen!” replikoi Dr.Pisha.

“Drejt! Ashtu është! Dhe programi duket shumë praktik, sidomos për ata të paktë që kanë në shtëpitë e tyre edhe shërbim interneti. Familja presidenciale, sigurisht, do ta ketë më të lehtë. Mu desh të kontrolloja, pak para se të vija këtu. Sapo ka dalë një Udhëzim i ri për nxënësit e ngujuar, në kuadrin e një programi të fundit, për të cilin ka dhënë para edhe UNICEF-i”.

Kolonel Bardhi zu të kërkojë me sy deputetin Gjetani, që vazhdonte të fliste në telefon në korridor. Përmes derës së hapur, dukej fytyra e tij e shqetësuar. Nuk ishte nevoja të bëhej kureshtar dhe të shkonte për ta pyetur. Deputeti Gjetani ishte bërë mik i familjes presidenciale dhe si i tillë, ishte mjaft i hapur. E la në punën e tij.

“Zoti Gjetani, i di më mirë këto punë. Konsultohuni me të dhe gjeni një zgjidhje!” ngriti zërin koloneli, si për të tërhequr vëmendjen e

deputetit, por ky nuk dëgjonte nga ai vesh. Dukej që ishte me të vërtetë i zënë.

"Dëgjo, kolonel Bardhi. Nuk është rasti të hapim debate tani, aq më pak të ironizojmë. Për ne, për interesat e vendit, çështja më urgjente është të lirohet Presidenti. Më vonë, jam dakord me ju, do parë gjithçka me themel, se kështu nuk mund të vazhdohet"

"Një fjalë goje, të lirojmë presidentin! Po pastaj? Ju prapë do ta mbani të burgosur, siç e keni burgosur deri tani, flas si institucion. Vendi duhet t'i ketë disa shtylla të përhershme. Jo, sa herë që fitohen një palë zgjedhje, ekzekutivi fillon luftën kundër Presidentit. Nuk është kuptuar ende që Presidenti nuk mund të preket, gjykatat nuk mund të preken, prokuroria nuk mund të preket."

"Ju thashë edhe një herë zoti Bardhi, le t'i lëmë debatet tani dhe të veprojmë konkretisht për të zhbllokuar gjendjen", ndërhyn Dr.Pisha.

"Në rregull, ja unë po e filloj me zotin Prekë Prela, kryetarin e Misionit të Pajtimit. Besoj e njihni mirë! Mbase pranon ai vetë, të ndërhyjë. Por më parë, na duhet të gjejmë palën tjetër..."

"Lëre tani zotin Prela!"

Ndërhyrja e Dr.Pishës dukej më nervoze. "Kjo, është çështje e veprimit të organeve të sigurisë!"

"Jo për ndonjë gjë, por kam marrë vesh për një platformë politike të Misionit të Pajtimit. Zoti Prela beson se në një shtet të dobët duhet forcuar Kanuni. E ke dëgjuar se ç'thotë për dënimin me vdekje, e hoqi shteti dhe e mori në dorë Kanuni. Ka ndërmend të paraqitet edhe në zgjedhje si parti politike dhe më duket se, për këtë rast, nuk ka ndonjë pengesë ligjore."

Kolonel Bardhi ngrihet, kërkon me sy deputetin Gjetani dhe si nuk e shikon më as në holl, nga dera gjysmë e hapur, i jep dorën Dr.Pishës.

"Nejse, do të mbetemi në kontakt të ngushtë".

"Domosdo. Ky është një moment delikat që duhet ta përballojmë të gjithë bashkë!" ia kthen Dr.Pisha dhe i shtrëngon dorën fort.

Disa minuta më vonë, deputeti Gjetani hyri në sallë dhe gjeti aty Dr.Pishën, që e priste. Ishte vetë këshilltari i kryeministrit, Dr.Pisha, që i kishte kërkuar ndihmë në një situatë kaq të rëndë. Kishin biseduar bashkë, pak përpara se të vinte koloneli. Ende nuk e dinin që Presidenti ishte ngujuar, por edhe atentati kundër tij kishte mjaftuar që ata të mendonin disa masa sigurie shtesë.

Dr. Pisha e priste edhe për të krijuar një ide të qartë përpara se të shkonte e të raportonte tek kryeministri. Mbase deputeti Gjetani, pas lajmit të ngujimit të Presidentit, ishte tërhequr për të bërë një seri telefonatash, për të vjelë informacionin e duhur.

"Ndonjë të re?" pyeti Dr.Pisha.

"Një helikopter transportues trupash po fluturon drejt Sektorit. Ka në bord një togë të Ndërhyrjes së Shpejtë. Personi është identifikuar, quhet Gegë Toska, 46 vjeç, oficer i liruar nga ushtria në 1997, babai i fëmijëve të vrarë dje, të premten në orën 7 e 35 minuta."

"Ma jep mua telefonin, me kë po bisedoje. Me trupat në bordin e helikopterit?"

"Po, por tani kontakti sapo u ndërpre. Ka shkarkime rrufesh dhe m'u desh ta ndërprisja vetë bisedën, pasi pengohen edhe valët e ndërlidhjes dhe rrezikohet fluturimi" tha deputeti

Gjetani. “Por, mos u merakos, kemi njerëzit tanë atje dhe do të veprohet shpejt.”

“Po, ashtu është. Për fat, Sektori është zona jote elektorale. Ke mundësi të bësh shumë. Dhe dëgjo, Nosh, mos u merr me asgjë tjetër. Nuk ka problem më të madh se ky, tani për tani. Na ka hapur punë, ta dish!”

“Siguroje edhe kryeministrin, që i kemi marrë të gjitha masat! Unë kamë hyrë në kontakt direkt me organet e Ministrisë së Brendshme, por edhe me forcat e policisë vendore. Kemi angazhuar njerëzit më ekspertë. Megjithëse, mbi qëllimin e vërtetë të misionit janë të informuar vetëm pak njerëz, nga ata që drejtojnë operacionin”, vijoi deputeti.

“Në rregull, atëherë. Le të lutemi, vetëm, që të bëjmë një gjumë të qetë sonte!”

Këshilltari i kryeministrit u ngrit, pasi i ra ziles për personelin e shërbimit, që do të vinte të merrte në dorëzim sallën.

“Ah, se desh më doli nga mendja”, u kujtua Dr. Pisha. “Porositini njerëzit atje, të bëjnë kujdes me zbatimin e procedurave ligjore. Unë do t’i telefonoj tani kolonel Bardhit, që edhe ata të Presidencës të mos i lëmë jashtë nga kjo punë, le ta bëjë ai vetë kërkesën për një prokuror që do të ndjekë çështjen. Dhe nëse vendoset me urgjencë, siç e do ky rast, mund të niset që sonte, a nesër në mëngjes. Mbase, duhen hetime paraprake dhe një urdhër arresti për të vepruar. Nejse, kjo është punë e profesionistëve, pastaj, ne bëjmë atë që na takon. Ky është rast shumë i ndërlikuar, i pabesueshëm!”

“Mos u shqetëso doktor, gjithçka do të zgjidhet shumë shpejt, mbase që sonte, pa merak!”

“Mirë, atëherë, mirudëgjofshim!”

Këshilltari i kryeministrit përshëndeti me kokë edhe personin e shërbimit, që ndërkohë kishte ardhur, dhe u largua.

Deputeti, u çapit ngadalë, duke rregulluar çantën, kuletën, paketën e cigareve dhe çikërrima të tjera, deri sa mbërriti tek makina. E kishte zakon ta ngiste vetë veturën e vënë në shërbim nga shteti, aq më tepër fundjavave, edhe pse në organikë kishin edhe shofer. Hapi derën dhe përshëndeti edhe një herë me dorë këshilltarin që i bëri shenjë nga makina. E ndoqi me sy derisa u largua dhe me dorën tjetër kapi celularin, linja funksiononte.

3

Frëngjitë e Presidencës

Në rezidencën presidenciale tensioni ishte rritur. Vazhdohej të luftohej kundër kohës; pas tridhjetë minutash do të errej dhe nata mund të sillte rreziqe.

Vëmendja e të gjithëve ishte përqendruar tek puna e dy muratorëve, që po zvogëlonin dritaret dhe po kullonin në djersë.

I kishin marrë me ngut në rrugë të madhe, ku dilnin çdo ditë për ndonjë punë të rastit. Mund të thuhet, për të qenë më të saktë, se i kishin rrëmbyer. Një makinë ushtarake, e Gardës së Republikës, u pati ndalur tek këmbët. Nga mjeti kishin dalë dy ushtarë, gjithë vrull, dhe i patën shoqëruar për krahu brenda në makinë. Ata qenë frikësuar nga uniformat, në fillim, por edhe pas sqarimit se i kishin marrë vetëm për punë, si muratorë, nuk kishin gjetur dot qetësi. Me keq ndjeheshin tani, që do të mbaronin punën. Çdo të bëhej me ta?

Janë dy, babë e bir, që pyesin me sy njeri-tjetrin, por nuk flasin. I riu duket se ka moshën e

djalit të presidentit, Indritit, rreth të katërmbëdhjetave. I ka ardhur radha, pikërisht, dritares së tij. Por, djali i presidentit bën sikur nuk e vë re që drita po i zvogëlohet, vazhdon të picërrojë sytë në ekran dhe jep e merr me tastierën e kompjuterit, pa lëvizur as për të ndezur dritën elektrike.

Moshatari murator kërkon sytë e tij, se do që t'i flasë. E di që po i bën një shërbim, por e ndjen që puna e tij nuk duket kaq e dëshiruar. Nuk pret që ai ta falënderojë, se kjo duket sheshit, por as nuk është i sigurtë që duhet të kërkojë ndjesë për atë që po bën. Po kryen një shërbim dhe pikë. Ishte tulla e fundit, prandaj i kërkoi sërish sytë e moshatarit, djalit të Presidentit. Ai nuk e ngriti kokën.

Nuk u thirrën muratorë të tjerë. Ata ia dolën mbanë në kohë, pa rënë nata. I zvogëluan të gjitha dritaret e rezidencës presidenciale dhe i kthyen në ca frëngji të ngjashme me ato të kullave të ngujimit. Në fund, dhanë emrat, adresën dhe pas shumës së majme që morën, u porositën që të mos flisnin, qoftë edhe me njerëzit e shtëpisë. Nuk duhet të tregonin se ku kishin qenë dhe se çfarë kishin bërë atë ditë. Vetëm kaq.

Nuk do të merrnin mësues ngujimi për fëmijët. Atë mbrëmje, shkarkuan nga interneti materialet e nevojshme didaktike, duke hyrë në sitin e Ministrisë së Arsimit.

Vetë Zonja e Parë, Tefta Tufani, mësuese në profesion, kishte dhënë mësim, deri tre vjet të shkuara, përpara se i shoqi të bëhej president, krahas veprimtarisë si aktiviste partie. Ajo do t'i kthehej me dëshirë mësimdhënies, edhe pse nuk e kishte menduar kurrë që kjo do të ndodhte në

rrethana të tilla. Kalimi nga mësuese në Zonjë e Parë nuk kishte qenë i lehtë. Ana formale e pritjeve e takimeve, ecja krah për krah me burrin, sa herë që e kërkonte protokolli, në fillim një sfidë për t'u ambientuar, me kohë ishte shndërruar në një veprimtari prej automati, aq sa ndikonte edhe në jetën bashkëshortore. E kishte marrë malli t'i bërtiste të shoqit, me sa kishte në kokë, të shante kalamajtë e saj. Gjithçka e mbante përbrenda. Tani, kur kjo krizë e përshtatjes kishte kaluar, një situatë e re, më e rëndë, do të krijohej me ngujimin. Mbase do të flinin me ushtar tek koka e krevatit.

Vitet e fundit, ajo ishte marrë vetëm me veprimtari bamirëse. Ia kishin sugjeruar si modë, se kështu bënin Zonjat e Para, por shpejt Tefta filloi ta kuptojë rëndësinë që kanë të fuqishmit për të zgjidhur probleme. Dhe ajo, tanimë ishte bërë e ndërgjegjshme se i përkiste kastës së të fuqishmëve dhe duhet ta luante rolin e saj sa më mirë. Pika e saj e dobët, do të ishin sigurisht fëmijët, arsimimi i tyre, prandaj kishte ndihmuar edhe në ndërtimin, në një zonë të fshehtë, të një shtëpie për fëmijët e mbetur jetimë ose të kërcënuar nga gjakmarrja.

Të nesërmen do të ishte mëngjesi i parë që do ta kalonte e izoluar dhe u kujtua të fshinte nga ditari të gjitha takimet për një kohë të pacaktuar.

Telefonata e parë i erdhi nga Prekë Prela, kryetar i Misionit të Pajtimit, i cili ishte njoftuar ndër të parët për atë që u kishte ndodhur. Vitet e fundit, ai kishte bashkëpunuar ngushtë me familjen presidenciale për pajtimin e gjaqeve. Tefta e shikonte si njeri babaxhan, edhe pse, herë pas here, ai lëshonte ca ide të çuditshme, që sigurisht ajo nuk ia mbështeste, por edhe nuk u vinte

shumë rëndësi, as ajo si Zonjë e Parë dhe as të tjerët. E kalonin të gjithë me një nënqeshje dhe kaq.

Preka nuk shprehu ndonjë çudi për sa kishte ndodhur, mbase ngaqë për të, këto situata janë të zakonshme. Kjo i duket bota e tij. Vetëmse, i tërhoqi vëmendjen, që në ngujim duhej të rrinte Presidenti, i shoqi, si edhe djali, pasi sipas kanunit ai mund të konsiderohej i rritur, i aftë për pushkë, ndërsa Tefta vetë dhe vajza e saj njëmbëdhjetë vjeçare mund të dilnin lirisht, ajo në statusin e gruas, ndërsa vajza në një status të dyfishtë, grua dhe fëmijë.

"Dëgjo" i tha duke e mbyllur Preka, "Hap më mirë Kanunin dhe lexo nenet 835 dhe 836, aty thuhet *"Prita do të fillojë pushkën mbë burra e jo mbë gra, fmi a mbë bagti"* Ju bagëti nuk keni!"

"Jo, bagëti nuk kemi!"

Tefta po sillej nëpër dhomë me telefonin e lëvizshëm dhe pa e kuptuar kishte hyrë në dhomën e të shoqit, Zamirit. Ky i bëri me shenjë se ishte i zënë, në rast se do të donin të flisin me të në telefon. Më në fund, Tefta e shtypi butonin e kuq të receptorit dhe iu afrua.

"Janë siguruar kalamajtë?"

"Po, mos ki merak, vetëm se duhen trajnuar ca ditë, sa të mësohen."

Hezitoi pak, se bëhej fjalë për një dallim midis saj dhe vajzës, nga njëra anë dhe burrit e djalit, nga ana tjetër, por aty për aty, vendosi t'ia përcillte atë që i kishte thënë Prekë Prela në telefon.

"Kemi ndonjë botim të Kanunit në shtëpi, neve?" e pyeti si fillim Tefta.

"Nuk thuhet gjë në Kanun. Aktet normative diskutohen në Kuvendet e Maleve. Aty përfshihen

vetëm nenet themelore" ia ktheu me ngut Presidenti, a thua se e dinte se çfarë do t'i thoshte e shoqja.

"Ah, Kanunin paske në dorë! Pa hape një çikë tek neni 835 dhe 836, se më tha Preka që unë me vajzën mund të dalim lirisht, nuk duhet të rrimë në ngujim"

"I kam lexuar, ashtu thuhet, por nuk e shikon ti se çfarë bëhet. A e more vesh se çfarë ka ndodhur dje. Kanë qëlluar mbi fëmijët që shkonin në shkollë!"

Biseda e tyre u ndërpre se hyri vajza, Vesa. Asaj nuk i kishin treguar asgjë, ndryshe nga Indriti, por kjo nuk mund të zgjaste shumë, se pas dy ditësh do t'u duhej t'i shpjegonin, të paktën, se përse nuk do ta linin të shkonte në shkollë. Mirë që ishte e shtunë dhe kishin, për fat, ende, edhe të dielën përpara.

Ra telefoni sërish. Presidenti përplasi dorën mbi tavolinë i nervozuar. "Nuk dua asnjë telefonatë. Më thirrni gjithë stafin këtu. Asnjë telefonatë në familje".

"Është Arbeni, sapo ka mbaruar takimin me këshilltarin e kryeministrit".

"Mirë, ma jep. Po ku e gjeti ky të flasë me linjën publike. Duhen rregulluar ndryshe këto punë, tani e tutje. Le që nuk varet më asgjë prej nesh!".

4

Hetim i pazakontë

Inspektori i Drejtorisë së Përgjithshme të Krimeve, Ilir Martini, u kontaktua vetëm ditën e hënë. Telefonata e parë i erdhi tek po rruhej, përpara pasqyrës. Ndjeu një dridhje në xhepin e djathtë ku mbante celularin. Priste ndonjë telefonatë personale, siç ndodhte rëndom në këtë numër. Zakonisht, e merrte e ëma, i kërkonte llogari se përse nuk ishte bërë i gjallë në fundjavë, ndërsa Mira nuk i telefononte më prej gjashtë muajsh dhe marrëdhënia me të mund të quhej e mbyllur këtë radhë. Ajo kishte kërkuar edhe transferim nga Seksioni i Krimeve dhe, e ndihmuar nga emri i mirë që kishte lënë vetë si studente, ndërkohë, kishte filluar të jepte mësim në Akademinë e Lartë të Policisë, me shpresë që të kalonte më vonë si pedagoge e brendshme, mbase që vitin e ardhshëm.

Ky i tanishmi, ishte një zë i ftohtë, zyrtar, që pasi u sigurua mirë që kishte të bënte me inspektorin, i tha:

“Më falni, për këtë thirrje nga celulari, por jemi të detyruar, për fat të keq, zoti Martini. Nuk mund të prisnim, qoftë edhe dy orë të tjera, orarin zyrtar.”

“Nuk ka problem! Me kë kam nderin të flas?”

“Unë jam Pandi Pisha, këshilltar i kryeministrit.”

“Po ju dëgjoj.”

“Jo, parapëlqej të lëmë një takim, kokë më kokë.”

Vendosën të takoheshin në bar “Artisti”, i veçuar, në një mjedis të hapur, i cili kundërmonte nga era e luleve të porsaçelura.

Dr.Pisha kishte ardhur më shpejt dhe kishte zënë një tavolinë nga fundi. Sapo e pa të kalonte portën e drunjtë, e ngjashme me ato deriçkat e lokaleve me sherifë në Perëndimin e Largët, Dr.Pisha u ngrit nga vendi dhe ia bëri me dorë. Kështu e kishin lënë, se inspektor Iliri nuk e njihte.

“Ke dëgjuar besoj, për çështjen e fëmijëve të vrarë në Sektor. Kanë shkruar të gjitha gazetat”, e hapi bisedën këshilltari i kryeministrit, pas prezantimit të rastit.

Iliri pohoi me kokë.

“Është një çështje delikate, tragjike dhe sigurisht që kërkon refleksione të thella nga të gjithë. Janë paralajmëruar edhe protesta të shoqërisë civile në disa qytete. Por, kjo është vetëm njëra anë e medaljes. Çështja nuk është zbardhur ende plotësisht, por duket një rast klasik i gjakmarrjes. Babai i fëmijëve ka reaguar, ka vrarë gjakësin dhe ndërmjetësin për pajtim, të nesërmen në mbrëmje, pas varrimit. Ne dërguam trupa të Ndërhyrjes së Shpejtë për kapjen e këtij vrasësi.”

“Përse nuk ka polici në Sektor?” pyeti Iliri. “Nuk shoh ndonjë motiv për dërgimin e forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë.”

“E kemi një motiv dhe shumë serioz. Gegë Toska, babai i fëmijëve të vrarë, ka sulmuar po atë ditë eskortën e Presidentit, duke e mbyllur brenda në rezidencë, praktikisht. Sigurisht, ngujimi i Presidentit u ndërmor më pas si masë sigurie, pas sugjerimit të organeve të Shërbimit Informativ.”

“Këtu, i kërkohet Presidentit të veprojë, me sa shoh! Duket diçka simbolike”, e ndërpreu Iliri.

“Nuk ka kurrfarë simbolike këtu. Presidenti është sulmuar me armë!”

Inspektor Ilir Martini vetëm tani filloi të gjerbte kafenë.

“Duhet të nisesh sa më parë! Duhet gjetur me çdo kusht Gegë Toska. Deri të premten Presidenti duhet liruar, duhet të udhëtojë jashtë shtetit për të nënshkruar ANM-në. Do të ishte një dështim total, nëse udhëtimi i tij nuk do të kryhej, në një ditë do të hidheshin në erë gati njëzetë vjet përpjekje të politikës për t’u integruar në këtë organizëm jetik për një vend të vogël si i yni.”

“Të nisem për në Sektor dhe të kap Gegë Toskën!”

“Po, duhet të nisesh sa më parë. Kam kontaktuar unë me shefat tuaj. Atje do të gjesh edhe njerëz të tjerë. Nuk është çështja e arrestimit të një njeriu. Kështu e menduam ne në fillim, por me sa duket kemi të bëjmë me një problem shumë më të ndërlikuar, përderisa kanosësi i Presidentit, Gegë Toska, nuk bie lehtë në pranga. Frika është se çështja mund të përgjithësohet, shumë të tjerë të krisur, si ky, mund të veprojnë njësoj. Nuk duhet të filtrojë asnjë informacion mbi ngujimin e Presidentit.”

“Dakord, po nisem sa më parë! Të shikojmë se çfarë mund të bëhet! Unë do të përpiqem të hetoj mbi çështjen, se kjo është në mundësinë time”

“Jam i informuar plotësisht mbi mundësitë tuaja, zoti Martini. Veproni, keni mbështetjen tonë të plotë!”

Pas një shtrëngimi të fortë duarsh, ata u ndanë. Këshilltari i la edhe një material të shkruar me informacione të nevojshme. Inspektor Ilir Martini, dukej sikur përpiqej të zgjohej nga ëndrra e fundit e mëngjesit të ditës së hënë. Kundroi makinën e këshilltarit që u largua dhe ul në ndenjësen e xhipit të vjetër, pa ditur se ku do të shkonte.

Pati edhe një telefonatë tjetër, të vonuar, siç do ta gjykojë ditë më pas, i pavendosur nëse vonesa e saj kishte qenë e qëllimshme, apo e pashmangshme.

Tani e kërkonte këshilltari i Presidentit, që ishte edhe mik i tij i vjetër, kolonel Arben Bardhi, me të cilin njihej gjatë kohës kur shërbente në policinë ushtarake. Ai ishte një oficer karriere, që kishte shërbyer nëpër misionet tona ushtarake jashtë vendit dhe Iliri vazhdonte të ishte ende i habitur, si në çastin e parë që e kishte marrë vesh, se si një ushtarak i tillë karriere pranonte të merrte papritur rolin e këshilltarit të Presidentit. Mbase këtu fshihej diçka. Sepse, siç dukej, gjithçka kishte filluar në atë moment kur në Kuvend ishte kërkuar një zgjidhje me konsensus të gjerë për Presidentin. Dhe kandidatura e kolonelit ishte e para e propozuar për President, duke e futur kështu në këtë valle. Por, shumica në parlament kishte ngulmuar që ta kishte presidentin nga radhët e veta dhe kështu qe vendosur. Vetëmse, vetë presidenti Tufani, që do të zgjidhej më vonë,

duke i njohur meritat e ushtarakut Bardhi, kërkoi që ta kishte në stafin e vet, i bindur që do të bënte shumë për integrimin e vendit në strukturat ushtarake ndërkombëtare dhe në forcimin e sigurisë së brendshme.

Nuk kishte dalë ende nga rrugët e kryeqytetit. Vazhdonte të ecte kuturu, pa marrë ende asnjë vendim. Siç kishin rrjedhur ngjarjet, inspektor Iliri, me të drejtë, zu të shqetësohej më shumë për metakomunikimin, modalitetet, duke mos i dhënë më asnjë rëndësi vetë informacionit.

Ajo që pat dëgjuar, të përsëritur dy herë nga personalitete të ndryshme, këtë mëngjes, nuk mund ta mohonte, ishte gjëja më e pabesueshme që i kishin zënë veshët që prej dhjetë vjetësh kur pat filluar karrierën e tij si inspektor krimesh. Dhe, në një pikëshikim tjetër, po ta gjykonte me qetësi, mund edhe ta klasifikonte, për lehtësi metode, si punë rutinë, si një çështje të radhës për t'u zgjidhur. Thjesht, dikush kërcënon dikë, vetëm se në këtë rast është kërcënuar Presidenti i vendit. I ka ardhur radha atij të ngujohet brenda katër mureve dhe ai, si inspektor, ishte thirrur jo vetëm të hetonte, por edhe të vepronte, nisur nga natyra e veçantë e kësaj çështjeje.

Për një hetim, koha gjithmonë është problemi numër një. Është pikërisht mungesa e kohës së mjaftueshme që, zakonisht, të detyron të ecësh, para së gjithash, me intuitë, pastaj të analizosh faktet shpejt dhe të nuhatësh rrugën e vetme nga duhet të lëvizësh. Zgjidhja kur vjen, shfaqet si diçka shumë e thjeshtë, që e ke pasur gjithmonë afër, e shoqëruar edhe me iluzionin se i paske rënë gjatë, duke humbur shumë kohë.

Mirëpo, ky ishte hetimi i parë që i kërkohej brenda një kohe të përcaktuar prerë. Në harkun e pesë ditëve, që nga e hëna në të premte, presidenti duhej liruar me doemos, për të marrë avionin në udhëtimin e tij të paralajmëruar me bujë, si firmëtar i anëtarësimit të vendit në ANM. Nëse kërcënuesi nuk do të kapej, atëherë do të merreshin masa të rrepta sigurie dhe udhëtimi i tij, mbase, do të kryhej megjithatë. Por kjo do të varej edhe nga vullneti i Presidentit. A do të pranonte ai të dilte nga ngujimi pa u zgjidhur çështja. Do t'i linte fëmijët e tij të shkonin në shkollë, mbase të shoqëruar vend më vend me ushtarë të Gardës?

Befas, zu të reflektonte se sa çështje të tilla ndodhin në vend brenda ditës, sa njerëz kanosnin, sa kërcënonin dhe trazonin jetën e të tjerëve, për motive nga më të ndryshmet. Çështje që, zakonisht nuk hetoheshin fare. Kjo, edhe për faktin se, qytetarët që viheshin nën kërcënime të tilla, nuk bënin kallëzim në organet përkatëse, ndryshe nga Presidenti.

Hapi krahun dhe ndali makinën. Siç dukej, sapo i kishte lindur një ide.

Zu të lexonte me kujdes materialin e ofruar nga Dr.Pisha. Ngjarjet ishin rrokullisur shpejt që pas vrasjes së fëmijëve në Sektor, mëngjesin e ditës së premte. Të nesërmen, menjëherë pas varrimit, Gegë Toska kishte marrë arratinë. Ngujimi kishte marrë fund për të, edhe pse tragjikisht, dhe ai mund të shkonte ku të donte, tek e fundit, pavarësisht se jeta e tij ishte njësoj në rrezik si më parë. Po ndodhte rëndom, kohët e fundit, që prishej radha e gjakmarrjes, ata që të kishin borxh të vrisnin përpara se t'i vrisje. Ngjashëm kishte ndodhur edhe me një tregtar të zonës që kishte

dhënë para hua. E kishin vrarë për të mos i kthyer paratë. Kjo, edhe mund të justifikonte, në një masë të madhe, faktin që ai kishte dalë nga shtëpia i armatosur. Kishte ngjeshur në brez armën e tij, një pistoletë TB, me leje, si të vetmin privilegj që gëzonte që prej lënies së karrierës së oficerit.

Po atë ditë, pasditen e së shtunës, në orën 16 e 21 minuta, në kryeqytet ishte sulmuar eskorta e Presidentit. Plumbat kishin thyer pasqyrat e limuzinës së blinduar presidenciale. Dhe, për fat, ai objektiv nuk mund të konsiderohej thembra e Akilit. Pasqyrat ishin vërtet e vetmja pjesë e cënueshme e makinës së tij të sigurtë, por që nuk sillte sigurisht asnjë rrezik për jetën e personave që udhëtonin në të. Dukej sheshazi, që qitësi kishte synuar shoferin dhe Presidentin. Mbase pas kësaj, presidenti, më në fund, do të detyrohej të ndryshonte atë zakonin e tij për t'u ulur në vendin e parë. Plumbat kishin bërë rikoshet në xhamat e padepërtueshëm dhe kishin dërrmuar pasqyrat.

Shërbimi Informativ pat njoftuar, disa orë më parë, gjatë varrimit të fëmijëve, se presidenti ishte kërcënuar.

Gegë Toska edhe gjatë varrimit, por edhe përpara se të dilte nga shtëpia, ishte dëgjuar të thoshte, si nëpër dhëmbë, *'Po shkoj tek Presidenti!'* pa iu drejtuar askujt. Një agjent i fshehtë, pjesëmarrës në varrim, e kishte përcjellë këtë fakt tek organet përkatëse dhe këto kishin rekomanduar marrjen e masave të jashtëzakonshme të sigurisë për Presidentin.

Dhe, po atë pasdite, zhvillohej parada përcjellëse e trupave ushtarake për misionin ndërkombëtar të radhës, ku Presidenti duhet të ishte i pranishëm.

Siç duket, atentatori e kishte shfrytëzuar pikërisht këtë rast, duke qenë i informuar publikisht nga media për praninë e Presidentit në këtë aktivitet. Mendohej që sulmi ndaj Presidentit ishte kryer me një pistoletë TB, njësoj si ajo që kishte vënë në brez Gegë Toska përpara se të largohej, edhe pse ende nuk ishin depozituar prova materiale që ta vërtetonin këtë, si gëzhoja, apo plumba. Pastaj, me sa dinte inspektori, këta fishekë mund të përdoreshin, po ashtu, edhe nga një seri armësh të tjera, midis tyre edhe nga disa automatikë të shkurtër të prodhimit vendas. Fakti se nga çfarë arme kanë dalë plumbat, mund ta sqarohej thjesht nga një analizë e rëndomtë balistike. Por më parë duheshin gjetur gëzhojat, të paktën.

Dhe sulmi ndodh plot katër orë pas largimit të Gegës nga shtëpia, kohë e mjaftueshme për të përshkuar njëqind e tridhjetë kilometra nga Sektori deri në kryeqytet.

Këto fakte ishin sigurisht një shtysë për inspektor Ilir Martinin, por nuk mund të shpjegonin shumëçka. Shteti nuk kishte kohë, e donte Presidentin të lirë brenda mëngjesit të ditës së premte, kurse për të, hetimi nuk kushtëzohej dot nga koha.

Në mbrëmje, katër orë të tjera më vonë, pas orës tetë, në qytezën e Sektorit ishin dëgjuar të shtëna të tjera pistolete. Dhe ishin gjendur të vrarë misionari i paqes, Palokë Lleshi, banor i zonës, dhe vetë dorërasi i dyshuar i fëmijëve, Nikë Camaj, hasmi i Gegë Toskës, i dergjur në një pellg gjaku në shkallët e brendshme të shtëpisë së tij.

Sërish, mund të thuhej se Gegë Toska ka pasur kohë të kthehej nga kryeqyteti në Sektor për të kryer krimin, po të kihet parasysh edhe autorruga

e re e vënë në funksionim kohët e fundit, me të cilën, e shumta, mund ta përshkosh për një orë e gjysmë distancën prej njëqind e tridhjetë kilometrash. Ka menduar të lajë hesapet në fillim me Presidentin, pastaj është kthyer dhe ka mbaruar punë me shkaktarët direkt të tragjedisë së tij.

Vendosi të kthehej dhe të shkonte drejt e tek zyrat e Misionit të Pajtimit. Iu desh pak kohë sa t'i gjente, pasi e kishte vështirë të pyeste qytetarët, nuk arrinte të formulonte dot pyetjen, "*Ku janë Zyrat e Misionit të Pajtimit?* Sapo pa një tabelë të shkruar, kjo iu duk disi më e natyrshme.

Tek i binte ziles dhe priste, habitej me veten, përse vazhdonte ta kishte mendjen tek telefonata e këshilltarit të Presidentit, kolonel Arben Bardhit. Mbase, ngaqë ai nuk kishte formuluar asnjë kërkesë të qartë për të, në ndryshim nga këshilltari i kryeministrit.

Tek dera u shfaq një zonjushë e re, e veshur shik që e shoqëroi për tek zyra e Prek Prelës, kryetarit të Misionit të Pajtimit.

Luksi binte në kontrast me vetë natyrën e misionit. Inspektori zuri vend përballë dhe duart i shkuan tek një botim i ri i ngjashëm me Biblën, në format të vogël.

"Është "Kanuni i Ri i Maleve", pas Kuvendit Kombëtar, iu bë një rishikim kanunit të vjetër nga një grup ekspertësh ligjorë. Mjaft kapituj kishin nevojë për rinovim" u përpoq t'i shpjegonte gjithë pasion kryemisionari.

"Interesante!" tha inspektori shkurt, që ta ndërpriste. Mirëpo, kryemisionari mori zemër dhe tani nxori nga sirtari edhe një revistë.

"Kjo është revista që botojmë ne. Shiko këtu, çfarë zgjidhje e përsosur! Këto janë shtëpi të

projektuara nga arkitektët tanë. Është parashikuar gjithçka, edhe ngujimi sigurisht. Siguria në plan të parë, por jo vetëm nga tërmetet! Shiko dritaret, muret e larta... Dhe nuk janë vetëm në letër! Ne kemi ndërtuar edhe një lagje këtu në periferi të kryeqytetit. Ne, nuk duam që ngujimet të ndodhin, por duhet të jemi të përgatitur. Njësoj si shteti, me programet për fëmijët e ngujuar, me mësuesit e trajnuar".

Inspektori e merr për një çast, për një të lajthitur, por ndjen që mbushet me një pezëm që, nga çasti në çast, mund t'i shpërthejë.

"Më falni se ju ndërpres, por jam pak me ngut. I thoni asaj vajzës, të më kopjojë të gjitha të dhënat që keni në kompjuter mbi misionarë, kanosje, ngujime, gjaqe, vrasje, të gjitha sa keni!"

"Ngadalë, zoti inspektor, pak më konkret, do të ishte më e udhës, se edhe ne pastaj dimë se çfarë të kërkojmë. Se, ne i kemi 721 misionarë të shpërndarë në të gjithë vendin"

"Të gjitha sa keni, shpejt! Jeni të detyruar përpara ligjit të jepni informacione të tilla, përndryshe do t'u plas brenda. Ç'domethënë pajtim sipas jush? Kush është ai shtet që ju pret ju derisa të pajtoheni?! Kriminelëve i luteni ju? Kush ju ka autorizuar ta bëni këtë?"

Inspektori e kuptoi që po e humbiste toruan. E mori revistën dhe e flaku në dysheme, pastaj rrëzoi një pirg me botime të kanunit.

"Ne jemi një OJQ e krijuar brenda të gjitha ligjeve në fuqi, zoti inspektor", ndërhyri kryemisionari.

"Dakord, por tani bëj si të thashë dhe shpejt, se nuk kam kohë!"

"Nuk kam asgjë për Presidentin, për atë mundohesh kot! E kam edhe mik! Më kanë

kërkuar edhe të ndërhyj për pajtim, por, besoj e keni marrë vesh, kjo është çështje pak delikate. Edhe misionarin tonë në Sektor, Palokën e shkretë na e kanë vrarë"

"Palokë Lleshin?!

"E njihni, zoti inspektor?"

"E njoh shumë më pak se ju, besoj! Çfarë mund të shtoni ndonjë gjë për të?"

"Ka qenë shumë i përkushtuar. Ka zgjidhur shumë raste ngatërresash, me pajtime të palëve. Ka ranë në krye të detyrës."

"Në rregull, kaq mjafton", ironizoi inspektori. "Tani bëni si ju thashë, që të dy, ose po ju sjell unë ndihmë atëherë!"

Inspektori thirri në radio grupin e gatshëm. "Merrni edhe një kamioncinë", përfundoi.

Kryemisionari, atëherë i bëri zë Gretës, kështu quhej sekretarja, që t'i vihej punës për të furnizuar me të dhëna inspektorin.

Megjithatë, një çerek ore më vonë, kompjuterët e Misionit të Pajtimit u ngarkuan në një kamioncinë, bashkë me krejt dosjet dhe kartelat që u gjendën në të gjitha zyrat e godinës.

Prekë Prela, protestoi deri kur u dëgjua uturima e fundit e kamionit të vogël që u largua me një shtëllungë të bardhë tymi, ndërsa ishte asistentja e tij, shumë e frikësuar, që u përpoq ta përmbajë.

5

Një vrasje tjetër

Përpara se të merrte autorrugën A2 drejt Sektorit, inspektori harxhoi edhe dy orë të tjera, atë të hënë.

Nuk iu ndejt pa kontrolluar më parë materialin, edhe pse jo shumë imtësisht. Më shumë qe marrë me shtypjen në letër të disa listave të gjata me emra, shoqëruar me komente ngjarjesh. Gjeti edhe shumë informacione me vlerën e fakteve, pasi përmbanin data dhe vende të sakta, për të gjitha krahinat e vendit, ashtu siç kishte shpresuar inspektori.

Si mbushi me to tre kartela, filloi të përzgjidhte materiale për një kartelë të veçantë, që kishte të bënte veçmas me rajonin e Sektorit.

I çoi, më pas, dosjet në makinë dhe deshi të nisej, më në fund. Mirë që u kujtua në kohë të bënte edhe një telefonatë me oficerin roje të postës së policisë në Sektor. Lajmëroi vajtjen e tij dhe la një takim me postëkomandantin Kin Uldeda.

Kishte lënë autorrugën A1 dhe kishte marrë A2-in, prej më shumë se pesë minuta, i habitur me një fakt të rëndomtë. Zakonisht, pas ndërtimit të rrugëve të reja, buisnin menjëherë anash tyre ndërtime pa kriter, pika shërbimi, motele e karburante, shtesë, përveç atyre që mund të ishin planifikuar që në projekt. Ndërsa kjo rrugë kishte mbetur ende e paprekur. Nuk ishin ndërtuar ende as objektet e parashikuara në projektin fillestar, me sa duket. Konflikte pronësie, kush e merr vesh. Në një lëvizje të mundshme, duhej mbushur makina mirë me karburant. Ai u kujtua dhe pa shenjën e karburantit në makinën e tij. Vuri duart në kokë, pas pak do t'i ndizej llamba. Ku shkonte ai symbyllur.

U kthye përsëri në A1, në daljen e parë, pranë një qyteze universitare. Mbushi makinën plot dhe kur ishte gati të nisej, i shkrepi edhe një mendim tjetër. Nuk doli menjëherë nga autorruga A1, vazhdoi përpara deri tej dalja për në aeroportin ushtarak. Bëri kthesën rrethore që të ngjiste lart në rrugën e aeroportit, duke përfytyruar atentatin e dështuar ndaj Presidentit.

Më shumë përpiqej të merrte me mend pozicionin e atentatorit, i cili kishte shtënë të paktën dy herë, në dy gjysmërrotullimet e detyruara të presidentit.

Bëri edhe nja dyqind metra në makinë, deri sa gjeti një shesh qëndrimi, djathtas, ku parkoi. U kthye mbrapsht me vrap, mbërriti në vendin e atentatit dhe filloi të kërkojë me kokën poshtë, duke ecur anash, pranë rrethimit metalik.

Makinat që vinin përballë tij u binin borive, por ai vazhdonte të kërkonte, derisa vrapoi si ai fëmija në mes të rrugës, që shkon të marrë topin. Në rrezet e diellit shkëlqeu diçka metalike. Ishte një

gëzhojë fisheku. E mori, e futi në xhep dhe u kthye tek makina.

Çudi, pozicioni në të cilën e kishte gjetur gëzhojën, iu duk një zgjedhje e vështirë për kryerjen e një atentati, në një vend krejt të zbuluar, fare pranë objektivit. E megjithatë, atentatori nuk ishte vënë re, do të jetë maskuar me sa ka pasur mundësi pas hekurave, deri në kalimin e plotë të karvanit të automjeteve. Nejse, sidoqoftë ishte i kënaqur se, më në fund, e kishte në dorë një provë.

Plot një orë e gjysmë. Kaq ishte koha më normale e përshkimit të 130 kilometrave të një rruge në standarte të tilla. Dhe ishte kjo e vetmja gjë me vlerë që konstatoi gjatë përshkimit të autorrugës A2 deri në Sektor. Në fakt, ai u përpoq të gjente diçka të veçantë, që do t'i bënte përshtypje, siç mund të ishte ndonjë makinë e braktisur anës rrugës.

I bëri sytë katër, edhe tani kur po i afrohej daljes për në qytezë, por nuk vuri re asgjë të dyshimtë.

Vajtja e inspektor Ilirit në Sektor, ishte paraprirë nga një vrasje tjetër, dhjetë minuta përpara se ai të mbërrinte në postën e policisë.

Ai e pa një trup të lagur, të vënë mbi një vig të thjeshtë që e tërhiqnin katër burra. 'Ndonjë vrasje tjetër për motive gjakmarrje', mendoi, kur pa viktimën, një mesoburrë i veshur me një kostum shik, që i lagur, dukej pis i zi.

Ndërtesa ishte një karabinà e vjetër guri, jo larg daljes nga autorruga, e tipit alpin, e mbuluar me frugja, si shtëpitë e malësorëve, pasi materiali i tyre i lehtë dhe i fortë, marrë nga zemra e

trungjeve të pishës, ishte ideal për kullim dhe për rrëshqitjen e dëborës.

Qytezës i ishte harruar emri i saj shekullor dhe që prej më se pesëdhjetë vjetësh quhej Sektor. Kjo kishte ndodhur pas reformës agrare, të ndërmarrë nga qeveria e kohës, që e kishte caktuar, *Sektor*, domethënë, pjesë e veçuar, e zgjedhur, qendër e zonës me dymbëdhjetë vendbanime të tjera, të vendosura në pllajat e një lugine të zakonshme, në të cilën rrjedh një lumë.

Inspektor Ilir Martini e ndali makinën e tij, një "Jeep Wrangler" i vjetër, pranë postës së policisë. Në fillim kishte planifikuar një takim me komandantin e postës, kapitenin Kin Uldeda.

U paraqit tek oficeri roje dhe nxori dokumentin e tij, duke e njoftuar ndërkohë se kishte lënë, rreth 2 orë më parë, një takim me komandant Kinin, në orën 10, pra pas pesë minutash, sipas orës së tij. Tjetri e shikonte si i shushatur dhe inspektori nuk po dinte si të vepronte për t'u marrë vesh. Më në fund, vetë oficeri ia zgjidhi situatën.

"Nuk mund ta takosh dot komandant Kinin".

Inspektori filloi të nervozohet, edhe pse e njohu nga zëri që ishte pikërisht njeriu me të cilin kishte folur pak më parë në telefon.

Në këtë mision, nuk është se ai kishte ndonjë rol të përcaktuar qartë. Zyrtarisht, askush nuk e kishte ngarkuar të hetojë, edhe pse këtë mëngjes kishte pasur dy kërkesa për përfshirje në këtë çështje nga dy personalitete shtetërore. Për organet e Ministrisë së Brendshme çështja ishte bërë e qartë, përfshirë edhe identifikimi i personit që kishte kërcënuar Presidentin. Ai kishte ardhur këtu, ç'është e vërteta, pa e ditur mirë se çfarë

kërkohej prej tij, i bindur edhe se askush nuk kishte përse ta priste krahëhapur, pasi të tjerët, mbase, e kishin të përcaktuar rolin e tyre në këtë histori, kurse ai vetë jo.

"Kam lënë një takim paraprak me të, për një çështje urgjente. Më duhet të bisedoj patjetër. Nëse nuk takoj dot as shefin e policisë, vaj hallit pastaj!"

"Të kuptoj, të kuptoj shumë mirë. Por, do të presë zëvendëskomandanti, major Tomë Keqi".

"Nuk ka kuptim, kam një bisedë me zotin Kin, kokë më kokë!"

"Më fal, zoti inspektor, se edhe unë jam ende i tronditur: nuk ma zë goja ta them atë që ka ndodhur. Pikërisht dhjetë minuta më parë, erdhi njoftimi. Kanë vrarë komandant Kinin!"

'Mos! Prapë ai, Gegë Toska?! Qenka çmendur atëherë!' mendoi me vete inspektori, pa folur. Dhe i erdhi fill në mend trupi i të vrarit në vig. Kot kishte menduar për ndonjë vrasje të zakonshme gjakmarrjeje, se ato tani kryheshin me kallashnikov, një armë e fuqishme që garantonte vdekjen e sigurt. Tani u kujtua që viktima, kishte vetëm dy vija të holla gjaku të mpiksur që buronin nga dy vrimëza në ballë. Me gjasë, ishin përdorur fishekë pistolete.

Tjetri priti që inspektori të fillonte nga pyetjet, por Iliri e mblodhi veten në çast. Gjithçka ishte shumë e freskët. Mendoi të kqyrte vetë kufomën, pastaj do të kërkonte informacione. Filloi të sillte në mend, për sa kjo ishte e mundur, gjithë makinat me targën e Sektorit që hasi në autorrugën A2, disa minuta më parë. Vrasësi mund të ishte shkëmbyer me të dhe tani mbase vazhdonte rrugën drejt kryeqytetit.

Vrasja e kapiten Kin Uldedës, dhjetë minuta përpara takimit të fiksuar me të, përbënte sigurisht një pengesë më shumë për punën e tij. Humbiste një burim zyrtar informacioni dhe një partner në hetime. Kjo, nga ana tjetër, të paktën, do të ishte kufoma e vetme që do të mund ta këqyrte, pas dy kufomave të mëparshme, atë të misionarit Palokë Lleshi dhe të Nikë Camajt, të varrosura me ngut nga komuna, pasi nuk kishin më të afërm në Sektor. Me një leje të veçantë ato edhe mund të zhvarroseshin.

Kurse zhvarrimin e kufomave të dy fëmijëve nuk kishte ndër mend ta kërkonte. Asnjë skrupull profesional, asnjë motiv i arsyes së shëndoshë, nuk arrinte ta shtynte të mendonte se do të përdhoste më tej trupat e tyre të brishtë. Do të arrinte shumë shpejt tek vrasësi i tyre.

Në këto mendime e sipër, preku dosjen numër 4, me informacione nga gjakmarrjet në Sektor.

Inspektori u ndje i lodhur, kur ora shënonte vetëm njëmbëdhjetë e paradites. I shkoi mendja të hidhej një copë herë nga vendfushimi i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, të vendosura pranë ish repartit ushtarak. Nëse nuk do të mund të takonte dikë që ia vlente, të paktën do të mund të hante diçka në mensën ushtarake.

Megjithatë, më parë shkoi dhe këqyri kufomën e postëkomandantit. Ajo që dyshoi ishte e vërtetë. Vrasësi ishte një qitës i aftë, një profesionist. Dy plumba pistolete kishin lënë dy vrima të zeza fare pranë njëra-tjetrës, në ballin e kufomës, shenjë e qitjes nga një dorë e sigurtë, që arrin ta mbajë mirë armën, duke realizuar dy goditje të njëpasnjëshme.

Vetëm se kishte një hollësi që i shpëtoi në ato çaste. Pistoleta TB ishte një armë sulmi, ofensive dhe në një distancë të afërt, nga ku qëllohej me të zakonisht, plumbat e saj kishin forcë të madhe depërtuese. Kurse në rastin e viktimës më të fundit, plumbat që kishin hyrë në ballë nuk kishin pasur forcë të dilnin nga prapa kokës, por kishin mbetur brenda në mukozën e trurit. Ose vrasësi ka shtirë me pistoletë TB nga një distancë e largët, ose është përdorur një armë tjetër jo kaq e fuqishme.

6

Bisedë në Messenger

Çun Matoshi, mësuesi i fëmijëve të ngujuar, hyri edhe një herë në dhomën e tyre, siç bënte çdo ditë, nga e hëna në të premte, që nga shtatori i atij viti shkollor. Ndezi kompjuterin, fjalëkalimin e të cilit e administronte vetë, prej kohësh, për të ruajtur fëmijët nga rreziqet e mundshme të kontakteve në rrjet dhe hyri në Messenger. Aty iu shfaq një mori emrash me mesazhe që kërkonin të futeshin në bisedë. I tërhoqi vëmendjen një emër, ose më mirë një mbiemër, Tufani. Vrau mendjen një copë herë, më shumë që të bindte veten, me një zë të dytë dyshues.

Po, ky ishte mbiemri i Presidentit, por mund të bëhej fjalë edhe për një përkim të rastit, se mbiemra të tillë mund të ketë me dhjetëra e qindra në vend. Vendosi të përgjigjet.

- *Përshëndetje, unë jam Donika Toska.*

Përdori emrin e vajzës së vrarë, njëmbëdhjetë vjeçare, të cilën e shikonte gjithmonë duke çatuar në internet, kohët e fundit. Ajo dërgonte mesazhe pafund, por ngaqë vozitës në internet në zonën e

saj nuk kishte shumë, shpesh përdorte edhe telefonin celular ose fliste me rrjetin fiks të shtëpisë. Ishte në një fazë kur përpiqej të kuptonte identitetin e saj përmes njohjeve të reja e të vjetra, por sidomos donte të fliste me shoqet e shkollës, të cilat i pyeste për gjithçka ndodhte, çdo ditë, për një vit me radhë, gjatë kohës së gjatë të ngujimit. Dhe dinte gjithçka për shkollën, sikur të ishte vetë në klasë.

Priti edhe disa sekonda i mbytur nga imazhet e fytyrave të nxënësve të tij, Donikës dhe Antonit, që nuk i shqiteshin për asnjë çast nga sytë, herë i qeshin, herë vrenjteshin, e herë nuk ia varin fare.

Dëgjoi një bip dhe në ekran iu shfaq përgjigjja.

-Ti nuk je Donika. Ne nuk themi përshëndetje, por tung, që do të thotë Tungjatjeta!

-Donika jam, sot m'u tek të përshëndes ndryshe. Po ti kush je?

-Që këtu merret vesh që nuk je Donika. Do ta kishe njohur shoqen tënde Vesën, menjëherë. E di unë, çfarë ka ndodhur, prandaj të lutem mos u tallni me mua, se jam shumë e dëshpëruar. Kam lexuar gazetat, e kam marrë vesh. Boll! Por desha vetëm t'u them, juve, kushdo qofshi, se edhe ne jemi ngujuar. Sot nuk kam shkuar në shkollë as unë e as vëllai im, Indriti.

-Po babin si ta quajnë?

-Babin, Zamir Tufani, pse nuk e njeh ti? Ai është president!

Çun Matoshi mbeti i shtangur. Doli nga Messenger-i me ndjesinë se sapo kishte zbuluar një sekret shtetëror dhe fiku kompjuterin.

Ngujimi nuk i bënte ndonjë përshtypje të madhe, si fakt në vetvete, se ai vetë jetonte me ngujimet, ishte i trajnuar dhe tanimë i

specializuar, pas një kursi zhvilluar online nga Ministria e Arsimit, si mësues ngujimi. I vinte zor ta mendonte, por ai vetë e siguronte jetesën me ngujimet. Sa më shumë ngujime, aq më shumë fëmijë për t'u dhënë mësim dhe, për rrjedhojë, pagesë më e lartë. Në një ndryshim të mundshëm të gjendjes, mbase do ta kishte të vështirë të gjente punë.

Vetëmse, tani nuk donte të hynte në telashe të reja. Këtu flitej për ngujim të Presidentit. E dinte që Gegë Toska kishte dalë i armatosur nga shtëpia. E pat dëgjuar me veshët e tij kur kishte thënë se do të shkonte tek Presidenti, por nuk e kishte menduar kurrsesi që ai paskësh pasur në mend të ngujonte vetë Presidentin. Nga gazetat nuk ka filtruar asgjë, kurse nga televizionet e dinte mirë që nuk mund të dalë gjë po të mos duan financuesit e tyre, qoftë qeveria, qoftë opozita, se dukej sheshit që ishin të gjithë nën ndikimin e politikës.

U dëgjuan të trokitura në derë. Ndodhej në një situatë absurde. U kujtua që në shtëpi gjendej vetëm ai me Lezen, nënën e fëmijëve të vrarë. Ajo ishte veshur në të zeza dhe ishte ndryrë e vetme, në errësirë, brenda në dhomën e saj.

Çuni zbriti shkallët e drunjta dhe hapi derën. Kushdo që të ishte, ai do ta hapte derën. Shtëpia kishte mort.

Njeriu që iu paraqit tha se ishte inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Krimeve, DPK, dhe se kishte ardhur të fliste pikërisht me të. Çuni i këqyri edhe dokumentin që i zgjati, por nuk arriti t'ia lexojë aty emrin, pasi ishte tejet i hutuar.

Shkoi të njoftojë Lezen, që paloste, e shkrehur në lot, rrobat e fëmijëve dhe i vinte me kujdes

nëpër raftet e tyre. 'Nuk kanë për t'i ba ma rrëmujë!' mendoi dhe pati një shkulm më të fortë ngashërimi, pikërisht në çastin kur hyri mësuesi.

"Ka ardhur një inspektor policie, me pyet! Çfarë t'i them? A ta pranoj mbrenë!"

"Po, dera është hapë, se kemi mort! Ti, shko e na piq kafet!"

Lezja doli pas Çunit në dhomën e pritjes dhe i zgjati dorën inspektor Ilir Martinit.

"Zoti të dhashtë kivet, o fisnike!"

"Kivet paç!"

Inspektori ndenji për disa sekonda të mira pa folur, duke i hedhur sytë gjithandej, derisa në derë u shfaq mësuesi me dy gota rakie. I la në tavolinë dhe u largua për të vënë xhezven e kafesë.

Duke kthyer pakëz gotën e rakisë, që e njohu menjëherë se ishte prej qershie, traditë e zonës, inspektor Iliri vendosi më në fund të flasë.

"Është e kotë ta fsheh. Unë këtu, nuk kam ardhur vetëm për ngushëllim, për shkak të detyrës që kam, mirëpo kjo nuk më pengon t'u shpreh, thellë nga zemra, hidhërimin tim për këtë tragjedi që iu ka pllakosur!"

"Faleminderit!"

"Do të doja të gjeja këtu edhe Gegën, edhe pse di që kjo do të ishte e pamundur, përndryshe nuk do të isha unë këtu!"

"Gega ka shku tek Presidenti!" ia preu shkurt Lezja, duke kthyer edhe ajo gotën e rakisë.

"A mund të më thoni se si iu ka ndodhë e gjithë kjo fatkeqësi? E kam fjalën, se si ka fillu? Pse keni qenë të ngujuem?"

Inspektori po përpiqej të fliste diçka në dialekt për ta afruar bisedën, edhe pse e dinte se nuk arrinte të ishte krejt i saktë. Megjithatë, kjo mënyrë të foluri, aty i erdhi e natyrshme.

“Ka fillu nga një nip i Gegës, djali i motrës, Luan Pepa ia thoshin emrin, se ka dekë, sot e gjashtë ditë, në burg. Është rritur jetim, prindërit i kanë dekë edhe ata, në një aksident në minierë. Ne nuk kena mujt me e mbajtë, por Gega e ka pasë pikë të dobët. Kur u hapën rrugët, mori detin me anije dhe shkoi në Itali, gjeti punë atje, erdhi këtu me leje dhe njofi një gocë. Ia kanë thanë emrin Teuta Camaj, e bija e Nikë Camajt, i vramë pas varrimit, në mbrëmje, thonë prej Gegës, po unë ja ku po ta them se, Gega tha se po shkon tek Presidenti e Gega nuk më ka rrejtë ndonjëherë.”

Hyri në dhomë Çuni me kafet dhe biseda u ndërpre.

“A mund të vazhdoj, zoti inspektor. Çuni është mësuesi.”

Inspektor Iliri befasohet për një çast nga ky pohim. I vjen në mend, papritur gjithë sa di për mësuesin dhe figurën e tij. I kujtohen jo vetëm mësues heronj të historisë së arsimit, të vrarë e të helmuar, por edhe vetë fytyrat e mësuesve të tij. Në vlerësimin e saj që ‘Çuni është mësuesi’ ishte derdhur gjithë besimi i mundshëm për një njeri.

Inspektori u kujtua që nuk i kishte dhënë dorën mësuesit, pasi tek dera i ishte prezantuar thjesht si inspektor policie. U ngrit në këmbë dhe iu paraqit për herë të dytë.

“Inspektor Ilir Martini! Është kënaqësi që njihem me ju. Jeni mësuesi i fëmijëve, apo jo?”

“Po!”

Mësuesi nuk i përmbajti dot lotët. Mori një pecetë në dorë dhe u largua sërish andej nga erdhi, duke kërkuar ndjesë.

“Eh, i shkreti mësues! E kemi pasë si robin e shtëpisë!”

Lezja pushon një copë herë, fshin hundët me shami dhe e vazhdon bisedën aty ku e kishte lënë.

"Nika, pra, ndjesë pastë, edhe ai, ani se thonë se ka shti mbi fëmijët..., Nika dha vajzën, Teutën, për nipin e Gegës që e mori në Itali. Atje, dul mendsh dhe e qiti në rrugë të madhe për pare, kjo i tha se do ta kallëzonte në polici e ai e vrau. E futën në burg në Itali, mandej e sollën këtu tek na, i dënuem me burgim të përjetshëm. Kjo histori ka fillua në mars të vitit të kaluem, kur na çuen fjalë me u mbyll mbrenë, me gjithë shpi. Hini në mes, Palokë Lleshi. Ke ndigju për të besoj. E kanë vra në një vend me Nikën, pardje. Thonë prapë, se ka qenë Gega. Ky, Paloka, ndjesë pastë edhe ky, hini ndërmjetës me falë gjakun, midis Gegës dhe Nikës. U duk muhabet i bamë në fillim, por po shkojke zvarrë, tërhiq e mos e kput. Derisa, nipi i Gegës, Luani vari veten në burg, e Nika erdhi tek na me pi kafe. Erdhi edhe Paloka. Ne e morëm këtë punë si të kryeme. Se, Nika ka qenë mik me Gegën, ka punu kapter në batalion e Gega ka qenë oficer, komandant. Dukej se vetëm një sebep donte me u pajtue. Për këtë punë, e patën braktisë edhe njerëzit e tjerë të familjes, e patën shku jashtë shtetit. Kur, ndodhi ajo që ndodhi... Ne, dërguem fëmijët në shkollë, të premten në mëngjes, dhe na i vranë!"

Fillon të ngashërehet me shkulme dhe inspektori nuk ka më besim se do ta vazhdojë bisedën. Ka ndërmend t'i bëjë disa pyetje për Gegën, do të marrë ndonjë informacion që do ta orientonte mbi vendodhjen e tij. Por e kupton që, tani për tani, vazhdimi i bisedës me gruan e gjorë do të jetë diçka sfilitëse. Vendos të vijë një herë tjetër në shtëpinë e saj.

Në çastin që ngrihet, hyn edhe mësuesi që tanimë është qetësuar dhe sikur do të thotë diçka, por inspektor Iliri nuk ndërron mendje, përshëndet dhe largohet.

Duke dalë, në murin e korridorit i tërheq vëmendjen një hartë topografike ushtarake.

“A bën ta mbaj ca kohë këtë hartë? Hartat janë pasioni im!”

“Mbajeni sa t’u duhet, por ma ktheni përsëri, se është e Gegës!”

thotë Lezja dhe si u largua inspektori deshi të pyesë menjëherë Çunin për diçka.

7

Makina e braktisur

Situata në Sektor po dilte nga kontrolli, për deputetin e zonës, Nosh Gjetani, edhe pse ai kishte bërë të vetën duke marrë të gjitha masat e mundshme.

Ishin shënuar katër viktima nga e premtja në mëngjes e deri të shtunën në mbrëmje. Kjo javë, sapo e kishin njoftuar, kishte filluar me një viktimë tjetër, e pesta, përsëri jo ajo që pritej. Gegë Toska, kërcënuesi i jetës së Presidentit, nuk ishte kapur, apo eliminuar ende. Përkundrazi, ishte aktiv, derisa kishte mundur të godiste vetë postëkomandantin, disa metra larg stacionit të policisë.

Kjo e hënë po sillte për të edhe një ndërlikim tjetër. Hynte në skenë një hetues dhe një prokurore që, sipas tij, do të ndikonin në zvarritjen e operacioneve, apo në ndryshimin e kahjes së tyre, siç do të vërente ai më vonë.

Nuk ishte informuar ende cila ishte prokurorja e dërguar në Sektor. Do ta mësonte pas disa orësh dhe në mendjen e tij do të përvijoheshin lojtarë

kundërshtarë shahu që vendosnin gurët dhe ndërtonin strategjitë. Tani dinte diçka vetëm për inspektorin, një tip i vrazhdë, sipas një telefonate që sapo i kishte mbërritur. Sapo kishte folur me Prekë Prelën, kryetar i Misionit të Pajtimit, i cili i qe ankuar për sjelljen 'brutale', siç do ta quante ai, të inspektor Martinit, këtë mëngjes. Nuk kishte pritur gjatë dhe kishte njoftuar menjëherë zotin Pisha, për t'i përcjellë këtë shqetësim, por ky ia kishte prerë shkurt, 'inspektorin e kam dërguar unë'.

Ai nuk e kishte zgjatur, nuk kishte kërkuar më asnjë sqarim prej këshilltarit të kryeministrit, edhe pse nuk ishte i qartë mbi diçka të rëndësishme për të. Për çfarë e kishte fjalën këshilltari? Që e kishte dërguar ai vetë në Sektor, apo e kishte orientuar të hetonte tek zyrat e Misionit të Pajtimit?

Që pas takimit të shtunën pasdite në Parlament me dy këshilltarët, për të nuk kishte pasur më qetësi.

Kohët e fundit, ai kishte ndikuar në shumë falje gjaqesh në krahinë, kishte marrë pjesë në kuvende malesh, kishte mbledhur ndihma për fëmijë të ngujuar, madje kishte bërë të mundur ardhjen në një Kuvend Pajtimi, dy vjet më parë, edhe të një eurodeputeteje të njohur, duke tërhequr më pas, përmes ndikimit të saj, edhe ndihma financiare nga UNICEF. Shkurt, veprimi i tij politik vërtitej në këtë vorbull. Këtu e projektonte ai të ardhmen.

Iu la hapësirë të kujdesej ai vetë për dërgimin e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, kontaktoi deri edhe me komandantët e tyre. Gegë Toska duhej kapur me çdo kusht dhe shpejt, përpara se

Presidenti të ndërmerrte udhëtimin e tij për nënshkrimin e anëtarësimit të vendit në ANM.

Prandaj, ai kishte vendosur të udhëtonte vetë drejt Sektorit. Gjendja duhej kontrolluar nga afër.

Inspektor Iliri mori makinën e tij dhe hyri sërish në autorrugën A2, tani me drejtim nga kryeqyteti.

Vrojtuesi e ndoqi me dylbi që nga dritarja e banjës së kapanonit të ish-repartit ushtarak, ku tani ishin vendosur trupat e Ndërhyrjes së Shpejtë. 'Ky, po largohet', mendoi vrojtuesi. 'E mori vesh më në fund, që kjo çështje nuk i takon atij'. Por inspektori ngadalësoi lëvizjen dhe e bëri të dyshonte. I telefonoi shefit të tij. "*Amerikani duket se po e lë këtë punë. Shpresojmë të jetë dhënë ndonjë urdhër nga lart. Ah, jo më duket, vetëm se po procedon fare ngadalë. Duket se po kontrollon krahun e djathtë të rrugës. Nuk besoj se po largohet. Do vazhdojmë ta kemi ferrë nëpër këmbë"*

Trokitën në derën e banjës dhe vrojtuesi fshehu dylbinë në një pllakë të hapur, pas bidesë. Shkarkoi ujin dhe doli.

Inspektori ndali makinën menjëherë në korsinë e urgjencës, pasi shqoi një pjesë bari të shkelur. Kërceu poshtë, në një vend ku nuk kishte rrethim metalik dhe pa gjurmë rrotash automobili. Eci më tutje dhe brenda në një ferrë të madhe, shqoi një makinë në ngjyrë gri. Ndonjë mjet i braktisur me kohë, mendoi fillimisht, por më pas vendosi të jetë më i kujdesshëm kur po afrohej. Nuk ishte i aksidentuar, kështu që mund të kishte edhe njeri brenda.

Targa ishte ajo që priste, SK 204 ML, një mercedes i vjetër që kërkohej që prej tre ditësh.

Me të ishte larguar Gegë Toska ditën e shtunë pas varrimit. Ishte parë të merrte autorrugën A2 drejt kryeqytetit, në orën 13 e 2 minuta, ndërsa vendi ku inspektori gjeti tani makinën ndodhej vetëm dhjetë kilometra pas hyrjes në autorrugë. 'Duhet ta ketë braktisur dhe pastaj i ka nxjerrë dorën ndonjë makine', mendoi.

Vazhdoi të afrohej me kujdes. Nuk kishte njeri brenda. Ngriti mbrojtësen e diellit nga ana e shoferit dhe gjeti aty, të palosura nën llastikun mbajtës, dokumentet e makinës. I kontrolloi, nuk mungonte asgjë.

Inspektori i vuri dokumentet përsëri siç ishin dhe u largua. I hodhi një sy vendit rrotull. Çdo gjë përkonte për bukuri.

8

Neni 83/a

Prokurorja Silva Basha, po hante në një tavolinë më tutje, në mensën e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë. Gjatë gjithë kohës bënte sikur nuk e vinte re inspektorin. Në fakt nuk njiheshin, edhe pse kishin dijeni për praninë e njeri-tjetrit këtu.

Inspektor Iliri duhet ta takonte patjetër.

E kishte kaluar atë paradite në kryeqytet duke përzgjedhur informacionet e marra në zyrën e Misionit të Pajtimit. Shumicën e tyre, të gjykuar si më me interes e kishte shtypur dhe e kishte sjellë me vete në disa dosje të cilat kishte menduar t'ia vinte në dispozicion prokurores. Më pas, e kishte ngarkuar kamionçinën edhe njëherë me materialet e marra, duke i porositur njerëzit e tij që të sistemonin gjithçka siç kishte qenë më parë. Vetë nuk kishte denjuar të shkonte edhe njëherë në zyrën e Misionit të Pajtimit, por ishte nisur për në Sektor.

E kishte dosjen ende përpara vetes, lidhur me dy llastiqe kryq, pasi ishte shumë e fryrë dhe

hapej. Në vend të etiketës, kishte shkruar mbi të *Neni 83/a* me një shkrim dore, si këmbë pule. E mori dosjen dhe u afrua tek tavolina e prokurores.

"Më falni, se edhe jeni duke ngrënë. A mund t'u shqetësoj një minutë?" i drejtua prokurores.

"Kam mbaruar, tani po pres kafenë. Nuk ka problem! Po si e keni hallin zotëri?"

"Jam inspektor Ilir Martini!"

"Po, e marr me mend, po si e keni punën?"

"Dëgjo, sot në mëngjes më thanë se këtu do të takoja edhe një prokurore. Më ka folur kolonel Bardhi për ju."

"Ah, koloneli!"

"Po, koloneli. Ai na ka dërguar të dyve këtu dhe besoj se ai vetë, të paktën, e di përse na ka dërguar"

"Më vjen keq, zoti inspektor, po unë kam nisur me kohë nga puna. Po mbledh prova për disa raste kanosjesh, derisa të sqarohet përfundimisht edhe çështja e Gegë Toskës."

Inspektor Iliri mori një karrige dhe u ul, duke lënë dosjen mbi tavolinë.

"Ja ku i ke provat!"

Inspektori i la pakon me dokumente mbi tavolinë dhe u ngrit me vrull, ashtu siç u ul.

"Inspektor!" i thirri ajo. "Prit, merr një kafe, të paktën!"

"Nuk pi kafe unë, as duhan, pakëz alkool me raste dhe vetëm mbllaçitem gjithë ditën e lume, ja shikoje!"

Inspektor Iliri nxori nga xhepi një çimçakiz dhe e futi në gojë, duke ecur mbrapsht.

U përplas pastaj pas kanatit të derës dhe u kthye mbarë.

Përshëndeti me dorë dhe u largua.

Dy sy, nga një tavolinë nga fundi, e ndoqën me vëmendje inspektorin.

Prokurorja Silva Basha mori dosjen në duar. Pa të shkruar mbi një etiketë të bardhë *Neni 83/a* dhe e mori vesh menjëherë për çfarë bëhej fjalë. Në mendje i erdhi i plotë formulimi i shkurtër i këtij neni të Kodit të Procedurës Penale: "*Kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje, që i bëhet një personi a një të mituri për t'u ngujuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet".*

Filloi të shfletonte dokumentet. Mesazhi i inspektorit ishte i qartë. Ai e ftonte të vepronte si prokurore, si organ akuze, të bënte mbase arrestime në masë të personave që kishin kanosur të tjerët duke i ngujuar brenda. Dhe në dosje kishte emra konkretë, adresa, data, prova të vërteta mbi dhjetëra raste kanosjesh, të gjitha të lokalizuara këtu në Sektor.

Filloi të inatosej me inspektorin. 'Si guxon ky njeri të më tregojë punën mua? Po për vete çfarë po bën? Çfarë po heton ky? Kanë ndodhur pesë vrasje në tre ditë dhe ende nuk ka asnjë raport të saktë për asnjërën prej tyre. Mbase, edhe nuk ka edhe shumë faj, se sot do t'i kenë thënë të merret më këtë çështje.'

E gjerbi kafenë gjithë nervozizëm, me dy hurba të mëdha dhe i ra pas inspektorit, gati e revoltuar.

As prokuroja nuk i shpëtoi syve që shikonin gjithë vëmendje andej kah tavolina e fundit. Madje, personi që i vëzhgonte u ngrit dhe e ndoqi pas. Ishte shumë i njohur për të gjithë, se e përshëndetnin sa majtas-djathtas.

Disa minuta më vonë, prokurorja po trokiste fort në derën e dhomës së inspektorit. Aty për aty, u step, por tashmë asgjë nuk mund të kthehej mbrapsht. Çfarë të drejte kishte ajo të trokiste në derën e dhomës së një të panjohuri?

Nga brenda u dëgjuan zvarritje shapkash që shoqëronin rrjedhën e ujit të rubinetit ende të hapur. Inspektori doli me një peshqir hedhur supeve dhe me shkumë në faqe.

"Më falni", kërkoi ndjesë ai kur pa në derë prokuroren, por në fakt u duk përsëri i sigurt në vetvete, sikur e priste vizitën e saj.

"Jo, nuk ka përse. Jam unë ajo që duhet të kërkoj ndjesë, se po ju shqetësoj, por përderisa këtu jemi thuajse në një gjendje të jashtëzakonshme, na falen edhe këto lajthitje. Si ajo, juaja një minutë më parë. Nuk denjuat të pinit një kafe. Latë dosjen dhe ikët."

"Ke të drejtë, por unë mendoj se na bie më mirë të mos harxhojmë energji kot. Le të përqendrohemi tek ajo që ka rëndësi. Bëtë shumë mirë që erdhët, na duhet të diskutojmë dhe t'i bashkërendojmë punët. Sa për kafe, nuk pi vërtet. Po nuk qëndron këtu problemi. Vetëm dy minuta, sa të vishem. Kisha nevojë edhe për një dush, por hajt, e bëj më vonë."

Inspektori rrëmbeu këmishën dhe u largua në brendësi të dhomës, ndërsa prokurorja vazhdonte të rrinte në pragun e derës. Dëgjoi hapa që zbrisnin lehtë, në shkallaren e poshtme.

Njeriu që e kishte ndjekur, kishte zgjatur kokën, ishte siguruar që nuk kishte hyrë brenda në dhomë dhe tani po largohej, duke mos dashur të zbulohej prej tyre. Por, prokurorja nuk u bë dhe aq kureshtare. Nuk besoi se e gjitha kjo kishte vërtet lidhje me të.

Ndërkohë, edhe Iliri doli. Dukej krejt ndryshe pa atë tisin e errët të mjekrës njëditëshe, që zakonisht pëlqehej nga gratë, se i tregonte djemtë më të burrëruar, ndërsa burrat e thyer në moshë më të rinj, duke lëshuar njëkohësisht tek ta një hije misteri dhe një dukje prej mentari.

Kështu, Iliri kishte shkuar kundër kësaj tendence, duke marrë pamjen e atij studentit që lë konviktin dhe del me të dashurën; një fytyrë çunaku, krejt tjetër nga ajo e disa minutave më parë në mensë, që dukej shumë larg nga pamja e një burri rreth të dyzetave.

Silva e vuri re ndryshimin, për të në drejtimin e duhur. Nuk e duronte dot më arrogancën e burrave, në çdo formë që ajo shfaqej. Sapo kishte mbyllur hesapet me një martesë të dështuar, të stërzgjatur kot së koti, me shpresën për ta shpëtuar. Sjellja e ish burrit të saj damkosej rëndom si xhelozi, nga shumë syresh, por për të kishte qenë një lloj reagimi tipik mashkullor, i mbrujtur me atë pasigurinë karakteristike, nga e cila e kanë burimin të gjitha dobësitë e burrave, që si për kundërpeshë shndërrohen në agresivitet. Dhuna, pastaj bëhet një lloj droge, që i ndihmon të shtyjnë përpara ekzistencën e tyre të sëmurë, shfaqur në forma nga më të lehtat, deri në më të ashprat, tamam një lloj varësie, pa kthim prapa. Dhe kujtojnë se viktimat, janë ata vetë, meshkujt!

"Zbresim!"

Zëri i inspektor Ilirit e gjeti Silvën të papërgatitur. Kthehu kokën si e përhumbur, por u përqendrua shpejt.

"Bëjmë nja dy hapa, apo marrim ndonjë gjë këtu në holl?" pyeti ajo.

"Më mirë këtu poshtë, në holl. Se kemi mundësi t'u hedhim një sy edhe atyre letrave"

“Në rregull!”

U ulën poshtë në holl. Bari ishte i heshtur. Mungonte edhe i dehuri klasik i tavolinës së fundit. Një mjedis ideal ku mund të punohej. Ai mori një teke raki qershie të vendit, ndërsa ajo një lëng frutash.

“Dëgjo, së pari propozoj t’i lëmë etiketat, jemi kolegë, le të bisedojmë pa dorashka e pa korniza mirësjelljeje…”

“Dakord! Unë e fillova që në mensë! Mjafton të mos keqkuptohemi!”, ia preu shkurt inspektor Iliri.

“Më thirr Silva, atëherë!”

“Okej, mua Ilir, edhe Lìri, po të duash!”

Silva qeshi vesh më vesh, pastaj u kujtua të pinte ca nga lëngu i frutave, për ta përmbajtur veten. Kujdesej që të mos linte në gotë shenjën e buzëve të lyera me një të kuq të lehtë.

Iliri ktheu paksa rakinë dhe një valë e ngrohtë iu përhap, fill, në të gjithë kraharorin. ‘Tani e bëjnë rakinë e mirë, të gjithë’, tha me vete.

“Është një ndjesi e çuditshme,” nisi të flasë prokurorja. “Ne që përfaqësojmë ligjin ndjehemi të izoluar. Se, i hodha një sy dosjes që ke marrë në Misionin e Pajtimit. Aty ka fakte të mjaftueshme për qindra njerëz që kanë kryer vepra penale, por sa të vështirë do ta kemi të veprojmë në terren! Unë e kuptoj disponimin tuaj…”

“‘Tënd’, jo ‘tuaj’, ndërhyri inspektori.

“Apo po, ke të drejtë!” Silva heshti pak duke rrotulluar sytë që të kujtohej se ku e kishte lënë. “Mirëpo, jemi në një situatë të veçantë, në rrethanat kur këtu kërkohet të arrestohet, ose me sa shoh unë, të eliminohet fizikisht një person i dyshuar si kërcënues i jetës së Presidentit. Ti nuk i ke parë ende Forcat Speciale se çfarë armatimi

kanë me vete! Mirëpo, puna është se, unë si prokurore, në gjendjen ku ndodhen hetimet, nuk guxoj të marr një vendim për arrestimin e Gegë Toskës. Më janë ofruar disa informacione të paplota, të cilat shpallin fajësinë e tij në lidhje me vrasjet e misionarit Palokë Lleshi dhe të shtetasit Nikë Camaj, por asnjë provë. Tani vritet edhe komandanti i policisë, nën hundën e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë. Përsëri thuhet se ka qenë Gegë Toska dhe jepet si provë fakti që në trupin e tij janë gjetur predha që janë zbrazur nga një pistolete TB, por ekspertët e armatimit thonë se predha të tilla mund të përdoren edhe nga lloje të tjera armësh, madje e dini fare mirë që ne kemi eksportuar municion të gjithë botën; nuk besoj se atje janë përdorur vetëm për armë TB dhe automatikë AK-47."

"Më fal Silva, se po të ndërpres edhe njëherë. Kjo është një çështje kyçe, sigurisht që duhet zgjidhur, por unë mendoj se duhet të veprojmë në çdo moment! Këtu kemi mjaft forca policore mbështetëse, të cilat mund t'i shfrytëzojmë në favor të zbatimit të ligjit. E kam fjalën, aty ku kemi prova, le të veprojmë. Sa ishin familjet e ngujuara vetëm këtu në Sektor, 37 apo jo, shumëzoi për 4 a 5 pjesëtarë, shkojnë afro 150 njerëz, që rrinë mbyllur nëpër shtëpitë e tyre. Shteti, që pretendon se jep siguri për qytetarët, duhet të ndërhyjë. T'i shfrytëzojmë rrethanat, them unë. Në këtë moment ne kemi këtu forca policore me bollëk. Mirë, kanë ardhur siç the ti për kapjen apo ekzekutimin e një njeriu, që ka kërcënuar Presidentin, por ne nuk na pengon asgjë që të arrestojmë, ndërkohë, të gjithë ata që kanosin jetën e qytetarëve. Jo më kot i vura dosjes

etiketën *Neni 83/a*. Le të zbatojmë këtë nen të Kodit të Procedurës Penale."

"Do të na hidhen në grykë! Shikoji kur të fillojnë ca ekspertë, jo me pretendimet se nuk zbatohet drejtësia restauruese, nuk përfillet ligji për ndërmjetësimin..."

"Ne bëjmë tonën, ata të vetën. Je e vendosur të procedojmë?"

"Që nesër!"

"Jo, që sonte!"

"Që sonte, atëherë!"

Kishte rënë nata, kur, makina të Policisë së Shtetit filluan të ngjisnin pllajat ku ishin vendosur vendbanimet e izoluara të krahinës së Sektorit. Të organizuar në grupe me nga pesë pjesëtarë të forcave speciale, u bënë me dhjetëra arrestime, të njëkohshme, pa lënë mundësi që lajmi të përhapej dhe personat në kërkim të largoheshin.

Nuk pati as kundërshtime me armë, siç mendohej.

Prokurorja dhe Inspektori vazhduan të punonin, deri vonë, në hollin e hotelit, duke plotësuar fletë-arrestime. Ua përcillnin korrierëve, të cilët i merrnin shkresat dhe ua dorëzonin për zbatim skuadrave të motorizuara.

9

Sheshi i Bashkisë

Të nesërmen qendra e lokalitetit gumëzhinte nga njerëzit. Gjithçka ngjante me ato kronikat bardh e zi, të mbetura në arkivat mbi çlirimin e qyteteve pas luftës botërore të fundit.

Edhe gazetat u mbaruan shpejt.

"Jo, mor, kësaj pune i paskan thanë, prit gomar sa të mbijë bar! Ja kanë bà bash mirë! Nuk durohej ma!"

Reagimet e njerëzve ishin nga më të ndryshmet, por mbizotëronte sidoqoftë një ndjenjë e përgjithshme çlirimi. Një rresht fëmijësh që niseshin për në shkollë, të kapur dorë për dore, u duartrokitën nga një turmë qytetarësh përpara Sheshit të Bashkisë.

Deputeti Nosh Gjetani, që kishte mbërritur një ditë më parë, po i vërente këto skena nga një dritarja e zyrës së Kryetarit të Bashkisë, të cilin e kishte thirrur me urgjencë. E kishte zgjedhur ai vetë si kandidat në atë post dhe prandaj ushtronte ndaj tij një pushtet të veçantë.

Kryetari, Frrok Gjini, dukej i ekzaltuar dhe i shpëtuan lot kur pa të duartrokiteshin fëmijët. Vazhdonte të ndiqte ecjen e tyre drejt shkollës, psherëtiu dhe pastaj u drejtua, me nge, nga deputeti.

"Eh, të gjorët fëmijë! Këta ja dolën për mrekulli, shëndosh si kokrra e mollës! Iu lumtë që e keni mendu me e zgjidhë këtë problem, zoti Nosh. T'i lëmë përrallat, duhet me vepru sa nuk është vonë. Keni bà shumë mirë!"

Deputeti nuk dukej të shfaqte ndonjë shenjë ekzaltimi të veçantë, në sytë e kryetarit, por edhe ai nuk po e ndante shikimin nga turma në shesh. Vërente fëmijët që vazhdonin të çanin në mes, njësoj si ata çlirimtarët në ato fotot e vjetra të luftës së dytë, veçse në vend të uniformave, fëmijët mbanin përparëse shkolle.

"Po ata të shkretët, që u vranë! Si ja ka bà dora me shti kundër fëmijëve!" vazhdoi kryebashkiaku.

"E ke fjalën për fëmijët e Gegës!"

"Po, për fëmijët! Çfarë faji kanë fëmijët!"

Ra një heshtje e gjatë, ndërsa ata vazhdonin të shikonin sheshin përpara bashkisë, që më në fund filloi të zbrazej.

Mbyllja përfundimtare e kësaj skene u lajmërua nga tingujt e ziles së shkollës, nja dyqind metra më tutje, që erdhën deri aty, në zyrën e kryetarit të Bashkisë.

Deputeti mbylli dritaren dhe u ul, si pa të keq, në karrigen e kryetarit, ndërsa tjetri vazhdonte të rrinte pas parmakut, duke hapur perden.

"Dëgjo, Frrok. Ulu, zër vend tani, se nuk kam shumë kohë!" foli qetë deputeti, por pa e fshehur dot një tension të brendshëm.

Kryebashkiaku u kthye dhe nuhati menjëherë se deputeti do t'i komunikonte diçka të

rëndësishme. Zuri vend në një karrige në krahun e tij të djathtë dhe priti.

"Duhet kapur Gegë Toska, me çdo kusht!" tha deputeti Nosh Gjetani dhe heshti një copë herë për të parë reagimin në fytyrën e tjetrit.

"E di, thonë se ka vra Palokën, Nikën dhe tani Kin Uldedën. Duhet kapë patjetër!"

"Pse ka vra, është njëra anë. Nuk është as i pari e as i fundit. Patjetër duhet kapë e dorëzu në organet e drejtësisë"

"Ka qenë i ligështum prej fëmijëve. Do të ketë humbë mendjen fare, se na e njohim të gjithë se kush është Gega! Por, o Zot, ma keq se e ka çu, nuk ban ma!"

"Ka edhe ma keq, or Frrok! Unë, kam ardhë me të njoftu për një sekret shtetëror! Hapi veshët mirë, por mbaje gjithçka për vete, se hala nuk është bà publik! Merre vesh pra, or Frrok, se ky Gegë Toska, që ti po thu se ka qanë burrë i mirë, ka mbyll mbrenë Presidentin!"

"Cilin president, atë të futbollit, Mëhillin, a?"

"Presidentin e Republikës, mor, zotin Tufani!"

"Ah, për nji mend e ke?"

Kryetari i Bashkisë kishte marrë një pamje prej të marri, me gojën hapur dhe sytë e zgurdulluar dhe deputeti nuk foli më. U ngrit nga karrigia dhe i bëri me shenjë të ulej në vendin e tij të kryetarit. Vetë vuri duart pas shpine dhe eci nëpër dhomë.

"Duhet kapë Gegë Toska me çdo kusht! Ne kemi sjellë edhe forcat speciale, por ato duan mbështetje, informacione. Autorruga e re është e gjitha e kontrolluar. Kemi vendosë postoblloqe që prej dy ditësh!"

Deputeti ndenji edhe disa minuta, duke biseduar për hollësi të tjera në lidhje me rëndësinë e kapjes së Gegë Toskës, ndërsa kryebashkiaku

dukej sheshit i zhgënjyer. Ishte befasi për të, që të gjitha ato forca kishin ardhur për kapjen e një njeriu. Sidoqoftë, ai do të bashkëpunonte, duke ndjerë përgjegjësinë e çështjes. Por, deputetit, sigurisht, nuk ia shprehu rezervat e veta. Kush i kishte kryer atëherë gjithë ato arrestime për gjithë natën? Ndjeu brenda vetes një lloj konfuzioni të përgjithshëm, por e kuptoi se aty për aty, nuk mund të reflektonte. I shkoi pas deputetit që kishte dalë përpara dhe po zbriste shkallët.

Varrimi i komandantit të Postës së Policisë, Kin Uldeda, u bë madhështor, me të gjitha nderimet zyrtare të rangut të tij. Nuk ishte ky rasti për të folur për anët e dobëta profesionale dhe të karakterit të tij, tani që ishte ndarë përfundimisht nga jeta. Nuk e vinte kush në dyshim që Kin Uldeda kishte qenë një njeri i ndershëm, por një polic i vërtetë nuk kishte mundur të bëhej dot, asnjëherë. Gjithkush, tek mendonte për të, kërkonte ta fshihte nga kujtesa nofkën që i patën ngjitur, "Dopiogjashta". Mund të ishte polici më i pasionuar në botë, por pas lojës së dominove, jo profesionit të tij. Nuk pyeste për koburen, rripat, pajimet, por ulej në mes të lulishtes dhe luante domino me pensionistët, pa llogaritur zyrën, në të cilën mblidhte gjithmonë edhe tre oficerë të turnit për të bërë katërshen e zakonshme të lojës. Nuk i pëlqente loja dyshe, i dukej një sfidë krejt e thjeshtë, pa atë ngazëllimin që të sjellin hilet e pa kuptuara, shenjat me ortakun, kështu që mbante gjithmonë, çdo ditë, bashkë me veten, edhe tre policë shërbimi për të luajtur domino.

Sigurisht, nuk ishte rasti për të kujtuar këto fakte, por nëse do ta merrte fjalën ndonjëri nga

pensionistët e shumtë, patjetër do t'i shpëtonin ca fjalë edhe për dominotë.

Ishte paraditja e së martës dhe inspektor Iliri po vërente njerëzit e mbledhur në varrim, forcat e rreshtuara të trupave speciale dhe një skuadër pushkatarësh që qëlloi në ajër në kohën e uljes së arkivolit në atë që quhej rëndom, banesa e fundit.

Pranë tij ishte Silva, që dukej se kishte diçka për t'i thënë.

Në trupat e rreshtuara të forcave speciale, ajo kishte vënë re atë, ai kishte ardhur. Donte të bisedonte menjëherë me Ilirin, por e kuptoi se kjo do të ishte e pamundur, duhej ta mbante përbrenda edhe ca kohë këtë zhvillim kaq të papritur për të.

Ilirit i shkuan sytë tek komandanti i njësisë speciale "Ujku", i njohuri Bim Hyka, i veshur në uniformë laramane ushtarake. E kishte njohur mbrëmjen e shkuar, gjatë natës së arrestimeve. Ndërsa, disa metra më tutje, vuri re deputetin Nosh Gjetani. Nuk po merrte vesh se ku e kishte zanafillën shqetësimi i Silvës. As ai nuk kishte ndërmend ta pyeste aty, pikërisht në atë çast, kur mbretëronte një heshtje varri.

E, megjithatë, Iliri lëvizi papritur. Diçka i shkrepi në kokë, befas. U tërhoq si me lezet dhe shkoi disa metra më tutje, pranë varreve të reja të fëmijëve, Anton Gega dhe Donika Gega. Pothuaj ngjitur me ta, preheshin edhe Palokë Lleshi dhe Nikë Camaj, pasi varrezat bashkiake ndiqnin radhën e të vdekurve. Vetëm për policin ishte bërë një përjashtim, duke e vendosur në një vend të rezervuar në pjesën ballore.

Iu afrua varreve, krejt i veçuar nga turma e njerëzve dhe zu t'i këqyrte ato me kujdes, sikur kërkonte të gjente diçka mbi dheun ende të butë.

E dinte që duhet të kalonte një vit që dheu të shkonte në vend dhe vetëm atëherë fillohej me ndërtimin e varrit të përhershëm.

Preku xhepin e xhaketës dhe u kujtua se aty kishte futur fotokopjen e hartës topografike që kishte marrë në shtëpinë e Gegë Toskës. E hapi dhe zu ta këqyrte me vëmendje; në të pasqyrohej i gjithë relievi i zonës me objektet e tjera të mundshme.

Vuri gishtin mbi një pikë ku ishte shënuar një kryq i madh. Ajo ishte varreza, ku ndodhej tani ai vetë, pastaj objekti tjetër duhej të ishte reparti ushtarak dhe menjëherë pas tij, një rrugë strategjike që kalonte në kodrat lart, futej në disa gryka, çante sërish në pllaja e livadhe malore, pa hasur në asnjë qendër të banuar.

U kujtua që Gegë Toska kishte qenë oficer këmbësorie.

Kthehu kokën dhe pa të gjithë ata njerëz të rreshtuar, që po varrosnin viktimën e fundit, me gjasë, të shkaktuar nga dora e një prindi të marrosur, që pas humbjes së fëmijëve i janë errur sytë, është bërі i egër e i rrezikshëm. Një imazh i çuditshëm i kaploi trurin. Përfytyroi Gegën me një çantë shpine, me gavetë e pagure uji, në marshim. U bind në çast, se një oficer i vjetër këmbësorie nuk kishte përse të mos e vinte në jetë përvojën e tij. Gega, me siguri, do të ketë nisur një marshim nëpër rrugën e vjetër ushtarake.

Filloi të bënte llogaritjet e rastit në hartë. Autorruga moderne me katër korsi kishte një gjatësi prej 130 kilometrash deri në kryeqytet, ndërsa rruga ushtarake maleve duhet t'i kalonte të 150 kilometrat, pak a shumë. I binte të ecte pothuaj i vetmuar, pa hasur askënd deri në kryeqytet. Në një marshim normal, mund të bënte

4 deri në 5 kilometra në orë. Duke llogaritur një udhëtim natën, për shumë motive, ai mund të ecte rreth 6 orë në natë me dy orë ndalesa, ndërsa ditën mund të fshihej nëpër zabele dhe të flinte. Do të arrinte të bënte 30 deri në 40 kilometra çdo natë, pra, brenda katër deri në pesë netë, ai do të mbërrinte në kryeqytet. Në çdo rast, ai do të shkonte atje, përpara nisjes së Presidentit për nënshkrimin e ANM-së, pra deri të premten në mëngjes. Llogarisim, që vrasjen e fundit e ka kryer të hënën në mëngjes. Sot ishte e martë, pra ai do të ketë udhëtuar një natë, deri tani, dhe ndodhet 30 deri në 40 kilometra larg prej Sektorit.

Inspektor Iliri e vuri gishtin në pikën e mundshme ku vrasësi mund të kalonte ditën dhe ja pati zili, për një motiv krejt tjetër. Ishte një zonë me pyje halore, ta cilat rrethonin si kurorë disa liqene me origjinë akullnajore. Nëse i kishte marrë masat mirë, mund të kalonte ditën për bukuri në një nga hotelet turistike, duke u regjistruar sigurisht me ndonjë dokument të rremë, gjithmonë nëse dikush do t'i kërkonte ndonjë dokument.

Pa edhe njëherë nga turma e mbledhur për varrimin e postëkomandantit Kin Uldeda, përfytyroi që larg fytyrat e tendosura të shefave të trupave speciale, që ishin shtuar me përforcime të reja dy ditët e fundit, pastaj solli ndër mend atë të deputetit Nosh Gjetani dhe i shpëtoi një si ofshamë. I ironizoi me vete, të gjithë, tek i erdhi në mend moria e postoblloqeve të ngritura prej tyre, nga kryeqyteti deri këtu në Sektor, me shpresë se do të gjenin, të kapardisur në ndonjë makinë, vrasësin e tre burrave dhe kërcënuesin e Presidentit.

Ishte duke palosur hartën, kur pa Silvën të shkëputej, si me lezet, nga pjesëmarrësit në varrim dhe të ecte drejt tij me hap të shpejtë. Nuk e la ta pyeste, foli vetë e para, madje duke e kapur për krahu, si ta kishte një të njohur të vjetër.

"Ikim që këtu!"

"Çfarë ke?"

"Ai ka ardhur. Është i armatosur dhe ka ardhur për mua!"

"Kush është ky?"

"Ish burri im, Bim Hyka quhet. Është instruktor fizik tek Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë. Tani na drejtoka njësinë speciale "Ujku", dëgjova të pështpëritej për të në turmë. Ka gjetur rastin dhe më ka ndjekur! Eja të lutem, të paktën më shoqëro deri në dhomë!"

Silvës i kishte humbur tërësisht vetëkontrolli. Iliri nuk e kishte parë asnjëherë në një gjendje të tillë pasigurie.

"Patjetër, shkojmë. Po, qetësohu! Askush nuk e ka mendjen tek ne!"

"Gabohesh, ai na ka ndjekur edhe mbrëmë. Shikoje edhe tani, si e ka zgjatur kokën!"

"Unë nuk e njoh që larg. Mbrëmë e kam parë për herë të parë dhe natën! Por, në fakt, nuk po shoh askënd të ketë zgjatur kokën. Qetësohu tani! Shkojmë. Ai ka ardhur për punë si të tjerët. Mbrëmë natën ka ekzekutuar gjithë urdhër-arrestet që ke firmosur ti! Mos e harro këtë!"

"Ikim, Ilir të lutem!"

10

Prokurorja fle në dhomën e inspektorit

Pasditen e së martës inspektor Iliri kishte planifikuar të bënte disa verifikime të rastit. Donte të shkonte të takonte Lezen, të shoqen e Gegë Toskës. Kishte ndër mend të pyeste se çfarë rrobash kishte veshur Gega, çfarë ushqimesh kishte marrë me vete, kur kishte thënë pas varrimit të fëmijëve, të shtunën pasdite, se do të shkoj tek presidenti. Kishte nevojë të qartësonte përfundimisht në kokën e tij se, ish oficeri i këmbësorisë Gegë Toska, ishte nisur me të vërtetë në një marshim drejt kryeqytetit.

Por, e gjitha kjo, nuk do të kishte qenë e mundur.

Gruaja, që nuk ishte trembur të lëshonte 37 fletë-arresti brenda një nate për burra me mustaqe që ndrynin brenda shtëpive të tyre dhjetëra njerëz nën kërcënimin e armëve, tani dridhej si purteka, në krah të inspektorit dhe praktikisht nuk e linte të bënte asgjë. Madje, i kishte thënë se do të flinte në një dhomë me të, atë natë.

Silva Basha i tregoi deri në hollësi historinë e saj prej gruaje që kishte guxuar të ndahej nga burri. Nga një burrë xheloz e për rrjedhojë agresiv, që nuk arrinte kurrë të kuptonte se gruaja e tij mund të kishte edhe një jetë krejt të sajën, të pavarur, që në fakt në rastin e Sivës, përbëhej nga elementë fare të thjeshtë, marrëdhënie korrekte dhe pak më shumë hare, pa imituar sigurisht ato gra, që në emër të kërkimit të një jete të lirë, bien në ekstremin tjetër, bëhen imituese të këqija të anëve më negative të meshkujve. Silva Basha kishte guxuar të ndahej nga i shoqi, Bim Hyka, një instruktor fizkulture, që përveç punës së tij shtetërore në Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, kishte çelur edhe një palestër private, nga e cila sillte edhe shumë të ardhura. Bashkë me rrogën e mirë të Silvës, si prokurore në Krimet e Rënda, ata kishin mundur të realizonin së toku një mirëqenie për t'u pasur zili, jetonin në një kompleks banimi në periferi të kryeqytetit, në të cilin i gjeje të gjitha shërbimet dhe nuk mungonte as banka, as kinemaja, as qendra tregtare.

E megjithatë, Silva kishte guxuar t'i thoshte jo dhe tani banonte në një apartament më të vogël, edhe pse të ristrukturuar mirë, pak më në qendër të kryeqytetit.

"Në rregull, fli në dhomën time, sonte, dhe nesër, nëse ndjehesh kështu si sot, është mirë të largohesh!" i tha Iliri.

"Po, nuk kam ç'bëj tjetër. Vështirë, se mund të qëndroj dot më. Është e tmerrshme! Ta thashë, edhe mbrëmë ai do të ketë qenë! Më ka ndjekur kur u largova nga mensa. Nuk mundem, Ilir. Më fut dridhmat, më keq, tani që bredh i armatosur m'u nën hundën time. Jam e rrezikuar, më kupton dhe nuk kam se ku dhe pse të ankohem.

Thuaj ti, për çfarë mund të ankohem? Ai ka ardhur në përbërje të trupave speciale dhe për një mison konkret. Duhet të ndihmojë në kapjen e një krimineli të rrezikshëm që ka kërcënuar direkt jetën e Presidentit. Mund t'i fshehë gjurmët për mrekulli!"

"Dakord, nesër do të shoqëroj unë me xhipin tim, por do të bëjmë një rrugë tjetër."

Në dush hyri ajo e para. Dhoma u mbush me një valë të ngrohtë avulli, ndërsa zhurma e ujit në distancë, krijonte për Ilirin një mjedis familjar, të cilin kishte kohë që nuk e përjetonte.

Marrëdhëniet e tij me femrat nuk arrin kurrë të ishin të qëndrueshme, ca për shkak të profesionit, ca për shkak të vetë karakterit të tij. Nëse rëndom femra tenton folenë, vatrën familjare në një marrëdhënie bashkëjetese, apo martesore, mashkulli fillon ta ndjejë veten të ndryrë në atë fole, që në fakt për të shndërrohet në një kafaz nga e cili e ka të vështirë të ikë. Do të fillojë të mungojë në barin e lagjes, ku ka parë me vite ndeshjet e futbollit, duke rrëkëllyer shishe me birrë mes shokësh. Iliri, megjithatë, ishte i një kategorie tjetër, por edhe ai fole nuk mund të ndërtonte. Tregohej shumë i përkushtuar në një marrëdhënie njohjeje ose bashkëjetese, por për sa kohë ishte i pranishëm, pasi nuk i qëllonte ta kalonte kohën në një banesë për shumë kohë. Pas ndërrimit të pafund të fjetoreve, fillimisht në shkollat ushtarake që kishte kryer, pastaj në misionet e ndryshme brenda e jashtë vendit, për shkak të profesionit të tij si ushtarak dhe inspektor krimesh, ai mbetej gjithmonë në lëvizje, kështu që partneret, herët a vonë, lodheshin me të.

Ndezi televizorin dhe ndoqi të plotë një edicion lajmesh, shoqëruar gjithmonë në sfond nga zhurma e dushit. Nuk kishte filtruar asgjë në lidhje me ngujimin e Presidentit, madje nuk u fol as për vrasjen e postëkomandantit Kin Uldeda, kur zakonisht flitej edhe për ndodhira krejt të parëndësishme. Dukej se shteti e kishte situatën nën kontroll. Ajo doli mbuluar me një peshqir të madh të bardhë, që i linte zbuluar supet dhe këmbët. Iliri u shkëmbye me të, me kurriz, në korridor. Silva kishte ndalur përpara pasqyrës dhe i hodhi një vështrim përmes refleksit të imazhit të saj, përcjellë me një buzëqeshje të lehtë. Ajo kishte lëshuar një afsh të ngrohtë dhe një aromë shampoje të mirë që dushet ku lahej ai nuk e kishin pasur kurrë ndonjëherë.

Ai tërhoqi paretin plastik dhe filloi të zhvishej. Duke fërkuar trupin e tij muskuloz, prekte vrajat e ndryshme, të shkaktuara nga plagët që kishte marrë. E pyesnin shpesh për to, po kjo këtu, po kjo tjetra. Shumica ishin shenja plagosjesh me armë zjarri, prej të cilave vetëm njëra ishte e justifikueshme, pasi ndodhej pranë vendit ku bëhet operacioni për apandesitin, ndërsa të tjerat duhet t'i shpjegonte me durim, varësisht nga këmbëngulja e tjetrës, duke kujtuar edhe historitë që lidheshin me to.

Në dhomë ndodhej vetëm një krevat, që në fakt mund t'i nxinte fare mirë dy vetë, se ishte i gjerë.

Iliri e kishte menduar, do të flinte në poltronin dysh, me këmbët varur. Nuk ishte hera e parë që e bënte. I ndodhte rëndom kur ishte i lodhur, të shtrihej në kolltukun dysh të shtëpisë dhe t'i linte këmbët ca më lart se trupin, që të çlodheshin dhe, ashtu e zinte gjumi.

Iliri kishte dalë nga banja, kishte veshur pizhamet dhe tani po rrinte ulur në shtratin e tij të sajuar, me telekomandë në dorë. Një edicion tjetër lajmesh dhe asgjë mbi situatën e jashtëzakonshme që kalonte vendi.

Silva, ndërkohë, po rregullonte valixhen për nesër; paloste rroba dhe nuk thoshte asnjë fjalë, duke lënë sfondin e zërit të televizorit që të mbushte boshllëkun e krijuar midis tyre. Deshi t'i kërkonte ndjesë që i kishte prishur terezinë, teksa e pa të përshtaste poltronin, me një çarçaf dhe një batanije të palosur si jastëk, por nuk foli.

Ai fiku televizorin, pastaj mori leje dhe shoi edhe dritën e dhomës. Për disa minuta, u përpoq të gjente pozicionin më të mirë për të fjetur, ndërsa Silva kishte nisur të gërhinte lehtë.

11

Një rrugë tjetër

E para u zgjua Silva, nga agu i mëngjesit, ndërsa Iliri, që kishte fjetur paksa më vonë, i hapi sytë teksa dëgjonte çezmën që rridhte. Silva po lante dhëmbët dhe po bënte përgatitjet e rastit për rrugë.

Iliri u ngrit, u vesh shpejt dhe i tha se do të dilte pak, prandaj e ftoi edhe të mbyllte derën me shul. U kthye, aty në prag, dhe i tha:

"Makinën tënde do ta lëmë këtu, edhe për të krijuar idenë që nuk je larguar. Nuk ka ndonjë problem, këtu në hotel është e siguruar. Dakord?"

"Tjetra zgjati kokën nga dera e banjës. E kishte kremin ende të pahapur në fytyrë."

"Kështu thua ti?"

"Po, edhe për një motiv tjetër. Nuk do të marrim autorrugën, prandaj do të na hyjë në punë vetëm xhipi."

"Pse ka rrugë tjetër këndej!" u habit Silva.

"Do ta shohësh!"

Iliri zbriti shkallët, vetëm kur ndeju pas dere zhurmën e llozit. Donte t'i krijonte Silvës një ndjenjë sigurie.

Doli që të bënte gati makinën. Zbriti në oborr dhe u përpoq të kapte ndonjë zhurmë të dyshimtë rrotull. Ndjehej vetëm shushurima e ujit në zallishte dhe ndonjë e kënduar gjeli, larg. Tek-tuk, dëgjoheshin edhe makina që kalonin me shpejtësi në autorrugën përbri, duke lënë atë zhurmën karakteristike në nyjet lidhëse të urës që ngrihej mbi lumë.

Kontrolloi nivelin e vajit dhe të ujit të xhipit dhe hapi një kasetë poshtë ndenjëses së tij ku mbante një armë automatike tip "Tomson". Ishte gjithçka në rregull, siç e kishte lënë.

Mbaroi punë dhe u ngjit lart në dhomën e hotelit, trokiti dhe foli me zë. "Hape, jam unë!"

Silva hapi derën dhe iu shfaq me një veshje sportive, xhinse paksa të zbardhura dhe një bluzë në rozë, me një makijazh të lehtë që e tregonte edhe më të freskët fytyrën e saj të çlodhur nga një gjumë i qetë.

Ai rrëmbeu çantën e tij, në njërën dorë, në tjetrën valixhen e Silvës dhe i la asaj çelësat të mbyllte derën. Silva deshi të shkonte t'i dorëzonte për të dyja dhomat në recepsionin e hotelit, por Iliri e ndali.

"Secili të vetën! Besoj e kupton. Ky poshtë, mbase, e di shumë mirë që kemi fjetur në një dhomë, por ne nuk duhet të kontribuojmë për t'ia vërtetuar hamendjet e tij deri në fund! Dikush do të vijë ta pyesë!"

Lanë çelësat, përshëndetën dhe dolën.

"Më the se ka rrugë tjetër për në kryeqytet. Nga e more vesh kaq papritur?"

“E dija me kohë”, gënjehu ai. “Pastaj, nuk kemi mundësi tjetër, duhet të shmangim ndonjë ndjekje të mundshme. E marr me mend që ish burri yt, Bimi, kështu quhet më duket, tani do të jetë tërbuar. The se është xheloz e tani që na ka parë bashkë nuk e dimë se si mund të reagojë. E pakta, që mund të bëjë është të na ndjekë. Pastaj është i armatosur, përbën një rrezik real për jetën tënde dhe timen. Dhe, kot së koti.”

Silva qeshi.

“Ej, kot u torturove në poltron mbrëmë. Në krevat kishte vend për të dy.”

“Ah, tani ma thua!” qeshi edhe Iliri.

Nga reparti, hoteli mund të kontrollohej për bukuri. Ai po këqyrte me dylbi, nga dritarja e tij e banjës, pa u ekspozuar jashtë që të mos vihej re. Pa xhipin e zbuluar, dhe kokat e atyre të dyve nën strukturën mbrojtëse metalike gri. Flokët e saj lëviznin nga era. Xhipi bëri një kthesë të papritur dhe për çudinë e vrojtuesit nuk mori daljen për në autorrugë, por zbriti poshtë në zall përmes një rruge të pashtruar. Pastaj ai e humbi nga kontrolli.

Disa çaste më vonë, e pa të ngjiste një malore dhe la dylbinë e shkoi shpejt në dhomë. Diçka kishte marrë me mend dhe nuk kishte kohë për të humbur.

Silva filloi të kënaqej me peizazhin në lëvizje, teksa rruga gjarpëronte lart në kodra e brinja. Iliri ishte gati të fliste, u bind se i kishte rënë në të, e kishte gjetur se cila ishte karakteristika kryesore e kësaj rruge, t’i fshihej syve të njerëzve.

Këtë nuk ia tha Silvës.

Ata kishin filluar tanimë të ngjitnin pllaja dhe të linin pas qendra të banuara, sigurisht, por këto vetëm sa merreshin me mend, pasi rrotull nuk dukeshin as shtëpi e as objekte të tjera që të kujtonin se këtu rronin njerëz.

Pas njëzetë minutash, kishin hyrë në një pllajë të ngushtë midis maleve me majat e bardha nga dëbora ende e pashkrirë.

"Ej, Liro! Ku po na çon?" pyeti Silva.

"Shiko pak, hape kasetën, se ka një hartë aty!"

Silva hapi kutinë metalike, mori hartën dhe e shpalosi duke picërruar sytë.

"Çfarë është kjo? Nuk kuptoj asgjë!"

"Është hartë topografike që e përdor ushtria!"

"Nuk marr vesh asnjë gjë!"

"Mos prisje ndonjë navigor satelitar ti!" qeshi Iliri.

"Ku po na çon?" filloi të shqetësohej Silva.

"Mos e vrit mendjen. Do të bësh udhëtimin më të jashtëzakonshëm të jetës tënde. Të siguroj që do të përshkosh një pjesë të madhe të territorit të vendit tënd që ke kujtuar se e njeh, përmes emrash, rrethesh, qendrash të banuara, statistikash, por në fakt, nuk e ke përjetuar asnjëherë nga afër. Dhe nuk do të hasësh rrugës asnjë ndërtim, asnjë banesë..."

"Asnjë stacion karburanti, asnjë dyqan..." e ndërpreu Silva.

"Mos e vrit mendjen, se kam përgatitur gjithçka. Makinën e kam plot me karburant dhe na del deri në fund. Janë vetëm njëqind e pesëdhjetë kilometra, kur me këtë sasi nafte mund të bëjmë deri në katërqind, pa frikë fare. Sa për ushqime, shiko njëherë sediljen e pasme!"

Silva pa dy gaveta të mëdha ushtrie, dy pagure uji, disa konserva mishi dhe bukë të paketuar në celofan.

"Duken racione ushtrie!" tha Silva.

"Janë racione ushtrie! Kjo rrugë është bërë vetëm nga makinat ushtarake dhe është rrahur vetëm nga çizmet e ushtarëve. Qendrat e banuara janë shumë larg dhe për banorët e tyre bëhet e papërdorshme. Është rrugë strategjike e hapur dyzetë vjet më parë nga ushtria. Ky dhé mbi të cilin tani ka mbirë bar, ka njohur vetëm këpucë ushtrie, këndej janë dëgjuar vetëm tinguj paguresh e gavetash për dhjetëra vjet me radhë."

"Lëre, mos fol më, se tani më duket i rashë në të! Ne po ndjekim dikë që ka mbathur, në fakt, këpucë ushtarake. Ndaloje pak shpejtësinë, ja shiko. Kanë mbetur gjurmët!"

"Dallove gjurmë?" pyeti Iliri dhe ndali makinën, duke e siguruar mirë në marshin e parë dhe në frena dore, pasi rruga aty ishte një e tatëpjetë thikë. Zbriti dhe e provoi me këmbën e tij; ishte një këpucë ushtrie e numrit rreth 43.

"Atëherë, nuk paske pasur ndër mend të më shoqëroje mua!"

"Një rrugë e dy punë!"

"Cila është pra, puna e dytë?"

"Ajo për të cilën kemi ardhur në këtë vend. Është e mërkurë, pas dy ditësh Presidenti duhet të udhëtojë i lirë."

"Gegë Toska ka ndërmarrë një marshim të tillë! Si të shkoi ndër mend!" u habit Silva.

"Ishte fare e thjeshtë. Një ish oficer këmbësorie, i përgatitur gjithë jetën për të realizuar një marshim si ky me batalionin e vet, nuk kishte se si të mos e mendonte këtë plan. Nëse ka ndërmend të mbërrijë deri në rezidencën e

Presidentit, nuk ka arsye përse të zgjedhë autorrugën, plot postoblloqe dhe patrulla lëvizëse të policisë."

"E vërtetë!"

Hipën edhe njëherë në makinë. Iliri lëshoi me kujdes frenin e dorës dhe e mbushi mirë me gaz ndërsa lëshonte friksionin. Xhipi bëri përpara i lehtë, sikur të nisej pas një ndalese në semafor.

Silva, atëherë, bëri pyetjen kyçe, që e kishte në majë të gjuhës.

"Përse vendose ta ndjekësh vetëm e nuk njoftove forcat speciale? Aq më tepër që Gega është një kriminel i rrezikshëm dhe i armatosur?"

Përgjigjja nuk ishte e thjeshtë dhe Iliri po bluante në mendje shpjegimin për të. Silva e shikonte me ngulm, pa parë nga rruga. Fytyra e tij u ngrys befas dhe thirri:

"Ulu Silva!"

U dëgjua një breshëri e shkurtër automatiku. Silva u bë njësh me sediljen, ndërsa Iliri vazhdoi të drejtonte makinën. Vuri një dorë në sup dhe ndjeu që ajo iu lag nga gjaku. Ishte plagosur, por ndjente vetëm një djegie si të ishte zhvatur në ndonjë rripë, si dikur fëmijë në shtëpinë e gjyshërve në fshat. I dha gaz makinës dhe hodhi një sy poshtë.

Një xhip tjetër, blu, gjarpëronte me ngulm kthesave poshtë tyre. Iliri duhej të shfrytëzonte mirë rrugën e drejtë për t'u larguar sa më shumë.

Silva nuk e ngrinte kokën. Nuk dinte gjë që Iliri ishte plagosur. Poshtë, nga ku ngjitej makina e policisë, pa bojën e një burri, që nuk e njohu menjëherë, por kjo zgjati vetëm një çast. U ul pastaj e frikësuar dhe bërtiti fort:

"Po na ndjek Bimi!"

“Hape kasetën dhe nxirr automatikun. Është i mbushur, por mos qëllo njëherë. Të provojmë diçka tjetër”

Iliri duke shfrytëzuar atë copë rrugë të sheshtë që vazhdonte për rreth 2 kilometra i dha gaz më shumë xhipit, duke llogaritur që makina ndjekëse të mos i shikonte kur ata të merrnin kthesën e parë.

“Ulu tani!” thirri Iliri dhe Silva po priste të dëgjonte një breshëri tjetër. Por ajo nuk erdhi, makina hyri drejt e në një kaçubë me bimë dredhëse, si të ishte një shpend gjigant që hyn në folenë e tij, në vend që të ndiqte kthesën poshtë, djathtas.

Pritën aty, dy-tri minuta, deri sa u dëgjua uturima e makinës që i ndiqte. Ata e panë qartë tek afrohej përballë. Habia në sytë e Silvës mbizotëroi mbi frikën. Drejt tyre po afrohej një fytyrë e tendosur që në njërën dorë mbante timonin dhe në tjetrën automatikun e shkurtër ‘Tomson’.

“Bim Hyka!” bërtiti Silva dhe Iliri i zuri gojën që të mos dëgjohej. Makina po u vinte përballë dhe Silva mbylli sytë me tmerr duke menduar përplasjen. Por, në momentin e fundit, ajo mori kthesën poshtë djathtas dhe vazhdoi rrugën.

Nuk i kishte vënë re.

Silva u mbështet në supin e Ilirit, pa zbritur nga makina dhe aty u njom nga gjaku.

“Qenke plagosur!”

“E njëmbëdhjeta herë, më duket. Por kjo është më e lehta!”

“Po humb gjak!” tha Silva dhe ngriti pak bluzën, zbuloi kanatieren e bardhë. E grisi në trashësinë e një fashe, pa e hequr nga trupi, derisa pjesa e trikotuar mbaroi dhe ajo futi dorën

nën bluzë duke nxjerrë rripat e fundit, që i flaku tutje pa kujdes. E ndihmoi Ilirin të hiqte bluzën dhe ia lidhi supin me fashat e kanotierës, duke përfunduar me një nyjë në qafë.

Iliri, nga ana e tij, filloi të kërkonte diçka brenda makinës.

Zu të shtypë mbështetësen e sediljes së tij në lartësinë e supit dhe aty pa pastaj një vrimë të vogël. Këqyri edhe pjesën e prapme të shpinores dhe vuri re që plumbi nuk kishte depërtuar, kishte mbetur brenda në sfungjer.

"Silva, provo ti, se i ke gishtat më të hollë!"

Silva rrëmoi me kujdes dhe nxori që aty një plumb, kalibër pistolete TB.

"Këta automatikë përdorin përdorin fishekë pistolete TB"

Ra heshtje. Dielli ishte ngritur mirë në horizont, por mbi kokat e tyre ai filtronte paksa nëpër gjethet e shpeshta të kulprave që dukeshin si ato maskimet që u bëheshin makinave ushtarake.

Ata nuk po lëviznin nga vendi edhe pse e dinin që nuk kishin shumë kohë. Silva zgjati dorën dhe mori paguret. Me një leckë të lagur, filloi t'i pastronte gjakun nga trupi Ilirit. Ca pika, tanimë në ngjyrë si vishnje, i kishin rënë edhe në pantallona.

Nuk kishin shumë kohë për të humbur. Pinë ujë dhe normalizuan frymëmarrjet, pastaj Iliri i dha makinës mbrapsht, duke dalë nga guva.

"Do të kthehemi, Liro!"

"Jo."

"Do të vazhdojmë përpara, atëherë. Po, a nuk ka rrezik? Thua të ketë pasur vetëm një shpërthim inati, nga xhelozia?"

“Një shpërthim me armë, një plan për të na eliminuar! Ka dalë zbuluar dhe shumë shpejt, ky Bim Hyka!”

“Atëherë? As nuk do të kthehemi dhe as nuk do të vazhdojmë? Çfarë do të bëjmë pra, do të fshihemi këtu në pyll?”

Iliri nuk u përgjigj menjëherë. Pastaj mprehu veshët.

“Çfarë? Po dëgjon gjë?” pyeti Silva e frikësuar.

“Ka mundësi që ai të kthehet shpejt. Nuk shikon më gjurmë të rrotave të makinës sonë dhe kthehet. Vetëm, nëse ka menduar ndonjë plan tjetër. Shkon të eliminojë Gegën dhe pastaj luan me faktin e kryer. Qëllimi u arrit, të tjerat janë pakujdesi, ‘shpërthime xhelozie’, siç i quajte ti. Të gjithë festojnë, atentatori u ekzekutua!”

Iliri mori në dorë hartën topografike të terrenit dhe filloi ta studiojë me vëmendje, derisa vendosi diçka.

“Po,” i tha Silvës, “ke të drejtë! As nuk do të vazhdojmë më tutje, e as nuk do të kthehemi pas. Do të zhvendosemi pak anash, nja dhjetë kilometra. Shiko këtu!”

Ai shpalosi edhe një herë hartën. “Jemi pranë qytezës Ujëmirë, pa e ditur se si. Na duhet vetëm të kalojmë në fillim këtë zonën pyjore. Shiko shenjën e pishave në hartë, pastaj janë disa plantacione pemëtarie. Shikoji shenjat konvencionale.”

“Unë nuk marr vesh asgjë nga këto. Por vetëm një gjë di të them. Nuk po më flet për asnjë rrugë. Nuk do të ecim në këmbë, apo jo?” ndërhyri Silva.

“Nuk do të ecim në këmbë! Na duhet besim, si fillim, por edhe fat! Tek e fundit, po nuk ia dolëm, do të braktisim makinën. Nuk është puna se i trembemi një përballjeje me Bim Hykën. Shanset

me të i kemi të barabarta, madje më të mëdha, sepse ne jemi dy, ai është një. Puna është se nuk duhet të veprojmë në favor të planit të tij."

"Dëgjo, nuk dua më krisma unë. Po më duket vetja si në film. Kurrë nuk do ta kisha imagjinuar vetën në një situatë si kjo. Të lutem, të ikim sa më parë!"

Dhe u nisën. Në fillim në kërkim të pyllit me pisha.

12

Një vizitë e deputetit

Po atë të mërkurë paradite, deputeti Nosh Gjetani vendosi të bënte një vizitë në rezidencën presidenciale.

Kishte lënë herët Sektorin dhe kishte marrë autorrugën A2 në drejtim të kryeqytetit. Provoi disa herë të lidhej me komandantin e njësisë speciale "Ujku" Bim Hyka, por pa dobi. Telefoni i tij celular nuk kapte valë, si duket. Megjithatë, nuk dukej i shqetësuar. Kishte edhe njerëz të tjerë me të cilët mund të merrej vesh. Edhe Bimi do të telefononte sapo të shikonte thirrjet, në një zonë ku mbërrinin valët, pranë ndonjë qendre të banuar, ku ka antena përforcuese.

Ai mbërriti në presidencë më parë se telefonata e Bim Hykës. Rojet, që e njihnin, megjithatë, e kontrolluan, por pastaj ia lanë pistoletën. Të gjithë deputetët ishin të armatosur, por një pjesë e tyre nuk mbante armë me vete, ndryshe nga Nosh Gjetani.

Donte të shkonte në Presidencë që t'i siguronte ata se punët ishin vënë në vijë.

Me Tefta Tufanin, nuk kishte pasur në fakt marrëdhënie të shkëlqyera, si aktiviste partie, përpara se ajo të bëhej gruaja e Presidentit. E njëjta gjë mund të thuhej edhe për Zamirin, për sa kohë ky ishte shef organizativ i partisë. Noshi kritikohej për cilësinë e prurjeve në parti. Sipas tyre, ai afronte aktivistë me integritet të dyshimtë moral. Por kjo ishte një periudhë kalimtare dhe mbeti në kuadrin e simpative dhe antipative, pasi më vonë rezultoi që prurjet e deputetit Nosh Gjetani, i hynë goxha në punë partisë dhe atij vetë, pasi arriti të zgjidhej në tre legjislatura radhazi. Nga ana tjetër, ishin njerëzit e tij ata që formonin rreshtat e para të manifestuesve, gjatë protestave kur partia u detyrua të qëndrojë në opozitë.

Periudha e fushatës për t'u zgjedhur president, si brenda partisë dhe më tej në parlament, brenda grupit të deputetëve, sigurisht nuk do të favorizonte përplasjet parimore midis dy korrenteve në parti, por do t'i zbuste e fashiste, të paktën deri në një kohë tjetër. Me orientim partie, edhe ai e kishte votuar kandidaturën e Zamir Tufanit në parlament, pasi pëshpëritej se kjo bëhej me urdhër nga lart, më shumë për ta larguar atë nga postet drejtuese të partisë. Flitej për një strategji të emërimit të tij në një post, në dukje të rëndësishëm, por që në një sistem të republikës parlamentare, e humbte peshën e tij vendimmarrëse. Dhe koha po e vërtetonte këtë. Tani pas tre vjetësh, presidenti po përpiqej të luftonte për të thënë fjalën e tij në reformat në drejtësi, por shpesh gjente kundërshtimin e parlamentit që komandohej nga dora e fortë e partisë.

Mirëpo, deputeti Nosh Gjetani kishte gjetur një mënyrë për t'u afruar me familjen presidenciale. Ndihmoi Teftën, Zonjën e Parë, që të ingranohej me punët e saj të bamirësisë, siç bëjnë rëndom gratë e këtij rangu. Kishte gjetur financime nga UNICEF dhe me to kishin ndërtuar një shtëpi për fëmijët e mbetur jetimë nga gjakmarrja. Që në fillim, qe treguar i gatshëm të bashkëpunonte edhe me Presidentin, duke bërë që këshilltari i tij Arben Bardhi të merrte pjesë në Kuvendin e Pajtimit, dy vjet më parë, zhvilluar në Logun e Zanave, në të cilin ishin marrë vendime për t'u përshëndetur në lidhje me gratë dhe fëmijët.

Shkurt, Nosh Gjetani këtu ndihej si në familjen e tij. Me të hyrë brenda, rregulloi pak këllëfin e brendshëm ku mbante pistoletën, se e vriste pak. Përshkoi pastaj sallonin e gjerë, të njohur për të gjithë nga kronikat e takimeve të personaliteteve të huaja në presidencë. Aty, po bënin mësim dy fëmijët, si në ato klasat e përziera, pasi Indriti ishte katërmbëdhjetë dhe po mbaronte klasën e tetë, ndërsa Vesa ishte njëmbëdhjetë vjeç dhe ishte në mbyllje të klasës së pestë.

Tefta e ndërpreu mësimin dhe u dha fëmijëve pesë minuta pushim, pastaj u shkëput me Noshin. Nuk deshi të bënte porosi dhe përgatiti vetë dy kafe të shpejta nga një ekspres në korridor, nga ato që përdoren rëndom në mjediset e zyrave.

"Hë, ke ndonjë të re? Edhe sa kohë do të rrimë kështu?" pyeti Tefta.

"Pres një telefonatë. Duket se kemi rënë në gjurmë të vrasësit!"

"Ai i ziu është, që i kanë vrarë fëmijët?"

"Kështu duket. Janë ekspertët që e kanë identifikuar." tha deputeti.

“Do ta vrasin të ziun? Di gjë ti?”

“Është i armatosur. E ka përcaktuar vetë fatin e tij.”

Po gjerbnin kafetë në heshtje, ndërsa nga salloni vinin zhurmat e dy fëmijëve që luanin gjithë potere.

“Po ai, si është?” pyeti Noshi.

“Nuk flitet me të. I ndryrë në zyrë, nuk ka dëshirë t’i kalojnë qoftë edhe një telefonatë. Mund t’i shtynim më ndryshe këto ditë, edhe pse të ndryrë në katër muret.”

“I ke parë gazetat sot?” pyeti sërish Noshi.

“Bravo ju qoftë! Kishit bërë arrestime në Sektor. Gjithë ata fëmijë të lirë. Pashë edhe një kronikë në televizor, pak përpara se të filloja mësimin.”

“Mirë në Sektor, po kjo fushatë po shtrihet në të gjithë vendin. Shiko këtu!”

Ai i la në dorë një të përditshme të njohur që e kishte mbushur njërën nga faqet e brendshme plot me kronika mbi arrestime. Brenda dy ditësh, të hënën dhe të martën, thuhej në editorialin e gazetës, ishin liruar 720 fëmijë.

“Është spontane kjo fushatë, apo e organizuar?” pyeti Tefta.

“Këtë desha të di edhe unë. Duket sikur kjo punë është krejt e thjeshtë. Paskemi punuar kot, me misionarë e ndërmjetës për të pajtuar njerëzit gjithë këto vite! Edhe misionarë kanë arrestuar! Prite kur të reagojë Prekë Prela, tani. Nuk kalon kaq lisho kjo punë!”

“Secili bën punën e vet! Mjafton të respektohen ligjet!” tha Tefta.

Noshi nuk e zgjati. U ngrit dhe filloi të këqyrte me vëmendje gjithçka, sidomos dritaret e ngushtuara, por nuk bëri koment.

“Ai nuk pret njeri, më the, je e sigurt?” ndërhyri Noshi papritur dhe rregulloi xhaketën e lehtë verore të fryrë në anën e majtë ku mbante pistoletën.

I ra celulari dhe ai i turbulluar çoi dorën tek pistoleta, në fillim, pastaj u kujtua dhe u skuq i tëri. Kontrolloi në xhepin tjetër. Ishte telefonata që priste. Bëri disa hapa më larg dhe vuri telefonin në vesh. Ndiqte informacionin që i vinte me një fytyrë të pandjeshme.

“Ende nuk ka asgjë të re!” tha si mbaroi bisedën dhe për herë të dytë gaboi xhepin. Kërkoi të fuste celularin në xhepin ku mbante armën.

Më pas, ndenji pak, përshëndeti dhe u largua, ndërsa Tefta vazhdoi me orën tjetër të mësimit, e habitur me hutimin e Noshit, por vetëm kaq.

E kuptonte shqetësimin e tij në një situatë si kjo.

13

Edhe një herë për qendrën e rëndesës

Makina “Jeep Wrangler” me një motor diezel 2500 kuaj fuqi, ishte mjeti i duhur që mund të nxiste të ndërmerrje një aventurë të tillë.

Pylli me pisha ishte një labirint i vërtetë. Drurët e lartë dhe të drejtë, përfundonin në majë me ca kurora jeshile, të cilat krijonin bashkë një shtresë të gjelbër, gati të padepërtueshme.

Silva po merrte frymë me gjithë mushkëritë, në një gjendje ekstaze, me sytë mbyllur, kur makina frenoi në vend, përpara një trungu të hatashëm, fare pranë dy trungjeve të tjerë më të vegjël, por që nuk të linin të kaloje.

Iliri po studionte një mënyrë për të dalë nga ai kurth. Provoi të ecte mbrapsht, pasi makina përpara e kishte turirin më të dalë, me një zgjatim tjetër të parakolpit. Nga prapa, gomat vinin dyst me fundin e karrocerisë dhe mund të brendashkruanin një hark më të vogël.

Bim Hyka, u kthye vetëm një çerek ore pasi ata ishin nisur, në vendin ku i ishte zhdukur nga sytë

makina e tyre. Ishte i bindur se e kishte qëlluar shoferin, të cilit në një moment të parë makina i kishte ikur nga kontrolli, duke bërë lakadredha në rrugë. Më pas, inspektori e kishte marrë ca veten, por siç duket e kishte tepruar me shpejtësinë e madhe dhe kishte dalë fare nga rruga.

Ky iu duk arsyetimi më i pranueshëm, tek kontrolloi për më shumë se njëzetë minuta rrotull vendit ku e kishte parë makinën për herë të fundit. Mori edhe një herë rrugën drejt jugut, në ndjekje të Gegë Toskës, kur sytë i vajtën tek diçka e bardhë, ngecur mbi kurorën e gjelbër të dredhëzave, pikërisht në strehën ku ishte fshehur më parë xhipi. Nuk e kishte futur ende marshin. Zbriti dhe pa ca rripa kanotiereje të mbledhura shuk, pastaj një shtypë me gjak, të hedhur përtokë. Pak më parë, u duk më i qetë me atë idenë e paqartë mbi fatin e tyre. Mund të kishin rënë në humnerë, mund të ishin fshehur diku. Kurse tani, ideja që iu krijua në kokë ishte arratia e tyre, bashkë. Ai i plagosur, ajo që i mjekonte plagët. Nuk u ndje mirë. Shtrëngoi dhëmbët dhe përplasi fort derën e makinës së tij të lënë hapur, pak më parë. Vetëm për të bërë zhurmë. Ta dinin mirë që ai ishte kthyer dhe kishte ndër mend t'i ndiqte.

Deshi të çajë nën strehën me bimët dredhëse, por vajti e ngatërrua keqas, i lidhur kokë e këmbë, nga padurimi. Nxori një kamë të dhëmbëzuar dhe i preu ato, gjithë inat. Bëri përpara. Mori nga xhepi i djathtë i pantallonave një karikator tjetër dhe e montoi në armë, gjithë zhurmë. Dukej më i xhindosur se kurrë. Deshi të bërtasë, t'i shajë me zë të lartë, por ndërroi taktikë. Do të ishte më mirë të përpiqej t'i kapte në befasi. U pengua edhe një herë dhe ra në një rrjedhë uji të padukshme,

poshtë bimëve. Iu mbushën këpucët plot dhe moti nuk ishte shumë i ngrohtë. Ajri ishte i freskët dhe temperatura nuk i kalonte të 15 gradët, në atë lartësi. Uji i akullt i drodhi shtatin. I përplasi këmbët, bëri ca hapa, cuq-cuq, me ujin që dilte nga vrimat e lidhëseve në currila, por nuk u kthye mbrapa.

Pa një pyll me pisha të larta, me trungje pranë njeri-tjetrit dhe halat e tyre të thara përtokë, që krijonin një shtresë të sfungjertë.

Ishte pylli në të cilin sapo kishin kaluar ata.

U përpoq të gjejë gjurmë. Bëri një provë; mëshoi me këpucët e veta mbi shtresën me hala pishe, hoqi këmbën dhe pa se si shtresa e shtypur pak erdhi sërish në vend, sikur të mos qe shkelur fare. Edhe gomat dimërore të xhipit me ato dhëmbëzat, nuk ndryshonin shumë nga një këpucë ushtarake.

E vazhdoi kërkimin nëpër pyll, drurë pas drurësh, pastaj e kuptoi. Ishte sjellë rrotull kot së koti, pa mundur të gjejë një rrugëdalje. Duhej busull dhe ai nuk e kishte me vete. Por, më pas, filloi të orientohej nga një reze dielli që çante diku, nga duhet të ishte perëndimi.

Doli më në fund dhe këqyri rrotull me kujdes.

Fati e donte që në atë çast, ata kishin fikur makinën dhe po studionin mënyrën se si do të vazhdonin me tutje. Iliri e pa. Ishte vetëm tridhjetë metra më tutje, duke shikuar, me dorën e vënë si strehë, për t'u mbrojtur nga dielli. Silvës i bëri një "shët" të lehtë dhe të dy u ulën.

"Pe gjë?" e pyeti ajo. "Mos është afër, na ka drejtuar automatikun?!"

Iliri bëri një jo me me gisht. Nuk i tregoi gjë. Edhe më vonë. I tha vetëm se i kishin bërë veshët dhe se, tek e fundit, duhet të ishin të kujdesshëm.

Ndërsa, me bisht të syrit, pa se si ai u tërhoq edhe një herë në pyll dhe u zhduk.

Kishin shpenzuar dy orë të mira vetëm për të përshkuar pyllin. Kjo do të thoshte se kishte kaluar shumë kohë. Ata, duhet të mbërrinin në qytezën e treguar në hartë, përpara se të binte nata.

Më pas, u gjendën në një qafë, pas së cilës vinte pemishtja. Aty sigurisht që kishin hyrë mjete, edhe pse këto kishin qenë vetëm makineri bujqësore dhe prandaj besonin që do ta kishin më të lehtë.

Ishin në majën e një faqeje kodrinore, e cila kishte nëntë rrathë tarracash, deri poshtë në një rrugë bujqësore, që të shpinte më pas buzë një lumi. Por, të zbritje deri atje, me makinë, ishte një çmenduri. Në fakt, ishte vërtet një plantacion mollësh, siç e kishin vënë re, më parë në hartë. Por tarracat nuk e kishin më atë rregullsinë e dikurshme dhe rrënjët e mollëve, të detyronin të kaloje me një gomë lart në skarpatë, duke rrezikuar përmbysjen. Përpara se të nisej, Iliri i shpjegoi Silvës aparatin që maste qendrën e rëndesës, pikën në të cilën makina mund të përmbysej. Pastaj, u kujtua që po i kallte tmerrin dhe i tha.

"Po, dëgjo. Ti fare mirë, mund të zbresësh anash, në këmbë. Unë do të përpiqem t'ia dal vetë, gjithmonë me të drejtën e braktisjes së mjetit, nëse kjo nuk është e mundur."

"Jo, në këtë rast, do të rrimë bashkë në makinë. Dhe e di përse?"

Iliri filloi ta shikojë me një vështrim pyetës. 'Ku e ka hallin, kjo, or vlla'. Në fakt ishte gabuar në hamendjen e tij prej mashkulli, të paktën në atë çast.

“Për kundrapeshë! Duhem edhe unë, patjetër, që të rëndoj sa në një krah në tjetrin.”

“Po, ke të drejtë. Po nuk ke frikë?”

“Më mirë mos fol, mos u tall të paktën, se më duket vetja në ëndërr, jam si në një makth. Është e tmerrshme! Të ndjekin për të vrarë dhe nuk ke nga t’ia mbash! Mos fol më për frikë, hë të keqen, po fillo më mirë zbritjen!”

Poshtë, natyra kishte ofruar një perëndim të mrekullueshëm. Që këtu, dukej paksa deti, një vijë e kuqërremtë, që të kujtonte një pjesë të hartës së vendit, të cilën e kishe mësuar gjithë jetën në shkollë, e kishe parë në emisionet e përditshme të motit.

Lulet e mollës lëshonin një aromë dehëse dhe dukeshin si dritëza pasi reflektonin rrezet e diellit që po perëndonte.

Morën spiralin e parë. Makina anonte poshtë nga krahu i shoferit, kështu që Silva duhet të rrinte në vendin e saj. Ishte Iliri që duhej t’i afrohej dhe e bëri. Ajo e pa e çuditur. ‘Po ky, çdo ky’ tha me vete. Iliri e nuhati që ajo u keqkuptua dhe i kujtoi kundërpeshën.

“Harrove, këtë veprim do të bëjmë me radhë derisa të zbresim kodrën.” Iu afrua shumë, por nuk e preku, ndjeu aromën e njohur të parfumit të saj, me të cilin po mësohej ato ditë. Parfumi nën aromën e fortë të luleve të mollës, davaritej, në fakt. E ndjente vetëm tani që i afrohej.

Momenti i kthesës për të marrë spiralin e dytë, një nivel më poshtë, ishte më i vështiri. E lëshoi makinën në rrëshqitje, të bllokuar edhe me frena dore, për dy metra dhe pastaj preu timonin. Ndjeu edhe një herë erën e saj mbi aromën e mollëve. U habit, se si i doli nga mendja edhe atij, kaq shpejt dhe qeshi. Silva iu ngjesh e tëra, se kishte frikë.

Iliri ishte përkulur në maksimum, tani majtas në drejtim të skarpatës. Aparati i nivelit të pikës së forcës së rëndesës, preku vijën e kuqe.

"Edhe pak, mos ki frikë!" i tha zemër Iliri. Po e kaloi vijën, e lëmë makinën të bjerë poshtë, hidhemi pa problem. Për fat, është edhe e zbuluar, pa dyer. Edhe pak, ashtu. Hë se dolëm."

Në spiralin e tretë, u duk se ai iu ngjesh i tëri, duke u palosur mbi të nga ana e pasagjerit, por ky ishte vetëm një iluzion, pasi dora e tij e djathtë mbahej fort në shpinoren e ndenjëses së saj.

Kështu i zbritën të nëntë nivelet, derisa ranë në rrugën e sheshtë. Ndaluan pak dhe mblodhën veten, duke rregulluar frymëmarrjet.

Dhe, për herë të parë, gjatë njohjes së tyre të shkurtër, u përqafuan. Silvës i shpëtuan lot, e çliruar më në fund nga një barrë kaq e rëndë.

14

Një ndarje

Kishte rënë nata. Ecën për njëzetë minuta, me ritmin e hapit njerëzor, derisa panë dritat e një banese. Nuk kishin ndër mend të ndalonin; ajo dritë mjaftoi që t'u ngrinte paksa moralin.

Pak e nga pak, rruga ishte kthyer në kalldrëm, pastaj në asfalt, më vonë në shëtitore.

Një tabelë njoftonte se kishin mbërritur në Ujëmirë, ndërsa një kthesë majtas, do t'i çonte në qendër. Një kartelë tjetër, tani në ngjyrë kafe, tregonte një hotel me tre yje. Ecën në atë drejtim dhe shquan më në fund dritat në majën e një ndërtese pesë katëshe, 'Hotel Udhëtari'.

Iliri shqoi edhe tabelë tjetër, në ngjyrë jeshile, e cila shënonte drejtimin për të marrë autorrugën A2. Ndërsa Silva, filloi të rrëmojë në çantë për të nxjerrë celularin i cili sapo dha sinjal se kishin hyrë valët, por u fik pastaj menjëherë se i ra bateria.

Në situata të ngjashme, njerëzit u sillkan njësoj. Ishte ora tetë e mbrëmjes. Tanimë, kishin

porositur secili nga një dhomë dhe po kryenin pothuaj veprime në sinkron, edhe pse nuk e shikonin njëri-tjetrin.

Së pari, nxorën celularët dhe i futën në priza, për t'u karikuar bateritë dhe pavarësisht nga tingujt e pandërprerë të mesazheve, asnjeri prej tyre nuk denjoi t'ua hidhte sytë, aty për aty.

Hynë në dush dhe e lanë veten për minuta të tëra në ujët e ngrohtë.

Dolën nga dushet të çlodhur dhe atëherë, u kujtuan për celularët, të cilët i kthyen edhe një herë në botën e tyre të zakonshme.

Silva kishte shumë thirrje të humbura, të gjitha nga Arben Bardhi, këshilltari i Presidentit, kështu që shkoi tek emri i tij, i pari në listën e saj, se fillonte edhe me A, e shtypi tastin jeshil dhe priti.

"Më bëre merak," tha zëri i kolonelit.

"Merak?! Ta dish ti se çfarë kemi hequr sot, ne..."

"Ne? Pse me cilin ke qenë!" pyeti këshilltari.

"Ej, nuk je në rregull më duket! Pyet njëherë se çfarë të ka ndodhur, pastaj të tjerat."

"Hë, si është puna?" pyeti koloneli.

"Përse më ke sjellë deri këtu? A e dije mirë se ku po më dërgoje?"

"Unë vetëm sa të tregova gjendjen, ti kërkove vetë të niseshe. Përse ma vë mua fajin? Po, hë fol tani, çfarë të ka ndodhur?"

"E dije ti, që në Sektor do të gjeja Bimin?"

"Bim Hyka në Sektor? Çdo ai në Sektor? Të ka ndjekur?"

"Jo, ai ka ardhur përpara meje, me forcat e para që u dërguan me helikopter, të shtunën në darkë. Unë po bëj tre ditë, që nga e hëna në mëngjes. Harrove ti?"

“Dhe gjithë këtë kohë, nuk jeni parë fare!”

“Jo, vetëm dje e pashë. Sot më ndoqi, shpëtova kot, së koti.”

“Më fal, po paske qenë vetëm, atëherë?”

“Jo, jo. Bashkë me inspektor Ilir Martinin. Besoj e njeh?”

“Po, kam folur edhe me të para se të nisej. I kam kërkuar që të kujdeset edhe për ty.”

“Nëse është dërguar këtu për këtë punë, po ta them se e ka bërë për mrekulli.”

“Përse, punët e tjera nuk po ju ecin? Unë, mendoj ndryshe. Keni vepruar në drejtimin e duhur. I lexoni gazetat ju. Kanë dalë nga ngujimi gjithë ato familje, edhe në krahina të tjera. Ju, për mua e keni kryer punën tuaj në Sektor!”

“Po mirë, këtu mbaron gjithçka, sipas teje? Po presidenti?”

“Jo, presidenti mbetet i ngujuar! Hajt, se do flasim! Ruaj veten hë, kujdes! Do ta ndërpresim këtu, se po më thërrasin në celularin tjetër. Duket diçka serioze. Do të sqaroj më vonë. Mirupafshim!”

Silva u duk e çliruar pas kësaj bisede. Ndjeu se ekzistonte. Vajti përpara pasqyrës dhe filloi të bëjë tualetin e saj të lehtë dhe në fillim me mend, pastaj me zë, filloi të këndojë një motiv kënge fëmijësh, nga ato që këndohen në kopësht, pa e pasur mendjen fare.

Edhe Iliri e mbylli bisedën e tij. Kishte lënë një takim me major Tomë Keqin, zëvendësin e Kin Uldedës. E ndjente vetën shumë të vonuar për hetimet. Dhe po bëhej gati të nisej edhe një herë. Toma i kishte folur në telefon për një kallëzim që Gegë Toska e kishte depozituar, dy ditë përpara vrasjes së fëmijëve në polici. Kallëzimi nuk ishte marrë në shqyrtim, se ngjarjet ishin rrokullisur

shpejt dhe nuk i kishin lënë kohë Kin Uldedës të vepronte. Këtë radhë, Iliri doli i parruar, me atë mjekrën njëditëshe që e tregonte më të madh në moshë. Silva kishte zbritur në holl e para dhe po e priste. Nuk kishte dashur ta shqetësonte dhe kishte zbritur shkallët, pa trokitur më parë në dhomën e tij. Porositën kafe kësaj radhe, edhe Iliri që nuk e vinte kurrë në gojë. Më pas, sërish të njëjtat gjëra si një natë më parë, Iliri një raki qershie, Silva një lëng frutash. Më vonë u erdhi edhe darka, e gatur në çast, taze; bërxollë gici, sallatë jeshile dhe birrë, si dhe një salcë vendi të përgatitur me kos dhe fruta. Një e ngrënë disi e rëndë, por të shtosh pjatat me makarona që i përpinë në fillim, mirëpo pas asaj që kishin kaluar, gjithçka dukej e natyrshme. U duk se gjithçka mbyllej këtu. Tani do të shkonin në shtretërit e tyre të pastër dhe do të çlodheshin, pastaj do të përpiqeshin të flinin, do të shikonin ca ëndrra të ankthshme me rrëzime e të shtëna armësh...

Por, për Ilirin e gjitha kjo do të do të ishte një luks i vërtetë. Ishte mbrëmja e së mërkurës, të nesërmen ishte e enjte, dita e fundit e vlefshme për të bërë diçka, se pastaj do të vinte e premtja fatale, mbase.

"Do të iki që sonte në Sektor. Kthehem vonë!" i tha Iliri pasi rrëkëlleu krikllën e birrës me një frymë.

Silva u mërzit, por nuk e dha veten. Nuk ishte më frika, por ky ritëm marramendës që nuk e linte të arsyetonte dhe i sillte një gjendje boshi, ku nuk arrinte më të gjente vetveten.

"Ti e di, vetëm ruaj veten! Çudi, si erdhën këto punë. Kurrë nuk i kisha menduar kaq të ndërlikuara!"

“Duro edhe pak Silva, se tani po qartësohen. Filli i parë i lëmshit u zgjidh...”

Iliri u ngrit dhe shkoi tek banaku për të paguar.

“Nuk po humbas kohë, atëherë. Mos më prit. Nuk dihet sa vonohem. Mirupafshim, nesër!” i tha Iliri në derë, ndërsa Silva ndenji ulur me sytë mbyllur duke pritur zhurmën e njohur të motorit diezel, që i dukej gjithmonë sikur thyente arra.

Zhurma e motorit shuhej ngadalë dhe ajo filloi të ndjehej më e qetë. Vendosi të dalë për një shëtitje nëpër rrugët e qytezës.

15

Takimi i parë

Gegë Toska nuk po u besonte syve. Kishte hapur dritaren e katit të katërt të hotelit alpin. Aty, kishte kaluar natën e parë në një shtrat të vërtetë, që të hënën kur ishte detyruar të largohej përfundimisht nga Sektori.

Shikonte tutje, nga dukeshin në largësi liqenet, më saktë gjashtë prej tyre, pasi i shtati, ishte i vendosur në një lartësi më të madhe, prapa në drejtimin lindor të hotelit. Nën kurorat e pishave shquheshin pasqyrat e tyre që zunë të reflektonin rrezet e para të diellit.

Kishte ulur sytë, pastaj, pak më poshtë. Dhe kishte parë makinën e tij në parking. E njihte shumë mirë atë makinë dhe njeriun që e drejtonte. Që prej të shtunës, më 13 mars, nuk po i ndahej. Gega nuk u besonte syve. As që e kishte marrë me mend se ai do ta ndiqte edhe në këtë rrugë. Kishte bërë gjithçka, që marshimi i tij të ishte i fshehtë. Edhe makina e tij e lënë buzë autorrugës, këtë qëllim kishte pasur.

U fut brenda me shpejtësi, bëri gati çantën e shpinës, mori gavetën e mbushur me ushqim që mbrëmë, mbushi edhe paguren me ujë në çezmë dhe zbriti shkallët.

Nuk i kishin kërkuar asnjë dokument në sportel, mbrëmjen e shkuar, kur kishte parapaguar dhomën, por i kishin lëshuar menjëherë çelësat në dorë. Edhe tani nuk kishte pse ndalej, mund të dilte turravrap përjashta dhe të riniste pastaj marshimin, larg në atë terrenin e tij të dashur.

Disa hapa në holl, porta automatike me fotocelula u hap sapo trupi i tij u afrua, kur tre policë i dolën përpara dhe i prenë rrugën. Nuk i kishte vënë re nën refleksin e xhamave të portës, përndryshe do të kthehej në kohë dhe do të gjente një rrugëdalje tjetër.

"Dokumentat!" i foli njëri prej tyre, më i madh në moshë dhe në gradë.

"Kam paguar rregullisht," tha Gega, pyesni në sportel.

"Jeni regjistruar?"

"Jo, nuk ma kërkoi njeri! Porosita një dhomë, pagova dhe kaq."

"Eja me ne!" tha shefi i tyre.

Ndërkohë, drejt tij po afrohej vetë ai, Bim Hyka. Kishte qenë ulur në njërin nga poltronët e hollit, duke ndjekur gjithë skenën.

Formoi një numër, duke iu zgërdhirë Gegës mu në fytyrë.

"E kapëm! E kam këtu në duart e mia!"

E qeshura ia tërhiqte të gjithë muskujt dhe zbulonte një shprehje të pa vënë re më parë në çehren e tij, nga shumëkush.

"Po, po, tani e di vetë se ç'bëj me të!" e siguroi edhe njëherë Bimi bashkëbiseduesin.

Gega i dëgjoi fjalët e fundit. Duhej të merrte një vendim. Të tentonte t'u ikte policëve. Kjo nuk mund të bëhej, se do të qëllohej menjëherë nga Bim Hyka që i kishte duart në xhepin e pantallonave, ku me siguri kishte futur pistoletën. Ai, armën e tij për fat e kishte fshehur në pyll, poshtë rrënjëve të një shkoze. Të paktën, tani në polici, nuk do të fillonin verifikimet pa fund për të mbi armën, po ta kishte me vete, edhe pse e mbante me leje.

Bim Hyka i ndiqte në distancë dhe kur shefi i skuadrës së policëve që e kishin vënë në mes, e vuri re interesimin e tij të tepruar, i tha të largohej. Ky fakt, e qetësoi pa masë Gegën. 'Nuk qenka Bimi atëherë që ka kallëzuar. Mbase, do të ketë qenë i zoti i hotelit. Më ka parë kështu, si kaçak mali dhe ka dyshuar, me të drejtë'.

Në stacionin e policisë, Gega e kuptoi që do të ishte më mirë për të që ta mbanin sa më shumë brenda. Dha emrin e mbiemrin e saktë, vendbanimin, profesionin dhe tregoi që i kishin vrarë dy fëmijë. Priti që policët ta ndalonin, si njeri të superkëkruar, por për habinë e tij ata u mallëngjyen. Kishin lexuar gazetat dhe e dinin mirë historinë e vrasjes së fëmijëve të tij.

Por vetëm kaq. Duket se çështja e tij ishte sekret shtetëror, madje një sekret i fshehur më së miri në një rreth tepër të ngushtë, përderisa një stacion policie vetëm 30 kilometra larg Sektorit nuk dinte asgjë për atë që kishte ndodhur aty realisht, por merreshin vetëm me gazetat.

E lanë të lirë.

Më pas, shefi i stacionit të policisë së komunës Liqene, i telefonoi për kureshtje homologut të tij në Sektor. Iu përgjigj zëvendësi, Tomë Keqi, i cili

vazhdonte të bisedonte në ato çaste me inspektor Ilirin.

"Po, keni kapur Gegë Toskën? Mbajeni aty! Çfarë? E keni liruar?"

Toma pa nga Iliri, për të komunikuar me të me sy. Ky i belbëzoi: "Thuaju që ta ndjekin dhe ta kapin me çdo kusht!"

"Po, ndiqeni! Na duhet patjetër!"

Toma e vazhdoi bisedën me ta, edhe për disa minuta, gjatë të cilave dëgjonte shpjegimet e tyre dhe ia përcillte fije për pe, Ilirit.

Një natë më parë, në zyrën e major Tomës, inspektor Iliri kishte pasur mundësi të njihej me një material kyç në zbardhjen e çështjes së Sektorit, proces-verbalin e kallëzimit që kishte bërë dy ditë përpara vrasjes së fëmijëve të tij, Gegë Toska. Ishte dokumenti që duhet ta kishte pasur në dispozicion që të hënën, gjatë takimit që do të zhvillonte me Kin Uldedën, dhjetë minuta përpara se ky të vritej.

Nuk u kishte besuar syve. Në kallëzimin e Gegës flitej edhe për një tarifë gjaku. Në thelb, ai kallëzonte në polici ndërmjetësin Palokë Lleshi, sepse i kishte kërkuar 20 mijë Euro, 5 mijë për frymë, me kusht që të ndërmjetësonte pastaj për ta nxjerrë atë nga ngujimi, bashkë me familjen.

Shpjegonte më pas, që ia kishte kërkuar këtë shumë parash nipit të tij, Luan Pepa, me një letër dërguar në burg, por në vend të përgjigjes i kishte ardhur, të mërkurën, tre ditë para vrasjes së fëmijëve, një furgon i policisë së burgjeve. E kishin marrë dhe e kishin dërguar të shikonte trupin e varur të nipit të tij. Policët, i kishin tundur Gegës letrën në fytyrë, duke e akuzuar si shkaktar të gjestit ekstrem të nipit. Dhe, Gega, atëherë, ishte

detyruar të zbulonte të vërtetën, të deklaronte që një farë Palokë Lleshi, misionar i pajtimit të gjaqeve në krahinë, i kishte kërkuar para në këmbim të lirisë.

Pas kallëzimit me shkrim, një ditë më vonë, të enjten, përpara Kin Uldedës, Gega ishte ndjerë i çliruar nga një barrë e rëndë. Tek ai, kishte ngritur krye qytetari, që ka besim tek shtetit i tij.

Kjo ndjesi sigurie i ishte përforcuar edhe më shumë kur në derë i kishte ardhur vetë Nikë Camaj. Ishte bërë hasmi i tij, që prej një viti, ai që më parë kishte qenë një nga miqtë e tij më të afërt. Nuk e kishin ngacmuar me fjalë njeri-tjetrin. Nga zemra fisnike e Nikë Camajt, kishte dalë vetëm një frazë ngushëllimi, "Zoti të dhashtë kivet", duke u ngritur mbi dhimbjen për vajzën e tij, Teutën, të masakruar nga dhëndri i tij, pra nipi i Gegës. Mbase diçka kishte ndryshuar brenda tij kur kishte marrë vesh se, ish dhëndëri i kishte dhënë fund jetës, në pamundësi për të korrigjuar diçka nga krimi që kishte bërë.

Të gjitha këto hollësi, kishin dalë në shesh pas hetimeve që po kryente Toma. Kishte gjetur një mënyrë të thjeshtë, por efikase, për të vjelë informacione. Rrinte gjatë me njerëz, fjalosej për gjithçka dhe pastaj e orientonte bisedën aty ku donte. Kuptohet, vrasja e fëmijëve ishte një çështje e ditës dhe njerëzit flisnin. Harronin për një çast se Toma ishte polic, njeri i shtetit, e konsideronin si të vetin, njeriun e tyre.

Po hanin mëngjesin në një lokal buzë lumit, në verandë. Po bisedonin shtruar nën ritmin e rrjedhës. Iliri ia kishte ngulur sytë kullave të bardha larg, pas bërrylit të lumit, aty ku kishte ndodhur tragjedia e fëmijëve.

“Edhe vetë Nikës, i kanë kërkuar para për të larë gjakun. Pesë mijë euro. Kaq kushtonte një frymë për ndërmjetësin Palokë Lleshi, si taksë për marrjen e gjakut. Me këtë shumë, siç duket, paguhej një vrasës. Kemi të dhëna, se kanë stërvitur për këtë qëllim edhe fëmijë, deri në moshën 14 vjeç, se i paguajnë pak. Edhe po të kapen, ata do të trajtohen me lehtësira nga drejtësia.”

“Fëmijë për të vrarë?”

Iliri, gjithnjë me vështrimin e mbërthyer nga kullat e bardha, filloi të përfytyrojë një skenë makabre me fëmijë që mbajnë në dorë një armë dhe qëllojnë bashkëmoshatarët e tyre.

“Po, dhe thuhet se po qarkullojnë shumë para në këtë biznes gjaku. Dikush i shfrytëzon edhe zënkat e kota, i nxit që ato të trashen, të shkojnë në fyerje, pastaj shkohet deri tek armët. Kjo është një linjë banale e prodhimit të gjakderdhjes, në të cilën gjithkush mund të mbetet brenda papritur. Megjithatë, ende nuk mund të thuhet, se ka një rrjet për vjeljen e taksës së gjakut, në një shkallë të organizuar. Jo, se dihet, që pas hasmërive, hyn në lojë ndërmjetësi.”

“Po Nikë Camaj, a ka paguar për larjen e gjakut?” pyeti Iliri befas.

“Edhe Nika, ua ka kërku paret djemve të tij! Për ironi të fatit, ai gjendej në anën tjetër të istikamit. Në ndryshim nga Gega, i donte paret jo për t’u pajtuar, por për të vrarë. Por, çunat e tij nuk e dëgjuan. Të merrnin ata gjakun jo e jo, por as të paguanin kënd për të vrarë. Ka një vit që kanë ikë jashtë shtetit. I thanë të atit, çfarë gjaku do me marrë ti, kur vetë krimineli është kapur dhe po kryen dënimin me burgim të përjetshëm. Nika u pati çu fjalë që t’ia dërgonin këto pare, edhe para

do ditësh. Ata nuk ja kanë dhanë dhe atij i ka mbetur vetëm një rrugë. Ta merrte gjakun vetë."

"Nika?"

Pyetja e tij mbeti pa përgjigje.

Inspektor Iliri e ndiente se brenda këtyre informacioneve të shkëputura fshihej e vërteta, të paktën njëra nga të vërtetat më të hidhura, ajo e vrasjes së fëmijëve. Ai e kishte nuhatur, që në fillim të këtij hetimi, se çelësi i zgjidhjes së gjithë enigmës, nuk ishte kapja, apo më keq eliminimi fizik i Gegë Toskës, por hetimi i vrasjes së fëmijëve, deri në detaje.

Për këtë dinte ende fare pak. Çun Matoshi i kishte thënë vetëm se kishte parë një siluetë burri të largohej me ca çizme të gjata gjuetie, mes për mes lumit, menjëherë pas krismave. Por nuk e kishte ndjekur, as ai e as i ati i fëmijëve, Gega. Pasi për ta, nuk kishte pasur më asnjë interes se kush ishte vrasësi. Pas kaq përpjekjesh dhe privimesh që e gjitha kjo të mos ndodhte, që të ruhej jeta e gjithsecilit me çdo mjet, ata kishin parë se si përpara syve të tyre, gjithçka ishte shndërruar në një zhgënjim tragjik.

Sipas të gjitha të dhënave që kishte mbledhur deri më tani nga major Toma, inspektori ishte bindur që Gega, as që kishte denjuar t'i binte pas vrasësit. Përpara tij ishte shembur përfundimisht një botë dhe ai ishte dorëzuar.

"Gegë Toska ka mendu një të ardhme si oficer karriere, dhe mbërriti të bëhet deri komandant batalioni. Por, zhgënjimi i parë i erdh, si duket, pas ndryshimeve politike, të cilat i kishte pritur me padurim. Ai ishte ushtarak dhe nuk para fliste shumë, por ato kohë sa e shikonin Gegën me një gazetë në dorë, i afroheshin të gjithë për të marrë vesh ndonjë gjë. Me lexu dinin, se nuk ka

analfabetë sot, por donin komente. Dhe Gega nuk përtonte me i sqaru.

"Shkurt, e nxorën në lirim, duke e detyru të merrej me tregti çikërrimash. Miq të tij në kryeqytet e patën këshillu të linte Sektorin dhe të ndiqte karrierën e tij atje, por ai e harroi vetveten dalëngadalë. I kish lindur fëmija e parë; duhej mbijetu, si fillim, e mandej duhej kriju një jetë për së mbari.

"E bani edhe një edhe një përpjekje tjetër që të punonte në radhët e organeve të sigurisë, tamam në forcat e policisë, ku nevoja ishte më e madhe, por aplikimi i tij ishte u hodh poshtë. Harrova të me të dhënë një kopje mbramë. Në refuzim thuhet tekstualisht se *'Policia ka kuadrot e saj dhe nuk preferon elementë të 'gardës së vjetër' nga ushtria, të skartuar për shkak të reformës'."*

Toma heshti pak dhe ia nguli pirunin një salsiçeje, kështu që nuk mund të fliste për disa çaste.

Inspektori e kuptoi se ky ishte justifikim i një drejtimi të ri partiak të shtetit. Në fakt, Gega, siç vërehej nga CV-ja e tij bashkangjitur, në kohën e aplikimit, të cilën inspektori e ka vënë në dosje, ishte vetëm 37 vjeç, pra kishte një përvojë trembëdhjetë vjeçare në ushtri, ku kishte ngjitur shpejt shkallë përgjegjësie. Ishte një oficer që kishte përfunduar shkëlqyeshëm Akademinë e Lartë Ushtarake.

Kur fliste, Toma përdorte një ton të shtruar bisede, edhe tani me inspektorin, aq sa Iliri kur e ndiqte, bënte kujdes që të mos përfshihej krejtësisht në bisedë, se kishte frikë mos i zbulonte atij, padashje, se përse kishte ardhur ai këtu. Se më pas, do t'i vinte turp t'i thoshte, se shtetit në këtë histori, nuk i interesonte shumë

vrasja e fëmijëve, as Gega si njeri, që ka një përvojë pas. Toma nuk ishte i informuar se përse ndodheshin në të vërtetë gjithë këto trupa në Sektor. Të gjithë ishin të gënjyer. Kujtonin se forcat speciale kishin ardhur për lirimin e familjeve të ngujuara. Tek e fundit, këtë gjë kishin bërë, edhe pse si diçka të dorës së dytë.

"Nga çikërrimat, Gega kaloi në tregtinë e rrobave, duke i shtuar mirë fitimet."

Toma e kishte mbaruar salsiçen.

"Ristrukturoi kullën e vjetër, mu përpara hundës së fqinjit të tij, Palokë Lleshit. Ishte njeriu i vetëm në qytezë që donte largimin e Gegë Toskës me çdo kusht nga trojet e Lleshëve, siç pretendonte ai. Dhe ka në fakt, një të dhënë historike. Stërgjyshi i Gegë Toskës kishte ardh nga jugu i vendit për të luftuar në një kryengritje ndaj të huajve, në prill të vitit 1877 dhe më pas ka mbetur në këtë krahinë. I patën dhënë tokë, pastaj e banë edhe dhëndër dhe shpejt, Cute Gjika e humbi mbiemrin e vet, por me dëshirë. Të gjithë e quanin Toska, kurse ai për nder të banorëve mikpritës që u bënë bashkëfshatarë të tij, djalit ia vuri emrin Gegë. Kaluan tre breza të tjerë që atëherë dhe emri Gegë Toska ka mbetë. Mbase edhe për pak kohë.

"Palokë Lleshi, na ka "zbulue", nuk dihet se si, kohët e fundit, kur të gjithë e kanë si modë të grinden dhe të vriten për tokat, se trojet në të cilën Gjika i parë kishte ngritur kullën trekatëshe, bashkë me oborrin dhe tridhjetë dynym reth e rrotull, kishin qenë të fisit të tij.

"Dhe, nuk linte rast, pa folë më këdo që haste, se Gega duhej të ikte që këndej, se ishte në tokë të huaj. Askush nuk ia vinte veshin, jo se nuk gjendeshin të tjerë si ky që përdornin të njëjtën

gjuhë. Atë nuk e dëgjonin për një fakt të thjeshtë: askush nuk e konsideronte Gegën të huaj në këtë vend. Madje dikush i kishte thënë, 'trojet dihet që kanë qenë të Lleshëve, por në atë kohë ato kanë pasë zot, kanë pasë burra që dinin të prisnin miq. Duhen burra të tjerë për t'i përzanë, nëse e shpërdorojnë mikpritjen, veç! Dhe Gegë Toska është bà një me katundin, njësoj si të parët e vet.' Kështu, ia kishin mbyllur gojën Palokë Lleshit."

"Paloka ka dashur ta shpërngulë?"

"Po, kështu thuhet!"

Nga një statistikë që i pat ofruar Toma, inspektori mësoi se popullsia e tanishme e qytezës ishte zvogëluar. Midis të larguarve kishte shumë të rinj, por edhe njerëz të administratës, të ardhur dekadat e fundit, të cilët ishin vënë nën presion dhe ishin larguar me kohë nga Sektori. Gega kishte rezistuar.

U nda me major Tomën duke bërë disa hapa buzë lumit. Ai shkoi drejt e në zyrë, ndërsa Iliri vazhdoi shëtitjen.

Laboratori i kriminalistikës ndodhej në katin përdhes. Iliri la gëzhojën e gjetur në vendin e atentatit ndaj Presidentit, si dhe plumbin e dalë nga arma e Bim Hykës. Përfytyroi gëzhojën si një kapele mbi plumbin e qëlluar nga arma e Bimit. A do të ishte kjo e mundur? Pas dy orësh, do të kishte në dorë një raport paraprak.

16

Nuk dihet fati i Silvës

Ishte betuar se, të premten në mëngjes, do të hynte me doemos në rezidencën presidenciale. Ishte e enjte, mëngjes, pra Gegë Toskës i mbeteshin në dispozicion vetëm 24 orë kohë, përfshi brenda edhe pushimet e mundshme. Duhej të përshkonte edhe 72 kilometra në këmbë, nga vendi ku ndodhej tani, deri në kryeqytet, thënë ndryshe, duhet të ecte rreth 18 orë, sipas hartës së tij.

Tani ndodhej në një vend të njohur, të quajtur Logu i Zanave. Kishte nxjerrë gavetën dhe po hante. Dy vite më parë, në këtë vend ishin mbledhur qindra burra të mençur kuvendi. Edhe Presidenti kishte dërguar njerëzit e tij, merrte pjesë edhe një europarlamentare, që në fakt kishte mbetur në një gjendje habitore gjatë gjithë takimit. Gega pat ardhur bashkë me Lezen dhe fëmijët, në formën e një pikniku. Ata vraponin edhe me fëmijë të tjerë në livadhet rreth e rrotull, pa kuptuar asgjë. Për ta ajo ishte një festë dhe e tillë duhej të ishte.

Gega i ndërpreu me një forcë autosugjestioni këto kujtime. Nuk donte të ligështohej tani, kur duhej të ndërmerrte fazën finale të marshimit të tij.

Deri tani kishte përshkuar më shumë se gjysmën e rrugës dhe ishte e enjte, domethënë do t'i duhej të udhëtonte ditën për të zëvendësuar natën e humbur kot në hotel. Pushimi në Liqene, kishte qenë gabimi i tij i dyfishtë. Në planin praktik, i kishte hequr një natë rrugë, pasi ai ecte vetëm natën, pa llogaritur pastaj andrallat e tjera; rreziku i përplasjes me Bim Hykën dhe ndalimi në polici. Kishte mundur të largohej shpejt, duke përdorur liqenin, pas hotelit. Askujt nuk i kishte shkuar në mend. Policët, që pas bisedës me Tomë Keqin nga posta e Sektorit, kishin dalë për ta arrestuar edhe një herë, e kërkonin në stacionin e taksive.

Ndërsa, Bim Hyka, që pas plagosjes së inspektor Ilir Martinit, kishte filluar ta ndjente veten një person në kërkim, e kishte humbur sigurinë e tij karakteristike. Ishte dashur t'i eliminonte që të sy, por sidomos atë kuçkën, Silvën. Dhe, tani që nuk ia kishte dalë dot, kishte mbetur zbuluar. Shpëtimi i tij i vetëm ishte ndjekja e Gegë Toskës, eliminimi i tij përpara së premtes.

Që nga Liqenet kishte bërë rreth 30 kilometra rrugë, maleve, në ndjekje të tij. Kishte një fizik të përsosur, muskuj të skalitur që kumtonin diçka pas çdo lëvizjeje. Mirëpo, marshimi paskësh qenë një gjë krejt tjetër. Nuk i ngjante as ecjes sportive, për të cilën ai ishte specialist. Ndryshimin midis tyre e përbënte terreni. Kjo natyrë e mrekullueshme për ta soditur, ishte tejet e ashpër

për ta mundur. Por, midis tij dhe Gegës kishte edhe një ndryshim tjetër, të cilin ai nuk mund ta kuptonte dot. Gega ecte natën, ndërsa ai ecte ditën. Nuk do të kishin asnjë shans të ndesheshin, nëse kjo mënyrë do të vazhdonte.

Mirëpo, tanimë, edhe Gega do të ishte i detyruar të ecte gjatë gjithë ditës së enjte dhe pastaj gjithë natën, duke u gdhirë e premtja.

Bim Hyka nuk po vendoste ende në duhet të vazhdonte marshimin, apo jo.

Dy orët në pritje të raportit balistik, inspektor Iliri i shfrytëzoi për të kryer disa nevoja të ngutshme. Mori një byrek dhe një birrë, pastaj nxori disa dhjetëmijëshe nga bankomati, që do t'i duheshin për të mbushur makinën me karburant. E dinte se, sido që të dilte raporti mbi plumbin dhe gëzhojën e dorëzuar, ai do të largohej nga Sektori. Këtë do të bënin me siguri, mbase të nesërmen, edhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, të cilat të paktën kishin shërbyer për kryerjen e arrestimeve dhe lirimin e familjeve nga ngujimi. E gjithë vëmendja do të përqendrohej në kryeqytet, që nga ky çast. Ishte e enjte, mesditë, trupat mbase niseshin që pasdite.

Shumkush kishte nisur të numëronte minutat dhe orët. 'Edhe Silva!' Inspektori u turpërua me veten që nuk e kishte menduar më fare, që nga ndarja me të, mbrëmjen e kaluar. 'Ta hajë dreqi, nuk kam as numrin e saj të telefonit' mendoi. 'Duhet nxituar!' i tha vetes.

Inspektori mori rrugën drejt postës së policisë; parkoi përpara, përshëndeti oficerin roje në mënyrë ushtarake dhe hyri brenda në godinë. U ngjit deri në zyrën e zëvendëskomandantit, major Tomës, me të cilin ishte miqësuar tanimë. Ai i

kishte ofruar të gjithë ndihmën e mundshme për hetimet e tij.

Nuk ishte nevoja të trokiste, pasi Toma që ishte njoftuar ndërkohë për ardhjen e tij, i doli përpara në derë dhe e ftoi të hynte brenda.

Mbi tavolinën e xhamtë qëndronte një qese plastmasi, shoqëruar me një letër të shkruar në format A4, edhe ajo e futur në një zarf plastmasi. Toma pa sytë e Ilirit që u ndalën atje dhe duke qeshur i mori objektet mbi tavolinë dhe i futi në sirtar.

"Prit një herë ta marrim vesh, zoti inspektor! Me sa ma merr mendja mua, ti do të largohesh dhe vështirë se takohemi më. Desha të shpreh respektin më të madh për punën tuaj këtu në Sektor. Të njëjtat fjalë i kam edhe për zonjën prokurore, Silvën. Nuk iu harrojmë kurrë; edhe unë që më sheh kështu të veshur, me grada, kam pasur do njerëz të fisit në ngujim. Dolën, hapi i parë u bà, tani le të merremi vesh, ose përndryshe ligjin!"

"Faleminderit zoti Tomë! Gabohesh vetëm kur thua që vështirë se takohemi. Nuk e harroj lehtë rakinë e qershisë që bën Sektori! Pastaj, sapo kemi filluar. Do dëgjohemi përsëri për ndonjë zhvillim të mundshëm."

Toma i dorëzoi pakon dhe raportin shoqërues, të cilat Iliri edhe pse donte t'i hapte në çast, për respekt, i futi në çantën e tij të shpinës. E bënë korridorin bashkë, shtrënguan duart dhe Iliri zbriti shkallët turravrap, kaloi hollin e ndërtesës, përshëndeti edhe një herë ushtarakisht oficerin e rojës dhe doli nga dera.

Aty, nuk priti dot më, shqeu plastmasin dhe filloi të lexojë në këmbë, ndërsa i afrohej makinës. Toma e vështronte nga dritarja, Iliri e ndjeu

shikimin e tij dhe e ngriti kokën, e përshëndeti edhe një herë me dorë dhe u fut në makinë.

Ajo që i interesonte të gjente në raport, ua pa qartazi që në fillim: plumbat e zbrazura ndaj makinës presidenciale nuk kishin asgjë të përbashkët me atë të qëlluar ndaj tij dhe Silvës, prej Bim Hykës. Çdo dyshim i ushqyer prej sjelljes më të fundit të Bim Hykës, dukej i pabazë, të paktën në këtë këndvështrim. Bim Hyka nuk i kishte qëlluar Presidentit! Këtë dyshim, për momentin, mund ta largonte nga koka e tij. Gëzhoja dhe plumbi nuk kishin dalë nga e njëjta armë.

Dhe në fakt, makina e Gegë Toskës, e fshehur buzë autorrugës A2, të linte të kuptoje që vetë ai ka pasur kohë dhe mjete për ta bërë këtë atentat.

Atëherë, me sa dukej, reagimi i Bim Hykës ndaj tyre duhej të kishte qenë thjesht xhelozi, pasi më pas ai kishte ecur përpara për të ndjekur vrasësin e vërtetë të tre burrave dhe kanosësin e presidentit.

Tani gjithçka do të përqendrohej tek mbrojtja e Presidentit, si në momentin e parë, nga një sulm i mundshëm nga kërcënuesi i tij i deklaruar, Gegë Toska.

Nuk ishte hera e parë që Iliri dyshonte për një komplot nga brenda ndaj Presidentit. Nuk e kishte përjashtuar këtë mundësi që në momentin e parë, por nuk kishte arritur të gjente motivimet e nevojshme për kryerjen e një akti të tillë, nga të dyshuarit e tij.

Veçoi gëzhojën e gjetur në atentatin ndaj Presidentit.

Kishte hyrë në autorrugë, bëri rreth tridhjetë kilometra dhe doli në Ujëmirë, që të merrte Silvën

me vete. Shkoi në “Hotelin Udhëtari” ku kishte fjetur ajo një natë më parë dhe si fillim pagoi dhomën e tij, pavarësisht që nuk kishte fjetur.

Më pas vajti të trokasë në dhomën e Silvës. E kapi një frikë e tmerrshme, befas. ‘O zot, po sikur të ketë ardhur Bim Hyka? Thua, të ketë ardhur deri këtu? Ta ketë rrëmbyer, poshtëruar, zhdukur! Dhe ka pasur kohë për të gjitha këto.’

I ra derës së dhomës me grushte. E vuri gjithë hotelin në alarm. Njeriu që shërbente në recepsionin e hotelit u bë gati t’i telefononte policisë. Iliri, që zbriti shkallët më vrap, e kapi me dorezën e telefonit në vesh dhe ia hoqi me forcë.

“Ku është Silva?”

“Atë po kërkoni edhe ju?” iu përgjigj burri përtej banakut.

“Pse kush e ka kërkuar tjetër? Fol!”

“Nuk ka më shumë se dhjetë minuta, që janë larguar. Erdhi e mori një burrë i gjatë, i pashëm, ushtarak m’u duk, edhe pse kishte veshur rroba civile.”

“Si ishte Silva? E frikësuar? Bërtiste?”

“Jo, as e frikësuar, por as e lumtur. I rrinte me turinj atij burrit!”

‘Është grua krenare, vështirë se nënshtrohet Silva!’ tha Iliri me vete.

“Po nga ikën? Çfarë makine kishin?”

“Një makinë ushtarake, tip xhipi.”

Iliri u mjaftua me kaq. E dinte se nuk mund të mësonte më shumë prej një njeriu të painteresuar. Duhej të kënaqej me sa kishte marrë vesh. Filloi të buiste një dritë shprese në qenien e tij të tronditur. ‘Ka mundësi të ketë qenë edhe kolonel Bardhi.’

Mori edhe një herë autorrugën, pak më i çliruar, tani i mërzitur përse ata të dy nuk i kishin

bërë një telefonatë. Kolonel Bardhi e kishte numrin e tij, mund edhe ta informonte. 'Dëgjo Ilir, mos u bëj merak, Silva është me mua. Kaq mund ta bënte.'

Kilometrat e mbetura i përshkoi brenda një ore dhe hyri në kryeqytet kur sahati i madh në qendër shënonte 2 e pasdites. E hoqi për një çast mendjen nga Silva. Ishte e enjte, ditë e zakonshme pune dhe po të donte mund të shkonte ta kërkonte në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, nëse ajo nuk bëhej e gjallë më parë. Dukej që ishte mërzitur me të, se përndryshe do t'ia merrte ajo numrin kolonel Bardhit dhe do t'i telefononte. Vendosi të përqendrohej në hetimet, njëherë.

Nuk kishte mbaruar ende ngrënia e drekës dhe nëpër rrugë kishte pak lëvizje. Inspektori përshkoi unazën dhe e ndali makinën pranë Akademisë së Lartë Ushtarake.

Aty ishte me fat, nuk gjeti askënd të priste në radhë. Sekretarja e shkollës, e veshur edhe ajo me uniformë ushtarake, i buzëqeshi me mirësjellje dhe iu drejtua.

"Me çfarë mundemi t'u shërbejmë, zotëri?"

Iliri e kuptoi vetëm në atë çast, që nuk ishte i përgatitur si duhet për atë që do të kërkonte. Ligjet e reja për privatësinë, nuk të lejonin të merrje të dhëna për tjetrin pa një autorizim. Deshi të gënjente, të paraqitej si Gegë Toska, një ish student i kësaj shkolle dhe të thoshte se vinte për të marrë kopjen e librezës së notave, pasi i duhej në një aplikim për punë. Tjetra do t'i kërkonte një dokument dhe atëherë gjithçka do të mbaronte aty, ajo do të nxehej dhe nuk do t'i shërbente më.

Por jo vetëm kaq, nga zhvillimi i mëvonshëm i bisedës, do ta kujtonte se kishte bërë shumë mirë që nuk ishte paraqitur në atë formë.

"Dëgjo, si e kam punën moj motër!" Iliri e ndërroi krejtësisht tonin e bisedës, i foli me 'ti'. "Kam një nevojë shumë urgjente për disa informacione që kanë të bëjnë me vitin 1984. Jam inspektor i krimeve në DPK dhe po hetoj një çështje shumë urgjente." Iliri i tregoi edhe dokumentin.

"Ne kemi një rregullore të veçantë, më strikte, në përpunimin dhe dhënien e informacionit. Është e kotë t'u përmend procedurat; duhet të aplikoni, të mbushni një formular tip, të lini numrin e telefonit dhe pastaj ju thërrasim ne."

"Në rastin tim, gjithçka mbaron nesër në mëngjes."

Iliri po bëhej gati të ikte dhe të kërkonte direkt komandantin e shkollës.

"Viti 1984, the? Atë vit, e kam mbaruar edhe vetë shkollën!" tha sekretarja dhe Iliri u bë sy e veshë.

"Këtu keni mbaruar ju?" pyeti Iliri. "Dëgjo, mbase i shmangim të gjitha formularët dhe mua ma kursen një vrap lart tek zyra e komandantit. Po të bëj një pyetje direkte. A e ke pasur në kurs një farë Gegë Toska, që ka mbaruar për këmbësori?"

Tjetra nxori një psherëtimë.

"I kanë vrarë fëmijët të ziut!" tha sekretarja.

"Po, pikërisht për atë e kam fjalën! Keni mbaruar bashkë në 1984, the. Po, edhe diçka tjetër. E njihni Arben Bardhin, është këshilltar i Presidentit. Edhe ai ka mbaruar këtë shkollë, më duket. Të paktën kështu thuhet në CV-në e tij të

publikuar në faqen zyrtare të Presidencës në internet."

"Arbeni nuk ka mbaruar me ne, se ka qenë degë tjetër, por ne mblidheshim në një sallë nëpër leksionet e përbashkëta. Si ta them, ju më dukeni ca i ri dhe nuk i keni bërë disa lëndë politike që bënim ne dikur. Vetëmse, di të them që Arbeni me Gegën kanë pasur mjaft shoqëri. I shikoje shpesh bashkë. E kujtoj, se ishin dy meshkuj që binin në sy, më kupton?"

Iliri mbeti i befasuar.

"E doni regjistrin e amzës të vitit 1984? Por, më duhet të shkoj në arkiv dhe do të prisni pak." vijoi sekretarja.

"Jo, kaq më mjafton! Shumë faleminderit!" i tha Iliri dhe u largua duke kuptuar se tjetra kishte dëshirë të vazhdonte bisedën, e ngacmuar, siç ishte, në kujtimet e saj për shkollën.

Por Iliri nuk kishte kohë me të vërtetë. Hëngri sërish byrekë, të blerë në rrugë.

17

Hetime dhe frikë për Silvën

Tani po e kërkonte Silvën jo vetëm për ta pyetur për shëndetin. Inspektor Iliri po shqetësohej seriozisht për fatin e saj. 'Kjo grua nuk paska fat fare me burrat që zgjedh' mendoi. Nga sa po merrte me mend, Silva ishte njohur me kolonel Bardhin, kohët e fundit dhe, me sa duket kërkonte të ndërtonte me të, nga pozitat e gruas, një marrëdhënie afatgjate. I erdhi keq për të, se nuk kishte nuhatjen më të vogël për të zgjedhur njerëzit e duhur.

Po ngiste makinën si i çmendur në rrugët e kryeqytetit, po atë të enjte pasdite, me shpresën se do ta gjente në zyrat e prokurorisë. Kishte një dyshim serioz, pikërisht për kolonel Bardhin dhe donte të këshillohej me të. Ti thoshte të paktën të rrinte larg prej tij, për ca kohë.

Binomi Gegë Toska – kolonel Arben Bardhi, po e sfiliste rrugës për në Prokurori. Ideja e një komploti ndaj Presidentit, ishte ngritur edhe një herë fuqishëm. Vetëm se kishte një dallim serioz midis tyre. Gegë Toska vinte nga një moment

tragjik, kishte pësuar një fatkeqësi të paripareshme, ndërsa Arben Bardhi ndodhej në një pozitë komode. Kërkonte të ngjitej lart, tani që e kishte ndjerë nga afër pushtetin. Qe kujtuar se mund të bëhej ai president i vendit dhe mbase rolin e këshilltarit mund t'ia linte mikut të tij besnik, Gegës. Kush më mirë se ai, do t'ia ruante krahët në momente kritike? E kishte shok të vjetër. Vërtet nuk e kishte takuar prej kohësh, por, me sa dukej, asgjë nuk mund ta bënte që të ndryshonte mendimin e tij për besnikërinë e tij.

Për inspektor Ilirin përvijohej një skenar i ri, që pas disa orësh, të nesërmen në mëngjes, mund të sillte pasoja të rënda për vendin. Kishte dyshime se, pikërisht këshilltari i presidentit, mund të kishte qëlluar mbi të. Disa elementë të atentatit e kishin bërë që të mendonte këtë pistë që në fillim. Vendi ku e kishte gjetur gëzhojën, në mes të rrugës, të bënte të mendoje se njeriu që kishte qëlluar ishte fare pranë presidentit, të paktën pjesëtarë në eskortën e tij. Inspektori i kishte bërë me kohë verifikimet e rastit dhe e dinte tanimë që tre makina pas asaj të Presidentit, qëndronte zakonisht makina e këshilltarit, kolonel Bardhit. Për të mos pasur dëshmitarë, duket se e ka ngarë makinën vetë. Ka pritur që makina presidenciale të përshkojë gjysmërrethin e parë dhe kur i ka ardhur në linjë të drejtë, ka qëlluar, rreth njëzetë metra larg, që nuk janë asgjë për një qitës si ai, të sprovuar. Pastaj, ka pritur që eskorta të përshkojë gjysmërrethin e dytë, pas urdhrit të kthimit mbrapsht, dhe ka qëlluar përsëri.

Por, a ka dashur koloneli të eliminojë fizikisht Presidentin? Kjo i dukej e dyshimtë. Nisur nga

arma që ka përdorur, një pistoletë, që edhe pse ofensive, nuk do të garantonte eliminimin e tij fizik në ato rrethana. Koloneli e njeh mirë shkallën e sigurisë së makinës presidenciale dhe në rast se do të donte vrasjen e presidentit, do të përdorte një armë potente dhe fishekë blindëshpues.

Inspektor Iliri nuk ishte në gjendje ende të krijonte një panoramë të qartë të asaj që kishte ndodhur. A ishte vërtet kolonel Bardhi që kishte thirrur në skenë mikun e tij të vjetër, Gegë Toska? Nëse po, përse ta bënte në rrethana të tilla tragjike për të? Mbase e bënte thjesht për të penguar anëtarësimin e vendit në ANM, për një farë kohe. Pastaj do të kërkonte të dilte ai si shpëtimtar.

Pikëpyetjet, fillonin e shtoheshin në një progresion gjeometrik, sapo tentonte të mbërrinte në një përfundim të sigurtë. Ajo që sapo kishte mësuar atë të enjte pasdite, ishte vetëm që Gegë Toska dhe kolonel Bardhi, ishin miq të vjetër. E kotë që të bridhte në hamendje të tjera, duhej ende të verifikonte shumë detaje, ndërkohë që koha ecte.

Sapo kishte kërkuar Silvën në zyrën e informacionit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. I kishin thënë që ende nuk ishte larguar nga zyra dhe kjo gjë e kishte qetësuar inspektorin. Po përgatitej me mend se çfarë duhej t'i thoshte, krejt i pasigurt se si do ta priste. Sigurisht, do të ishte e zhgënjyer prej tij, pas largimit në Sektor, duke e lënë vetëm, të pambrojtur në hotel.

E pa të zbriste shkallët e qetë, si një modele në sfilatë, me hapat e sigurt, duke vënë në pah kërcinjtë e saj të gjatë. Ilirit ky iu duk një agresion i vërtetë, u tkurr përbrenda, deshi të ikte, por e mbajti veten.

Ajo i kaloi përbri dhe i tha vetëm një fjalë.

“Dalim!”

Gjëja e parë që e çuditi Ilirin ishte makina e saj, një “Audi” sportiv që ata e kishin lënë dy ditë më parë në parkingun e hotelit, në Sektor, përpara se të niseshin në atë udhëtimin e rrezikshëm përmes maleve me xhipin e tij “Wrangler”. Dikush ia kishte sjellë. Iliri e pa se si shkëlqente tani makina, krejt ndryshe. Vuri re se si xhami i derës së saj, pas prekjes se dorezës nga Silva, përmbysi menjëherë poshtë të gjithë godinën e Prokurorisë së Krimeve të reflektuar në të.

“Lëre këtu makinën tënde, se nuk e gjen gjë. Përdorim timen!”

Iliri u ul pa folur në vendin e pasagjerit, ndërsa Silva në vendin e shoferit. I grahte makinës e qetë, pa një fije nervozizmi.

“Ku po na çon?” e pyeti Iliri.

“Mos u merakos, se nuk jam si ti! Në një bar të qetë! Besoj se edhe ti ke nevojë.”

Iliri deshi të ndërhynte menjëherë, t’i thoshte se nuk kishte kohë për të biseduar në një bar, por u ndje i pafuqishëm. Në fund të fundit, ai kishte vërtet nevojë të bisedonte shtruar, të qetësohej pak, përpara se të qartësohej mbi gjithë sa mund të ndodhte të nesërmen. ‘Jo të gjithë e vrasin mendjen si unë, atëherë!’ tha me vete, tek shikonte si vjedhurazi profilin e Silvës.

“Të kam thirrur për të dhënë llokumet” tha Silva.

“Llokumet?!” u përçudnua inspektori.

“Martohem! E ke pakon me llokume prapa në sedilje, se e dija që do të vije. Sigurisht jo për mua, por më lejo të shfrytëzoj rastin, pastaj le të flasim për çështje pune.”

“Kush është fatlumi?” pyeti Iliri duke e parë në sy.

“Kolonel Arben Bardhi!”

“Mos!”

Iliri mbylli sytë, Silva gozhdoi makinën në vend. Kishin mbërritur në parkingun e barit “Nëna Mbretëreshë” midis pishave të buta. Silvës iu deshën edhe dy manovra elegante për të zënë vend mirë në parking.

U ulën në tavolinë. Erdhi kamerieri të merrte porosinë. Silva filloi të qeshë, mbase për të ç’dramatizuar pak situatën, duke parë fytyrën e ngrysur të Ilirit. Pa hapur mirë gojën kamerieri, ajo dha porosinë.

“Për zotërinë, raki qershie, për mua një lëng frutash!”

“Raki qershie! Ç’është kjo? Nuk mbajmë pije vendi ne! Uiski, xhin, vekia romana, çfarë të dojë zemra. Po raki qershie, më fal, po kurrë nuk e kam dëgjuar!”

“Dakord”, ndërhyri Iliri. “Mua një ujë nga rubineti, nëse nuk keni ujë vendi me shishe, ndërsa zonjës lëng frutash. U morëm vesh?”

“Okej!”

Silva dhe Iliri vazhdonin të ndiqnin hapin e shpejtë të kamerierit në largim.

“E paskam më të lehtë, atëherë!” nënqeshi Iliri.

“Çfarë paske më të lehtë?” iu kthye Silva e vrenjtur, se e kuptoi që Iliri kishte ndërmend të ironizonte.

“Dëgjo Silva, sot e kam vuajtur pakujdesinë time në lidhje me ty. Shkova në hotel dhe kam bërtitur si i çmendur kur nuk të pashë. Pastaj pyeta rojën e portës, disi u qetësova, kur e mora me mend se kishte ardhur koloneli. E kuptova nga përshkrimi i hotelierit që ishte koloneli dhe jo Bim

Hyka, se tha 'erdhi një burrë që m'u duk ushtarak edhe pse kishte veshur rroba civile'. Por, edhe ti, mund të ma bëje një telefonatë, se mirë unë gabova dhe nuk e bëra. Të thoshte vetëm: 'Jam mirë, po shkoj me kolonelin. Vetëm kaq!"

"Ende nuk po më thua se çfarë ke më të lehtë tani?" e rikujtoi fillin e bisedës Silva.

"Eh! Si ta them! A je e sigurt këtë radhë për njeriun që ke zgjedhur?"

"Ç'është kjo pyetje? Nuk të kam dëgjuar asnjëherë të më flasësh për këto tema. Dhe besoj kemi pasur kohë."

"Përsëri jam jashtë asaj teme Silva. E kam fjalën, në e njeh mirë kolonelin, vërtet, sepse kam një dyshim serioz për të!"

"Dyshim për kolonelin! Lëri këto tani Ilir! E di që profesioni yt është të dyshosh, por çdo gjë e ka një kufi."

Silva kishte folur me zë të lartë.

"Më duhet një raport balistik i armës së tij, ka një pistoletë TB nga ato të ushtrisë, apo jo?"

"Nuk marr vesh nga pistoletat, unë! Sa për armën, kërkoja vetë. E ke mik të vjetër, edhe ti më duket. Pa dale, njëherë. Ku e ke fjalën ti?", iu kthye Silva me ton më të ngritur.

"Është për të mirën e të gjithëve. Njeriun që kemi pranë duhet ta njohim deri në fund. Unë e kam pasur mik dhe kam besim të patundur tek ai. Përpara pak orësh në hotelin e Ujëmirës, kur pashë që ishe nisur me të, u ndjeva pak xheloz, për ty si grua, por u kënaqa për njeriun që kishe zgjedhur. Ndërsa tani, na duhet vetëm një sqarim i vogël, një provë e re, e cila nëse kapërcehet, e bën kolonelin edhe më të admirueshëm, për të dy ne."

"Fol më shkoqur, atëherë?

“Presidentin e ka qëlluar koloneli!”

“Çfarë!?”

“Nuk i njoh rrethanat, motivet, por jam gati i sigurt se e ka bërë ai. Prova e balistikës do ta vërtetojë plotësisht!”

Silva u ngrit nga tavolina. Doli jashtë dhe u mbështet në verandën e drunjtë të barit. Iliri e ndoqi pas.

“Do armën e tij, nga unë?”

“Po! Sa më shpejt! Një kontroll të shpejtë dhe ta kthej!”

“Ilir, po përse nuk ia kërkojmë dhe pikë!”

“Bëj si të duash, atëherë!”

I hipën makinës dhe Silva e la Ilirin pranë xhipit të tij. U kujtua pastaj t’i merrte numrin e celularit.

“Të njoftoj unë, kur ta kem armën!” i tha Silva.

“Më fal, Silva, por urimet do t’i bëj më vonë” i tha Iliri dhe i tundi pakon me llokume.

“Nuk ka rëndësi! Mos e vrit mendjen për mua!” i tha Silva dhe e nisi makinën menjëherë me marshin e dytë, nga nervozizmi, duke i xhiruar gomat me një tym të lehtë.

18

Kujdes, ka qëlluar koloneli!

Inspektor Iliri hyri në apartamentin e tij, aty nga ora katër e pasdites. Veprimi i parë që bëri, qe një telefonatë në repartin e kriminalistikës, në DPK.

"Alo, hë Niko, nuk paske ikur akoma në shtëpi?"

"Oh, kush na qenka! Ilir, po nga je zhdukur gjithë këto ditë?"

"Vërdallë. Po, dëgjo Niko, si e kam punën. Ti shko në shtëpi, e ku të duash, mjaft të mos largohesh nga qyteti, se sot më duhesh. Nuk e kam të sigurt se kur, me saktësi. Do të marr unë në telefon."

"Si e ke hallin?"

"Asgjë, më duhet të kryej një ekspertizë arme. Deri tani kam në dorë vetëm fishekun. Sa të më vijë edhe arma, do të marr në telefon."

"E kuptova, e kuptova! Gati më ke, në çdo orë, mos u bëj merak!"

"Mirudëgjofshim atëherë!"

Iliri e mbylli telefonin dhe u shtri sa gjatë gjerë mbi krevat. Mori në dorë telekomandën dhe filloi të kërkojë kanalet. Ndalej në secilin pak minuta, nga frika se mos gjente ndonjë program vërtet interesant dhe pastaj do t'i vinte keq ta linte në mes.

Tani ndjehej i lodhur për vdekje dhe kishte një frikë tjetër, më reale, se mos e zinte gjumi.

Ra zilja e celularit përsëri. Ishte Silva.

"Ai po bën dush, eja shpejt poshtë pallatit. Është një ndërtesë katër katëshe në rrugën "Drita", nr.13. Nuk duhet të jetë larg nga banesa jote. Ke thënë se banon në bllokun e Parkut të Madh."

"Për një minutë jam aty!"

Iliri banonte në katin e dytë, për fat dhe nuk kishte nevojë të priste ashensorin. I kaloi shkallët nga katër dhe doli turravrap poshtë. I kërceu xhipit drejt e në sedilje, se tani i zbuluar ishte fare pa dyer. Rrugën e bëri për dy minuta.

E vuri re Silvën që larg, dukej se kishte dalë e veshur me një rrobë shtëpie, një lloj robdëshambri me lule të mëdha.

E kishte futur armën në një qese plastmasi dhe ia zgjati. Iliri e mori dhe menjëherë formoi numrin e Nikos, ekspertit të balistikës.

"Hë, Niko, ku je tani?"

"Eja, nuk lëviza vendit unë, e kuptova që kishe nevojë. Këtu më ke."

Iliri mori drejtimin për nga DPK-ja. Çdo gjë po shkonte siç duhet. Hyri edhe vetë në repartin ku punonte Nikoja. Ai përpiqej t'i shpjegonte, gjithë pasion se si vjaskat e tytës linin shenjë mbi gëzhojën.

"Ja, kjo është gëzhoja."

Në monitor u shfaq e zmadhuar gëzhoja.

“Këtu duken shenjat që kanë lënë vjaskat e tytës së pistoletës. Shikoje vetë, përputhjen!” i tha Niko.

“Dëgjo, Niko, të jetë për mua, unë nuk kuptoj asgjë. Më thuaj shpejt, arrite në një përfundim, apo jo?”

“Ta thashë pra, përputhen! Kjo gëzhojë ka dalë nga kjo pistoletë TB dhe nuk e luan topi. Gjithçka përputhet!”

“Ika, tani Niko, faleminderit!”

“Ik o Ilir, Ik! Mirupafshim!”

Iliri nuk priste rezultat tjetër. Tani duhej të nxitonte për tek Silva që t’i jepte armën. Po a do të ishte ky veprimi më i mençur? T’ia dorëzonin armën edhe një herë kolonelit? Armën me të cilën kishte qëlluar Presidentin.

Megjithë mëdyshjen, ai po e ngiste makinën me gjithë shpejtësinë. Për fat të mirë ishte ora pesë e pasdites, kur qarkullimi ende nuk ishte shtuar. Mbërriti tek Silva brenda pesë minutash.

Silva nuk dëgjoi zilen e celularit. E lajmëroi koloneli, madje e mori aparatin mbi komodinë dhe ia zgjati Silvës që po bënte dush. Ishte nga ata telefonat me kapakë, tek i cili nuk lexohej emri apo numri që binte, pa e hapur. Pastaj shtypje butonin nëse doje të përgjigjeshe.

Silva falënderoi kolonel Bardhin, pa numrin dhe pastaj e fiku.

“Kush ishte?” pyeti koloneli nga dhoma.

“U ndërpre! Mbase kanë gabuar numër!” tha Silva që brenda dushit dhe e fshiu thirrjen pa përgjigje.

Koloneli tani mezi e priste të dilte nga dushi. Filloi të shqetësohej me atë ‘kanë gabuar numër’.

E njihte Silvën nga zëri kur kishte një emocion të fortë. I shkoi mendja tek Iliri, pastaj sytë i vajtën tek pantoflat e Silvës, bërë me baltë. 'Paska dalë, kur unë bëja dush!' tha me vete. Shikonte siluetën e trupit të saj të përsosur pas xhamit opak të derës së banjës, lëvizjet e lehta, si një vallëzim bluz, krejt në kontrast me padurimin e tij.

Ishte mbrëmja e tyre më e rëndësishme. Pas një periudhe dy vjeçare bashkëjetese kishin vendosur të martoheshin. Dhe kishin gjetur pikërisht një mbrëmje si kjo, për ta celebruar.

Silva ndjehej shumë konfuze. Ishte nga ata pak njerëz të informuar për rrezikun që i kanosej Presidentit dhe këshilltari i tij gjente një ditë të tillë për t'i propozuar martesën. Këtë gjë nuk e kishte menduar në fillim, por pas takimit me Ilirin, çdo gjë kishte ndryshuar. Do ta kishte vështirë të ishte e qetë, e jo më të dukej e lumtur në mbrëmjen e tyre. Do të darkonin në njërin nga restorantet më të njohura të kryeqytetit. Pa të ftuar, vetëm ata të dy. Një fakt ky, që i kishte pëlqyer disa orë më parë, ndërsa tani po i kallte frikë.

U dëgjuan të trokitura në xham. Silva u drodh. Ishte koloneli.

"Hë, se u err! Mbarove?"

Toni i tij kishte ndryshuar. 'Diçka ka vënë re' mendoi Silva. 'O zot, po sikur të kërkojë pistoletën!'

Doli nga dushi, me flokët e lidhur me peshqir dhe shkoi përpara pasqyrës, duke e parë kolonelin përmes saj. Ishte veshur civil.

"Vura re që dole qëparë. Ku shkove?" e pyeti.

"Derdha plehrat."

Silva u habit me veten se si e kishte pasur përgjigjen në majë të gjuhës.

Nuk folën më derisa u bënë gati.

Mesazhi i Ilirit i erdhi kur ishin futur në makinë. E hapi dhe e lexoi: *Ka qëlluar koloneli. Kujdes!*

Nuk priti që koloneli të bëhej sërish kureshtar.

"Paska qenë Iliri edhe qëparë. Unë nuk e kam numrin e tij të regjistruar dhe mendova se mos kishin gabuar numër. Na uron për martesë."

"Faleminderit! Ktheja mesazhin!" tha koloneli.

Silva i shkroi: *Çelësin e ke poshtë shtrojës së derës. Vëre armën në vend! Silva!*

"Ja, ku u bë edhe kjo punë!" tha Silva.

U ndje e lehtësuar papritur, a thua se kishte ndryshuar ndonjë gjë nga situata kritike në të cilën ndodhej.

19

Të reja nga Sektori

Vrojtuesi nuk kishte nevojë më për dylbitë. Pas pak do të errej dhe do të fillonte nata më e gjatë për të. E kishte pasion vrojtimin, edhe kur nuk përdorte dylbi. Vendosej në një pozicion fiks në plazh, a kudo që të ndodhej, në një qendër tregtare, në stadium, kudo dhe fiksonte një njeri, për një kohë të gjatë, që zakonisht do të ishte viktima e tij e ardhshme.

Natën përdorte duart, armën, me saktësinë e një profesionisti. Ishte habitur këtë radhë me ndryshimin objektivit që kishte për të eliminuar. Ditë me radhë kishte vrojtuar *amerikanin,* inspektorin, kurse tani natën i kishin caktuar për të eliminuar një tjetër.

Vrojtuesi ishte nisur, bashkë me helikopterin e trupave speciale. Me të mbërritur në bazën ushtarake, ai do të shkëputej dhe do të ngjitej në mal përmes një rruge që pakkush e njihte. Më pas do të zinte pozicion në rrënojat e një qyteti antik, tridhjetë kilometra larg kryeqytetit.

Iliri ishte brenda në apartamentin e kolonelit kur i ra zilja e telefonit. U drodh i tëri. Por aty për aty, e mori veten, 'telefon është, nuk është kamera dhe po më shikojnë' mendoi.

Nuk iu shfaq asnjë emër, pra nuk ishte numër i regjistruar. E hapi celularin, që e kaloi në dorën e djathtë, ndërsa pistoletën e kolonelit në të majtën.

"Alo, jam Tomë Keqi, flas nga Sektori."

"Mirëmbrëma, Tomë! Ç'të reja kemi?"

"A të shqetësoj?"

'*Boll, besa!*' tha Iliri me vete duke menduar situatën në të cilën ndodhej. I futur si hajdut në apartamentin e një njeriu, me një armë në dorë.

"Mos e fol atë fjalë!" u përgjigj. Ndërkohë, në çast u pendua. Mund t'i kishte thënë vërtet që të merrte më vonë. Tani do të niste ajo ligjërata e pafund e Tomës, në të cilën nuk dallohej mirë çfarë ishte informacion e çfarë ishte koment.

"Ke kohë, të më dëgjosh atëherë! Mirë, pra."

Iliri deshi ta mbyllte, pastaj do t'i shpjegonte se kishte rënë linja.

"Deri tash dimë që Nikë Camaj ka vra fëmijët, Antonin dhe Donikën. Babai i tyne Gega, është çue e ka vra Nikën, si hasëm dhe Palokë Lleshin, pse i ka kërku të ndërmjetësojë me pare."

"Dëgjo, Tomë, a mund të marrësh më vonë?" e ndërpreu inspektor Iliri.

"Jo, tani duro pak. Të mora leje në fillim! Pra, ku e lashë? Hë, po. Kam njoftime se është pa me pushkë në dorë, duke kalu lumin, mëngjesin e së premtes, vetë Palokë Lleshi!"

"Ndërmjetësi, misionari i pajtimit?"

"Misionari i dreqit me brirë! Krimineli!"

Toma po bërtiste me të madhe në telefon.

"Kam kontrollu edhe vendin e ngjarjes" vazhdoi Toma. "Është gjetë një defter, me shifra, hesape.

Duhet t'i ketë ra nga xhepi Palokës. Shumë faqe janë bà të palexueshme, se njëherë i ka lag shiu, pastaj i ka ter dielli e i ka përcëllu, nesër bëhen shtatë ditë plot! Dëgjo, po t'i dërgoj me faks, të gjitha faqet, ma dërgo numrin me mesazh. Dhe mos harro me shku deri tek kryetari i Misionit të Pajtimit, tek Prekë Prela. E di vetë, ti. Tani po ta mbyll. Ma bafsh natën e mirë!"

Palokë Lleshi, misionar i pajtimit të gjaqeve! Çfarë do të thotë Preka kur ta marrë vesh? Po deputeti Gjetani? Iliri, rrinte ende me pistoletën në dorë, duke vrarë mendjen për të inkuadruar këtë informacion të ri.

Prekë Prela hyn në Presidencë si në shtëpinë e vet, po ashtu deputeti Gjetani dhe që të dy bashkëpunojnë me zonjën Tefta. Koloneli qëllon mbi presidentin, jo për ta vrarë, por për ta mbyllur brenda. Që përpara se të nisej në paradë, ky e paska këshilluar që të ngujohet brenda, duke marrë shkas nga një njoftim i Shërbimit Informativ se një farë Gegë Toska, që tani na del së është mik i tij i vjetër, qenka nisur të kërcënojë Presidentin. Mos duhej gjetur një forcë madhore për ta nxjerrë nga shtëpia Gegë Toskën? A e justifikon qëllimin për të ngujuar Presedentin, krimi i shëmtuar ndaj dy fëmijëve të pafajshëm? Dikush ka dashur të nisë Gegë Toskën me çdo kusht drejt kryeqytetit.

Inspektor Iliri e kuptonte që po humbte shumë kohë brenda në apartament. E dinte se për kolonelin kjo ishte një mbrëmje e veçantë dhe do të rrinte gjatë jashtë me gruan e tij të ardhshme. Mbase pas darke, shkonin në ndonjë pub apo në ndonjë diskotekë. 'I ka punët vërtet në terezi, ky koloneli. Presidentin e ka mbyllur brenda dhe vetë

bredh e zdërhallet nëpër lokale me gruan më të bukur që i ka zënë syri. Iliri duhet të bënte diçka, sa nuk ishte vonë. Por rrethanat nuk ishin aq të favorshme. Koloneli kishte Silvën në dorë, mund ta përdorte si peng. 'Dreq o punë, duhej vendosur mbase, o Silva o Presidenti!' mendoi. Dhe kjo nuk ishte retorikë. Presidenti rrezikonte jetën e tij, të gruas dhe të fëmijëve.

Vetëm tani filloi të kërkojë këllëfin ku koloneli mbante pistoletën.

E gjeti në vendin më të gabuar. Silva nga nxitimi, e kishte futur bashkë në një nga sirtarët e komosë ku mbante të brendshmet e saj. Iliri e nxori, e vuri pranë uniformës së kolonelit, vënë në një varëse në sallon dhe filloi të sistemojë shtëpinë siç e gjeti. U kujtua, nxorri shaminë nga xhepi dhe fshiu gjurmët e gishtave që kishte lënë tek arma. Së shpejti mund të bëheshin verifikime dhe ai donte të shmangte ndërlikime të kota.

Niko Palushi, eksperti i balistikës në DPK, nuk kishte ikur ende në shtëpi. Menjëherë, pasi ishte larguar inspektor Iliri, ai kishte nisur të bënte disa verifikime të tjera. Së pari, kishte numrin e armës, një pistoletë e regjistruar dhe, pas disa kërkimesh në rrjetin informatik sekret, kishte gjetur që arma i përkiste këshilltarit të Presidentit, Kolonel Arben Bardhit. Dinte që arma e tij kishte qëlluar, kishte të skanerizuar gëzhojën që i dha inspektor Iliri për verifikim. Në duart e tij kalonte gjithçka. Pas atentatit ndaj Presidentit, Inspektor Iliri kishte gjetur vetëm një gëzhojë, kurse të shtënat kishin qenë katër. Tre të tjerat ndodheshin në një sirtar, të ruajtura nga Niko me kujdes.

Vetëm pas këtyre saktësimeve, Niko Palushi doli nga zyra. Dhe nuk mori rrugën e shtëpisë. Mori ashensorin dhe u ngjit vetëm një kat më lart, në zyrën e shefit të DPK-së. Dhe bëri kallëzim për vrasje të mbetur në tentativë ndaj Presdentit të vendit, në ngarkim të kolonel Arben Bardhit. Ilirin nuk e përmendi fare, se nuk i kishte qejf telashet me të, përherë dilte i humbur.

20

Nata e parë e martesës?

U kthyen në shtëpi përpara kohe. Koloneli vuri re që Silva nuk ishte fare e qetë. Kishte ndryshuar krejtësisht, nga mëngjesi në mbrëmje. 'Mbase e ka nga pesha e vendimit që ka marrë. Nuk ka pasur një përvojë të lumtur në marrëdhëniet me burrat.' tha me vete tek i hidhte nga një vështrim të shpejtë profilit të saj, ndërsa po i grahte makinës.

Atje në hotelin e Ujëmirës, gjithçka kishte filluar ndryshe. Përpara se Silva të dorëzonte çelësat, kishte mbyllur edhe një herë dhomën, nga brenda. Aty, i ishte dhënë për herë të parë kolonelit, edhe pse njohja e tyre vazhdonte me ulje e ngritje që prej një viti. Dhe ishte e ndjerë e zotëruar mirë prej tij, këtë mëngjes. Koloneli, në dashuri nuk e kishte atë pasionin e vrullshëm, por ishte metodik, dinte të kalonte mirë nga një etapë në tjetrën dhe të mos zhgënjente në çastin e duhur. Silva ishte çliruar tërësisht, përpara se të nisej. I kishte hedhur prapa edhe hamendjet që i kishin lindur mbi Ilirin, pas një të tundur të flokëve. Për këtë kishte ndihmuar edhe vonesa e

tij, harrimi total. Jo, ndaj Ilirit, Silva nuk donte të ushqente asnjë iluzion. Kërkonte një mbështetje solide dhe atë e kishte gjetur tek koloneli.

Por, ja që dita kishte rezervuar kthesa të papritura. Silva sapo kishte mësuar një të vërtetë të tmerrshme, që ia rrëzonte të gjitha iluzionet e ngritura për dy vjet me radhë, në lidhje me kolonelin. Kishte pasur ndërmend të krijonte familje dhe ky ishte kufiri i fundit për të. Sapo i kishte mbushur të dyzetat dhe gjetja e një partneri vetëm shtatë vjet më i madh, siç ishte koloneli, ishte një rast që nuk mund t'i ikte nga dora.

Koloneli ishte gati ta pyeste, por bisedën e hapi ajo e para.

"Beni, nesër është e premte. Habitem si nuk më ke thënë një fjalë për presidentin?"

"Ah, për këtë merakosesh ti? Unë kujtova se u pendove që dhe fjalën për martesë."

"Çfarë, por bën shaka tani? Nuk është diçka për t'u merakosur?"

"Na vjen keq, njësoj si për të gjithë ata që vuajnë si Presidenti. Nuk ka ndodhur ndonjë gjë e padëgjuar. Kanë ngujuar një familjar, me gruan dhe fëmijët. Vetëm se, në këtë rast, e ka pësuar Presidenti!"

Silva ia nguli sytë hetues profilit të tij. Nuk i lëvizte asnjë muskul, nuk kishte pësuar asnjë ngërdheshje apo grimasë. Një fytyrë krejt e pandjeshme.

"Ti po bën shaka me mua?"

"Jo, Silva! Dhe kjo është e keqja, që e gjitha duket si një shaka. Mund të jetë vendim i Presidentit. Dikush e ka kërcënuar dhe ai është mbyllur brenda. Ta thashë, nuk është as i pari e as i fundit!"

"Po, nesër ai duhet të udhëtojë jashtë shtetit?"

“Ç’ka këtu për t’u habitur! Edhe të tjerët që ngujohen, nuk është se nuk kanë se çfarë bëjnë dhe rrinë brenda. Edhe ai fshatari i gjorë, po e marr si shembull, nuk del dot në arë, nuk afrohet dot as tek katoi ku i bulurasin qetë për parmendë, ku i blegërijnë delet për ca bar të njomë... Ai e ka më keq se ngujon edhe kafshët brenda, të cilat nuk kanë vërtet faj. Kurse njerëzit vendosin vetë...”

“Po, nesër është dita e anëtarësimit në ANM!”

“Vëri në balancë vetë. Kush është më i rëndësishëm, anëtarësimi në ANM, apo një fëmijë që kërkon të dalë jashtë e nuk del dot? Ose, dy fëmijë, të kapur dorë për dore për të shkuar në shkollë dhe sharrohen nga plumbat! Kush është më i rëndësishëm? Fol, Silva?”

Kolonel Bardhi ulëriti me të madhe, duke nxjerrë jashtë një tension të akumuluar prej kohësh. Silva nuk e ngacmoi, por filloi të çuditej edhe më shumë. Pak më parë, koloneli ishte njeriu më moskokëçarës në botë, që vinte nga një mbrëmje me të dashurën dhe që nuk donte t’ia dinte për asgjë. Tani, fillon e ulëret i revoltuar. ‘Qenka e vërtetë. Ky është çmendur fare! Sa ka marrë vesh që janë vrarë dy fëmijë, që kanë thyer ngujimin, ky ka marrë armën dhe ka kërcënuar Presidentin!’ po mendonte Silva.

Nuk folën derisa hynë në apartamentin e tyre. Silvës i shkuan sytë menjëherë tek pistoleta në këllëfin pas derës. ‘Ok, Iliri e paska gjetur!’ tha me vete dhe eci më një hap tjetër, filloi t’i kryente veprimet më shpejt. Madje, po ndjehej disi e çliruar, ishte gati të bisedonte, të qeshte, të bënte çfarëdo që do t’ia diktonte rrethana. Nuk po e kuptonte shkakun e këtij ndryshimi të brendshëm. Mbase ishte reagimi i Arbenit. Nuk i

dukej sjellja e një njeriu që merr pistoletë për të vrarë. Nuk kishte më fare frikë prej tij.

Në këto çaste, koloneli ishte pas shpinës së saj, me pistoletën në dorë.

"Ke frikë?" i tha ai.

"Për çfarë?"

"Të kam drejtuar pistoletën. Nuk e shikon?"

"Frika fillon ku mungon besimi. Unë kam besim tek ty Beni!"

"Besimi nuk është një e dhënë e pandryshuar. Ai duhet përtërirë!"

"Dhe ti sapo e bëre!"

Silva i mori pistoletën. Ia la në tavolinë dhe i hodhi duart në qafë.

"Nesër do të njoh më një mikun tim të vjetër. Emrin nuk po ta them. Kam dëshirë të ta lë si surprizë."

Shkuan në dhomën e gjumit dhe filluan të zhvishen.

"Do flemë?" pyeti Silva.

"Po. Është ca herët. Po edhe ne jemi të lodhur!"

"Nuk pyete një herë për Presidentin? Bëji një telefonatë, të paktën."

"Presidentit? Nuk kam asgjë për t'i thënë!"

Silvës iu kthye turbullimi i mëparshëm, por ai ishte sidoqoftë më i dobët se lodhja.

E këputi gjumi në krahët e tij, por ai kishte ndërmend ta zgjonte.

21

Një vizitor i huaj

Vrojtuesi, kishte mbërritur i pari në rrënojat e qytetit antik. Të gjithë kështu e njihnin, me një palë dylbi në qafë, me të cilat i gëzohej peizazheve mahnitës, siç thoshte ai shpesh. Por, në të vërtetë, ai kishte ardhur për të vrarë.

Me të mbaruar misionin, do të largohej andej nga kishte ardhur, siç kishte ndodhur në dhjetëra raste. Bënte një jetë të dyfishtë, zgjidhte për një kohë një profesion, e ushtronte gjithë pasion për atë periudhë, kryente vrasjet e radhës dhe zhdukej në një vend tjetër, me një profesion tjetër e objektiv tjetër. Këtë radhë ishte kamufluar si instruktor i trupave speciale, me kombësi të paqartë. Quhej Roland Garther dhe ishte thirrur me urgjencë, për eliminimin e Gegë Toskës.

Ditë me radhë, ai e kishte studiuar terrenin mirë dhe e kishte menduar ndalesën e tij në këtë qytet të lashtë, duke e llogaritur si vendin e një ndeshjeje të mundshme. Nuk kishte preferuar ta ndiqte Gegën në marshim, duke i menduar të

pakta shanset për ta vrarë atje, prandaj e ftonte të ndeshej këtu në fushë të hapur.

Shteti e dinte që Gegës i kishte borxh, në një farë mënyre, dhe nxitonte ta eliminonte i pari, përpara se ai të kërcënonte seriozisht shtetin. Shteti i ishte borxhli, sepse ai kishte kallëzuar në polici, që kanosej vetë dhe familja e tij dhe pastaj i sigurt se shteti do të vepronte, kishte dalë vetë edhe nga ngujimi.

Roland Garther, kishte hyrë në veprim shumë shpejt. Ai në fakt ndodhej me kohë në këtë vend. Qëndronte në një hotel luksoz të kryeqytetit, në pritje të rastit për t'u përdorur.

Tani kishte zënë vend në portën hyrëse. Vuri dylbitë me rreze infra të kuqe dhe filloi të vrojtojë natën, për herë të parë në këtë mision.

Gegë Toska, e njihte shumë mirë armikun e tij. E dinte që Bim Hyka e ndiqte, që prej 13 orësh, i rraskapitur. E kontrollonte në distancë afrimin e tij, pasi vepronte në terrenin e tij. Këndej kishin zhvilluar lojën e fundit ushtarake në vitin 1987 dhe këto vende ai e kishte shkelur pëllëmbë për pëllëmbë, si oficer këmbësorie.

Gega nuk e kuptonte përse ishte ndërsyer pikërisht Bim Hyka për ta ndjekur. Ai priste një tjetër për t'u ndeshur, të cilin e kishte parë nga afër duke vepruar.

I doli Bimit pas krahëve dhe në ndalesën e parë i drejtoi armën rrëzë veshit.

Tjetri nuk e kishte pritur këtë sulm të beftë të kundërshtarit. Sipas tij, Gega ndiqej dhe duhej të ikte, sulmohej dhe duhej të mbrohej. Shkurt, e kishte vlerësuar Gegën si një të trembur, që ka marrë arratinë, pa qenë i zoti të kthejë kokën

prapa, mendim ky që i ishte përforcuar që nga çasti kur e ndeshi në hotelin e Liqeneve.

"Ule armën Bim Hyka!"

Gega kuptoi pavendosmërinë e tjetrit për të vepruar, poshtërimin që i lexohej në sytë dhe shtoi: "Unë e kuptoj pozicionin tënd, se kam qenë vetë ushtarak. Ule armën që të bisedojmë! Kam shumë gjëra për të sqaruar."

"Nuk pres sqarime nga një vrasës, si ti! Fitove, tani qëllo! Jepi fund këtij muhabeti!"

"Ule armën!"

Bim Hyka la poshtë automatikun e shkurtër për luftim në distancë të afërt. Në brendësi, diku poshtë sqetullës nga ana e zemrës mbante edhe një pistoletë të vogël, por për momentin nuk deshi të vepronte. Gjatë heqjes së automatikut nga qafa, mund të merrte njëkohësisht edhe pistoletën me një veprim të shpejtë. Sa herë e kishte bërë këtë veprim në stërvitje. La armën dhe deshi të ngrinte duart lart, por Gega ia uli dhe i zgjati dorën. Pastaj, duke e parë drejt në sy i dha edhe automatikun.

"Kemi një armik tjetër, që të dy. Jam i sigurt që do të ndeshemi me të. Është shumë i përgatitur, e kam parë duke vepruar, duke vrarë..."

"Për kë ke fjalën?" e pyeti Bimi.

"Është një tip me dylbi në qafë, duket biond, por më shumë është i thinjur, rreth të pesëdhjetave. Flet me theks prej të huaji."

"Roland Garther! Është ekspert pranë trupave speciale! Nga e ke parë atë?" u habit Bimi.

Gega u ul i pari. Pranë tij u afrua Bimi gjithë kureshtje.

"E bëjmë tani pushimin. Hamë dhe një kafshatë bukë që të marrim pak fuqi. Më ka mbetur edhe pak kafe e ftohtë, për në fund."

Bimi nuk foli. Po ndiqte Gegën, që tani e kishte me shpinë, duke nxjerrë gavetën, lugën me bisht të shkurtër, termusin e kafesë. Kishte kohë sa të duash t'i qëllonte me një send të fortë pas koke, ose të nxirrte pistoletën e sigurisë dhe ta çarmatoste, apo, në fund të fundit, ta vriste. Të gjitha këto i shkuan në mend rrufeshëm. Sakaq, Gega ktheu kokën dhe mbi Bimin ranë sytë e tij të qetë, prej prindi që sapo ka humbur dy fëmijë dhe nuk e vret shumë mendjen se ç'mund të ndodhë me jetën e tij, sepse përndryshe do të vepronte më me kujdes.

"Më pyete për atë të huajin, ekspertin e vdekjes. Hapi veshët mirë. Më ka ndjekur që në fillim. Pas momentit të uljes së helikopterit, ju të gjithë besoj keni shkuar nëpër kapanonet dhe nuk e keni vënë re nga është zhdukur Gartheri, kështu ia the mbiemrin më duket."

"Po, Roland Garther, ekspert i huaj i ndjekjes. Në fakt, asnjeri nuk e di saktësisht se nga cili vend është."

"Unë kisha dalë nga shtëpia prej kohësh. Kisha marrë makinën dhe doja të merrja autorrugën drejt kryeqytetit..."

"Pse drejt kryeqytetit?"

"Mos më ndërprit!"

Gega i hodhi një shikim të prerë.

"Kam bërë vetëm dhjetë kilometra rrugë, kur pashë së largu postobllokun e parë. Isha me fat, gjeta një vend ku autorruga nuk kishte mbrojtëse metalike dhe dola djathtas, lashë makinën e fshehur brenda ca shkurreve dhe hartova një plan tjetër. Do të merrja këtë rrugë ku u poqëm bashkë. E kisha shumë të njohur që nga koha e zboreve ushtarake. Ti je i ri, për shembull dhe nuk e di ç'është zbori. Nejse, shëtita me duar në xhepa,

i dërrmuar nga ajo që më kishte ndodhur dhe vajta për herë të dytë në shtëpi. Herën e parë kisha marrë vetëm çantën dhe pistoletën. Tani mora edhe paguren e ujit, gavetën, këtë lugë...”

Gega pushoi një çast dhe pa nga Bimi. “Ti nuk ke lugë, po dikur hanim edhe dy veta, apo më shumë, me një lugë, qëllonte. Po, ne e bëjmë kështu. Ha ti në fillim, përderisa unë po flas dhe më vonë kur të mbushet mendja ty për të folur ma jep lugën mua.”

Bimi hezitoi pak, por pastaj filloi të hajë. Ishin fasule! Fantastike, pale qëkur nuk kishte ngrënë.

“Vendosa t’i bëja një vizitë Palokë Lleshit. Ndodhi çfarë ndodhi, thashë po ky si nuk më erdhi në varrim. Kisha kohë, se doja ta nisja marshimin kur të binte nata. Nuk doja që të më shikonte askush në momentin e largimit nga Sektori, pikërisht pse doja të zgjidhja marshimin në këtë rrugë, si dikur. Nuk kisha nevoja vetëm të largohesha, por edhe të reflektoja.

“E gjeta në oborr. Sytë më vajtën menjëherë tek një palë pantallona të nderura dhe ca çizme gjuetie me kokë poshtë. Po nuk mu dha ta pyesja e as të dyshoja. Do kujtohesha vetëm disa orë më vonë, gjatë një pushimi si tani, natën tre orë larg, kur Paloka nuk jetonte më, që pas krismave, të asaj të premteje të zezë, një njeri kishte kaluar lumin në këmbë...”

Bim Hyka kishte mbaruar së ngrëni, por nuk ia zgjati lugën, se nuk donte ta ndërpriste.

“Ai më pa dhe hyri me vrap brenda, pa përshëndetur, pa më lënë t’i thosha një fjalë. Doli me automatik në dorë, ishte i zbehtë në fytyrë, i frikësuar për vdekje. ‘Hej, burrë i dheut’, i thashë. ‘Kam ardhë me u falë me ty, se do të iki. Kjo punë kështu e pat. Po iki përgjithmonë’. Paloka nuk

kuptonte asgjë. Armën e kishte mbushur dhe e kishte hequr nga siguresa që brenda. Unë nuk kisha kohë të nxirja pistoletën, se nuk isha i përgatitur për një çast të tillë. E kuptova se do më qëllonte, ishte në një gjendje shoku. Dhe, isha gati të mbyllja sytë, stomaku m'u mblodh, më erdhën në mend fluturimthi fytyrat e fëmijëve dhe e Lezes. Ky ishte fundi, mendova. Kur, pashë Palokën me dy vrima, gati të menjëhershme në ballë, si t'i ishin ulur aty dy miza. Ndenji pak çaste në këmbë, fraksione të sekondës, se në fakt kishte mbaruar menjëherë. Si ta them, kur pret me kosë një kërcell të njomë dhe ai për ca kohë rri drejt, pastaj këputet... Ktheva kokën dhe pashë në këmbë vrasësin, që më qeshi dhe më foli. 'Tungjatjeta!' Iu desh shumë kohë për ta thënë atë fjalë të vetme, e kuptova që ishte i huaj. Mbante në dorë një armë automatike të shkurtër, me silenciator. E kuptova që nuk kishte ndërmend të më qëllonte dhe nuk provova të reagoja. Bëri me dorë dhe u duk sikur iku. Unë dola me hap të shpejtë dhe thashë të merrja malin menjëherë, por u kujtova që kisha lënë pas një të vdekur dhe vrasja do të më ngarkohej mua."

"Gegë, lugën!" i tha Bimi.

"Ah, më fal! Ke ndonjë gjë për të thënë ti? Do që ta lë?"

"Jo, jo, por edhe ha nga një çikë! Kush e ka sjellë këtu atë njeri? Ekspert i huaj, thonë, sikur kjo mjafton."

"Për të vrarë, ishte ekspert që ç'ke me të!

Gega lëvizi nga vendi dhe mori një lugë groshë.

"Vendosa të shkoj nga Nika. E ndjeja veten të pajtuar me të, që pas çastit kur erdhi të pijë kafe për nipin tim dhe ish dhëndrin e tij, Luan Pepën. Ishim vetëm shokë, nipi na bëri miq, pastaj na

bëri hasëm. E lau me jetë krimin e tij! Plagët janë të rënda, por mbyllen një ditë. Mendova se Nika e ka pasur të vështirë të vijë në varrimin e fëmijëve, për një mijë motive. Por, në asnjë çast, nuk e kam menduar si vrasës të tyre. Më shumë, më qante zemra për ndonjë keqkuptim. Nuk arrija ta lidhja më vrasjen e tyre me hasmërinë që kishim pasur. Ç'punë kishin fëmijët, ja tek më kishin mua!"

Gega futi një lugë tjetër groshë, i tulatur nga mendimi për fëmijët. Kur u duk se nuk do të vazhdonte më, u përtyp dhe e gëlltiti gjellën menjëherë.

"Ai biondi, Gartheri, më kishte ndjekur! Gjithçka ishte e llogaritur në mënyrë të përpiktë. Hartuesi i këtij plani, merrte vesh goxha edhe nga psikologjia e sjelljes. Ishte parashikuar reagimi im, deri në detaje. Edhe postoblloku që më kishin vënë dhjetë kilometra pas hyrjes në autorrugë, ka mundësi të ishte vepër e atij biondit."

"Mundet!" tha Bimi. "Ne ende nuk ishim organizuar. Është fjala për orën 8, pak a shumë."

"Tamam, gati po errej. Biondi më kishte ndjekur, nga afër, pastaj më kishte kaluar. Derën e Nikë Camajt e gjeta hapur. Pata menjëherë një parandjenjë të keqe. Hyra në sallon dhe mora shkallët për në katin e dytë. Që në kthesën e parë, pas pushimit midis shkallëve, e pashë pranë një pellgu gjaku, me dy mizat e mëdha në ballë që dukeshin sikur ia thithnin lëngun nga thellësia. E njëjta armë, e njëjta dorë, biondi. M'u nxeh gjaku. Nika kishte qenë shoku im, miku im dhe hasmi im. Me të ndaja një pjesë të madhe të jetës. Vrapova i nxitur nga një forcë e befasishme. Dola turravrap jashtë, por nuk po dija se nga t'ia mbaja. Pak e nga pak, arsyeja filloi të mbizotërojë mbi emocionet. Thua ta kem radhën unë tani,

thashë me vete. Ashtu mendova, në ato çaste, dhe vendosa të fshihesha, derisa të binte mirë nata, nuk doja të kishte asnjë lëvizje përpara se të filloja marshimin tim.

"Por, nuk më la kureshtja dhe meraku të largohesha menjëherë atë natë. Fjeta në një tunel, në njërin nga ata që kanë brenda rëndom municione të ushtrisë. Me kokën mu tek dera metalike, në thellësi. Aty e kalova edhe gjithë ditën, duke sjellë ndër mend krejt jetën e shkurtër të fëmijëve të mi. Kam qeshur, kam qarë, kam biseduar, kam ngrënë nga këto fasulet gjysmë të gatshme të ushtrisë, derisa erdhi edhe një herë nata. Fjeta dhe kur u zgjova, kisha vendosur që të shkoja në polici, për të dëshmuar.

"Kin Uldeda e ka shtëpinë jo larg vendit ku kisha kaluar natën. Ka raste që nxjerr makinën e tij foristradë në lumë dhe e lan, duke ecur në kundërrrjedhë. I mbyll xhamat dhe i jep gaz fort. Makina përfshihet nga uji, duke gulçuar në tendencë për t'u shkulur përpara dhe pas disa minutash ai e nxjerr në zallishtë që të thahet nën rrezet e diellit. Këtë veprim të tij e kisha parë kushedi sa herë. Kështu po bënte edhe atë mëngjes, si duket. E mendova veten me fat. Makina ishte midis lumit në kundërrrjedhë. Po prisja që të dilte në zall. Pritja m'u duk e gjatë dhe më në fund i thirra. Nuk mora përgjigje. Atëherë u shqetësova, mos i ka hyrë uji brenda dhe nuk arrin të manovrojë. Hyra në ujë dhe me një gur theva xhamin e shoferit. E gjeta me kokën në timon. Kam lënë gjurmë gishtash në flokët e tij. E kapa dhe e ngrita. Përsëri ato dy mizat e mëdha në ballë."

"E pabesueshme!" tha Bimi.

“Unë nuk kisha kohë për t’u habitur. U ktheva edhe një herë në tunelin tim dhe fillova të pres natën.”

Bim Hyka kishte mbetur si i shtangur: nuk ishte në gjendje të formulonte asnjë pyetje. “Ha, mbaro tani, Gegë. Duhet të përgatitemi. Nuk i dihet se ku e do ta ndalë hapin ky biondi!”

“E di ku jemi?” pyeti Bimi.

“Jemi pesë deri në gjashtë orë larg, në këmbë nga kryeqyteti, por, nëse bëjmë një marshim normal. Do të thotë që në mëngjes jemi atje!”

“Pse duhet të jemi atje?” pyeti përsëri më me ngulm Bim Hyka.

“Më mirë të jemi ne atje, se dikush tjetër, siç kanë ardhur punët! Ti, e the mirë nuk e dimë se ku do ta ndalë frymën ky biondi. Kam një parandjenjë që na pret diku. Ai ka udhëtuar rehat, me helikopterin e Forcave Speciale dhe mund të na zërë pritë ku të dojë. Një gjë është qartë, terrenin e ka studiuar shumë mirë. Dhe, pas kësaj gryke, dilet vetëm në një shteg, i cili të fut në rrënojat e një qyteti antik, si e ka emrin, mor, se e harrova. Nejse, ka shumë mundësi që ai të na zërë pritë aty. Pasi më vonë nuk na bllokon dot lehtë, kemi më shumë liri veprimi. Dhe duhet të jetë i vetëm. E di, përse?” Gega heshti një çast. “Nuk ja merr mendja që ne jemi bërë bashkë! Të vetmen gjë që nuk e ka menduar!”

Gega nxori hartën e tij topografike, në të cilën paraqitej edhe qyteti. Filluan të hartojnë një plan.

22

Taksa e gjakut

Iliri nuk vuri gjumë në sy gjithë natën. Shkoi në zyrën e tij në DPK dhe vendosi të mos luante më vendit deri në mëngjes, duke e pritur aty zhvillimin e ngjarjeve.

Filloi të merrej me faksin e gjatë të Tomë Keqit. Ky, në fillim e kishte kopjuar defterin e Palokë Lleshit në fletë formati A4, pastaj e kishte dërguar me faks.

Inspektori, ndërkohë kalonte faqet, një e nga një. Njëherë u detyrua të furnizonte mjetin me letër, se dokumenti ishte shumë i gjatë. Nga çfarë shikonte e kishte të vështirë të deshifronte. Faksi e bënte edhe më të pakuptueshëm shkrimin e dorës së ish ndërmjetësit të vrarë. Megjithatë, mundi të krijonte shkallë-shkallë idenë, se për çfarë bëhej fjalë. Kishte shifra kryesisht, llogari, që në krye të çdo faqeje mbanin nga një datë, me përqindje të ndarjes së shumës dhe nga një spuntim në fund për të shënuar që shumat ishin shlyer në rregull.

Ia ku i erdhi një faqe e shkruar më keq se të tjerat, më me nervozizëm, mbante datën 12 mars, duhet të ishte shkruar pas krimit.

Vërtetonte gjithçka kishte kallëzuar në polici përballë Kin Uldedës, Gegë Toska, tre ditë përpara krimit, më 9 mars. Në defter Palokë Lleshi, shënonte si të pashlyer shumën prej 20 mijë euro.

Por, inspektor Iliri nuk arrinte ta bindte veten plotësisht, se ndërmjetësi Palokë Lleshi kishte qëlluar mbi fëmijët për një shumë të papaguar, të pritur e të premtuar prej kohësh, por që i mungon në momentin e fundit. Të qëllosh për të vrarë, është diçka shumë personale, kërkon një shtysë të fortë emotive. E kundërta, ndodh me vrasësit profesionistë, të cilët zakonisht nuk e njohin viktimën, nuk kanë asnjë lidhje me të dhe për ta, ajo bëhet vetëm një objektiv që duhet eliminuar.

Paloka nuk njihej si vrasës. Kishte punuar gjithë jetën gardian burgu dhe e merrte pensionin nga ajo punë. I kishte ndodhur vite më parë të keqtrajtonte të burgosur, por nuk kishte bërë asgjë jashtë rregullave të kohës. Një herë kishte qëlluar dy shokë, të burgosur politikë, që tentuan arratisjen nga kampi. Nuk ishte i vetëm, kishin qëlluar në grup, me një skuadër pushkatarësh nën komandën e oficerit. Të burgosurit ishin pikasur me kohë, të spiunuar nga të burgosur të tjerë, pastaj ishin lënë të kryenin aktin e tyre. Në kohën kur ata kishin besuar se çdo gjë po u shkonte për bukuri, një skuadër pushkatarësh kishte mbirë pesëdhjetë metra larg tyre. Kishin pasur kohë të merrnin pozicion, në rresht, si gjatë ekzekutimit të pushkatimeve dhe kishin qëlluar. E gjitha kjo ishte bërë për t'u dhënë një mësim të burgosurve të tjerë, të cilët ishin nxjerrë pa

zhurmë në oborr për të parë skenën. Trupat e tyre nuk arritën të bien në tokë, mbetën të ngatërruar nëpër tela, pa jetë.

Vetëm këtë rast, i referonte major Toma, inspektorit, mbi të shkuarën e Palokë Lleshit. Kjo nuk provonte që Palokë Lleshi kishte një prirje të veçantë për të vrarë dhe, aq më pak, që këtë ta ushtronte si profesion.

Diçka tjetër e grishte inspektorin. Faturat e detajuara, përqindjet e shumës 20 mijë euro, të ndara në tri kolona. Nuk kishte kolonë 20 %, për TVSH-në, nuk është se xhiroja deklarohej në shtet, sigurisht, por disa ndarje të tjera, pa sigla shpjeguese lart, mbase për ruajtje sekreti, por me përqindje të qarta, e para 60 %, e dyta 25 %, e treta 15 %. Nga një vrasje e zakonshme, përfitonin tre palë. I pari, që merrte shumën më të madhe, mund të ishte vrasësi, po dy të tjerët, kush ishin? Ta zëmë njëri ishte ndërmjetësi, po i treti? Kush e fitonte 15 % të shumës nga një vrasje? Apo nga një falje gjaku?

Mbase, Palokë Lleshi ishte ngutur për të qëlluar, që të merrte vetë 60 %, që i takonte vrasësit.

Inspektor Iliri kishte vënë re një makutëri të rrallë në shumë njerëz të brezit të Palokës, të cilët e kishin mbyllur periudhën e tyre aktive në regjimin e vjetër, pa mundur të sigurojnë të ardhura, përveç bukës së gojës. Një pjesë e tyre, bënin çmos për të fituar kohën e humbur. Kishte prindër, nga ky brez që pranonin vjedhjet e fëmijëve të tyre në vendet fqinje, apo prostitucionin e vajzave të tyre. Kurse të tjerë, ishin bërë vetë aktivë, duke u marrë me ndërmjetësime të gjitha llojeve. Përpara

ambasadave, shikoje jo pak nga ky brez, të kollarisur, me makina shkrimi në dorë, duke ofruar shërbime nga më të çuditshmet. I gjeje përpara stadiumeve, me biletat e ndeshjes më të rëndomtë, të cilat dikush i shiste nën dorë tek të tjerë që u shtonin çmimin. Pa le, pastaj kur bëhej fjalë për ndeshje të kombëtares. Ndërmjetësimin e merrnin në dorë ustallarë të një rangu më të lartë. E keqja më e madhe ishte kur njerëz të tillë hipnin në pushtet, se bënin shumë më tepër dëm.

Palokë Lleshi nga gardian burgu ishte bërë ndërmjetës. I donte paratë dhe, me sa duket, i nxirrte nga derdhja ose nga falja e gjakut. Por, nuk punonte i vetëm. Ishte dikush tjetër, më i fuqishëm, që komandonte dhe të ftonte ose të hyje në rrjet, ose të eliminonte. Palokë Lleshi kishte hyrë në rrjet. Inspektori, megjithatë mendonte një motiv tjetër, si shtysë për vrasjen e fëmijëve. Atë mëngjes, fëmijët, si gjithë kohën përpara ngujimit, i kishin kaluar m'u në mes të oborrit të tij, se andej binte rruga. Pra, kishte kohë që nuk e bezdisnin, nuk ia ngacmonin kujtimet e tij për nipërit e larguar. Palokë Lleshi ishte braktisur nga të gjithë të afërmit e tij, si shumë të moshuar të tjerë në fshat. Dhe, ja befas, ata i dalin sërish para syve dhe i kalojnë mes për mes oborrit të tij. Paloka, me sa duket, i kishte lënë edhe atë mëngjes të kalonin përpara hundës së tij, por tani ishte bërë gati. Kishte veshur çizmet e gjuetisë dhe do të priste lumin shkurt për t'u dalë përpara, tek kthesa, pas së cilës zhdukeshin shtëpitë e lagjes së tyre. Për inspektorin, Palokë Lleshi kishte qëlluar njësoj si ndaj të burgosurve. Fëmijët kishin dalë nga ngujimi, nga burgu që ai u kishte caktuar dhe do të vazhdonin të kalonin dy herë në

ditë nga oborri i tij, se andej kalonte rruga. Për ca kohë, ai e kishte fashitur pezmin e tij ndaj fqinjëve, se ishin *mbyll mbrenë*. Ai kishte pritur që kjo punë të mbaronte keq për Gegën dhe familjen e tij, se e kishin hak: kollaj fare e kishin, po të donin, të iknin si të tjerët, në kryeqytet, apo të fshiheshin diku jashtë shtetit, mjaft që të shkuleshin prej këtu. Iliri, i jepte peshë kryesore këtij motivi, shpërngulja e Gegë Toskës, me çdo kusht, nga trojet e falura dikur prej një Lleshi të marrë!

'Dhe, me sa duket, ia ka dalë! Gegë Toska, tani ka marrë arratinë! Por me një çmim shumë të lartë, vdekjen!' mendoi Iliri dhe vazhdonte të shikonte shiritin e gjatë të faksit, me fatura të tjera.

Dy, do të ishin atëherë kundërshtarët e mundshëm të aktit të vrasjes së fëmijëve nga Paloka, të interesuar edhe për ta vrarë, siç edhe ndodhi. Njëra palë, sigurisht, është Gega, i ati i fëmijëve që sulet ndaj tij, pa ditur se ka shtirë mbi ta, siç do të merrej vesh më vonë, çuditërisht. Gega mund ta ketë vrarë thjesht nga dëshpërimi.

Mirëpo, tani inspektori i mbështjellë i tëri me këtë faks të gjatë, filloi të mendojë, se vrasja e fëmijëve, mund të ishte një akt i nxituar i Palokës, i paautorizuar për t'u bërë nga dikush. Edhe në Kuvendin e Logut të Zanave, ishte përmendur se vrasja e fëmijëve dhe grave nuk mund të pranohej. Palokë Lleshi kishte kryer një precedent, ishte i pari që kishte shkelur një normë të pacenueshme dhe prandaj duhej ndëshkuar.

Inspektori nuk deshi të shkonte më larg në hamendjet e tij. I erdhi në mend zyra e kryemisionarit, Prekë Prela, me ato botimet e tij

me banesa ngujimi dhe filloi të nervozohej më keq se ato çaste kur kishte shkelur në zyrën e tij.

Largoi fashikujt e defterit të taksave të gjakut dhe hapi dritaren. Gjatë gjithë ditës kishte qenë një kohë e vrenjtur, tani kishte dalë hëna e plotë. Nuk e kishte ndër mend të flinte atë natë.

Nga çasti në çast, priste një telefonatë nga Silva dhe sa më shumë ajo vonohej, ankthi i tij rritej.

23

‘Biondi’ qëllon nga afër

Pak çaste më parë, Gega e pat mbështjellë hartën dhe e kishte futur në xhep, i menduar. Bim Hyka nuk po dinte çfarë të bënte. Diçka kishte ngecur në planet e tyre, ose më mirë planet e tyre ishin ende të errëta.

Por, vetëm deri pak çaste më parë.

Tani një puhi e lehtë po u rrihte fytyrat, ndërsa në qiell pati një lëvizje të shpejtë resh. Gega filloi të çelej i gjallëruar nga mendimi se gjithçka mund të kthehej në favorin e tyre, me daljen e hënës. Duhej dritë mbi fushëbetejë, duhej një prozhektor gjigant, për të ndriçuar çdo skutë të qytetit antik. Dhe këtë mund ta bënte si s’ka më mirë një hënë pesëmbëdhjetëshe, e cila sapo çau retë me një pompozitet perëndish.

“Ja, tha Gega, tani mund të bisedohet! Avantazhi i tij ishte nata. Ai e ka armën me dylbi që shikojnë natën. E kishte të montuar kur qëlloi mbi Palokë Lleshin! Tani jemi të barabartë!” tha Gega.

“Tani jemi dy me një!” iu përgjigj Bim Hyka.

“Ke të drejtë, por kemi të bëjmë me një kundërshtar të fortë! Dy me një, është pak për një profesionist si ai!”

Doli në fillim Gega, ndërsa Bim Hyka ndenji i fshehur.

Gega pa orën, ishte tre e natës.

Kaloi murin rrethues dhe filloi të kontrollojë me kujdes qytetin, rrugë më rrugë. Nuk dëgjohej asnjë zhurmë dhe hëna mbulohej herë pas here, kërcënueshëm, nga retë.

Gega filloi të arsyetonte duke e vendosur veten në pozitat e ‘biondit’, vrasësit me pagesë. Një gjë ishte e qartë për Gegën. Roland Garther ishte një killer profesionist që kishte ardhur i joshur nga dikush. Thuhej se shërbente prej muajsh si ekspert i huaj i sigurisë pranë strukturave vendase, mirëpo vrasjet e tij seriale, dëshmitar okular i të cilave kishte qenë vetë Gega, e kishin çuar në përfundimin se Roland Garther ishte një njeri i punësuar. Duhej të kishte ‘punuar’, ndërkohë gjatë kësaj kohe, në fronte të tjera, pasi ngjarja e Sektorit dukej e papritur. Vrasja e fëmijëve të tij, duhej të kishte qenë një lajthitje e papranueshme për dikë që kishte nxituar të mbulonte diçka tjetër që fshihej pas tyre.

Gega kujtoi çizmet e Palokë Lleshit të ndera me kokë poshtë në oborr, pastaj i erdhi në mend sërish ajo pllaqurima nëpër lumë e një njeriu që largohej me mund nga vendi i krimit. Për të, tanimë gjithçka ishte e qartë, vrasësi i fëmijëve të tij ishte Palokë Lleshi, mbase i dëshpëruar dyfish, nga mospagimi i gjakut dhe sidomos nga largimi i perspektives së shpërnguljes së Toskëve. Kjo e dyta, dukej motivimi kryesor, nga ajo që kish dëgjuar të flitej për të nëpër milet. Dhe Gega, më

parë, nuk u kishte dhënë asnjë rëndësi këtyre fjalëve!

Po kujt i kishte interesuar zhdukja e Palokë Lleshit? Nisur nga fakti që ai ishte një misionar i pajtimit të gjaqeve, gjithçka të çonte në kupolën e këtij organizmi, në Misionin e Pajtimit. Mendja shkonte vetvetiu tek Prekë Prela. Gega e kishte njohur edhe atë, dy vjet më parë në Kuvendin e Logut të Zanave. Nga goja e tij ishte shqiptuar me forcë, ashpër, fraza 'nuk duhet të qëllohet mbi gra dhe fëmijë'. Dhe Palokë Lleshi, që e kishte thyer i pari këtë normë, duhej ndëshkuar. Deri tek vrasja e Palokës gjithçka dukej e motivuar: gaboi dhe u ndëshkua! Po Nikë Camaj? Përse Prekë Prela do të paguante edhe për eliminimin e tij? Ai nuk kishte vrarë. Apo mos ndoshta, askush nuk ishte ende i qartë se cili ishte në të vërtetë vrasësi i fëmijëve, Paloka apo Nika? Dhe i kishin ndëshkuar që të dy.

Vrasja e tretë, ajo e postëkomandant Kinit, dukej fare pa lidhje në këtë logjikë. Këtu Gega nuk arrinte të ngrinte kurrfarë hipoteze të besueshme. Por, në të gjithë këtë zinxhir, ai po harronte veten. Përse 'biondi' e kishte lënë gjallë në fillim dhe më pas e kishte ndjekur për ta eliminuar? E qartë! I qe dashur kohë për t'ia ngarkuar Gegës vrasjet në kurriz, ato të Palokës dhe të Nikës, në lidhje me fëmijët dhe atë Kinit, më pas, si reagim i një krimineli në ndjekje nga policia, i cili është nisur drejt rezidencës presidenciale, duke kërcënuar vetë kreun e shtetit.

Gega do të vazhdonte edhe më tej me arsyetimet e tij, por e kuptoi se më parë duhej të mendonte për gjendjen në të cilën ndodhej. Kishte përpara një kundërshtar që synonte ta eliminonte. Për të, pika e dobët e 'biondit' ishte që e mendonte veten në avantazh, dy me një, ai bashkë me Bimin

kundër Gegës. Dhe gabohej, ishte e kundërta. Gega kishte folur me Bim Hykën dhe këtë 'biondi' nuk kishte nga ta dinte. Në këtë dobësi, do ta mbështeste Gega gjithë planin e tij.

'Biondi' nuk qëllonte nga larg. Mbase i pëlqente të shikonte me sy viktimat, kushedi. Gega, e kishte kuptuar që ai qëllonte afër dhe me preçizion. Ndërsa ai vetë, mbante një pistoletë TB, ofensive, dhe mund të qëllonte në largësi më të madhe, që do të thotë, i pari. Mund t'i afrohej 'biondit', ballë për ballë, dhe të shfrytëzonte mbase këtë mani të tij për të qëlluar nga afër. Dhe, në çdo rast, ai kishte Bimin që do t'i mbulonte krahët.

Retë e fundit u davaritën plotësisht dhe hëna zu të ndriçonte si një ekran gjigant kopjuteri, me klikime përshkënditëse që të verbonin paksa kur i mbaje sytë gjatë në të.

Gega mbërriti tek Gurra e Dheut, që ishte një burim i ngadaltë, i një lumi të tërë, që rridhte më pas anës mureve të qytetit. Kishte vendosur të mbante një largësi sigurie nga bedenat prej rreth pesëdhjetë metrash. Nëse 'biondi' kishte ardhur, me siguri, po e vrojtonte brenda mureve.

Gega bëri një rrotullim të plotë rreth qytetit, me dorën në pistoletë. Kishte një parandjenjë se do ta gjente përballë me të mbërritur në portën kryesore. Do t'i qëllonte sapo ai të shfaqej, me pistoletën e tij TB, e cila, për fat, kishte më shumë cilësitë e një automatiku për luftim në distanca të mesme.

24

Trokitje natën

Të trokiturat në derë i dëgjoi e para Silva, ashtu siç ishte përgjumësh.

Kishin rënë herët në shtrat, por jo të flinin. Kjo ishte nata e parë e gjitha për ta, edhe pse njiheshin prej kohësh. Dita, sado e trazuar, për ata të dy kishte filluar në dhomën e hotelit në Ujëmirë, ku mbase kishin dashur të rrinin shumë më gjatë.

Silva kishte hezituar t'i jepej më parë, gjithmonë me atë frikën se marrëdhënia e saj nuk do të kishte të ardhme. Dhe kishte zgjedhur një moment si ky, çuditërisht në çastin kur ishte më e paqartë se kurrë mbi atë, se cili ishte në të vërtetë burri i saj i ardhshëm. Një njeri me botë, i ndjeshëm e profesionist në detyrë, apo një karrierist i pandreqshëm që po përgatiste një grusht shteti? Fjalët e fundit të thëna prej tij në mbrëmje, përpara se të binin në shtrat, e kishin qetësuar paksa. Ai ishte treguar njerëzor, kishte shprehur indinjatën e tij për vrasjen e fëmijëve të pafajshëm, por kjo Sivës nuk i kishte mjaftuar.

Kjo, nuk e përjashtonte aspak, përkundrazi, e nënkuptonte, që kolonel Bardhi të ishte atentatori i Presidentit, gjë për të cilën, Siva, për fat, ishte e garantuar edhe nga Iliri.

Tek rendi për të hapur derën, Siva mendoi për një çast, se mund të ishte vërtet Iliri në derë. Mbase kishte ndonjë të re në lidhje me fatin e Presidentit dhe vinte të kërkonte kolonelin.

Përpara se të rrotullonte çelësin, dera u drodh nga një e shtyrë e fuqishme, por duke qenë e blinduar, nuk lëvizi vendit.

Siva e hapi dhe pa tre njerëz të veshur në të zeza. Mendoi, se ky ishte fundi, për të dhe kolonelin. I pa me automatikët gati dhe mbylli sytë.

"Është i armatosur!" tha i pari.

Siva e mori veten, pasi pa një shenjë të qartë në supin e atij që foli. E kuptoi që ishin forca të rregullta të policisë së shtetit dhe mori pak zemër.

"Është në gjumë!" u përgjigj Siva me ironi.

Pastaj i pa se si hynë në dhomën e tyre. Koloneli ishte në gjumë të thellë. Ata e tundnin që të zgjohej, por ai nuk përmendej.

Kjo nuk i ndodhte zakonisht, se ai ishte ushtarak, i hapte sytë pas zhurmës më të vogël. Por, sonte për të kishte qenë ndryshe. E kishte menduar veten, si burrë familjeje, kishte rënë në gjumë i qetë dhe i kënaqur, pas natës së parë me gruan e tij të ardhshme. Nuk ishte faji i tij që kjo ishte njëkohësisht edhe nata e Presidentit.

Siva filloi të revoltohej, tani. E bindur se kishte të bënte me forca të policisë, ndryshoi menjëherë qëndrim. Nuk do t'i lejonte ata të merrnin nëpër këmbë burrin e saj. U kujtua edhe që kolonelin e kishte zënë gjumi pa u veshur. U doli përpara dhe i largoi nga dhoma.

“Prisni jashtë, e zgjoj unë! Keni një urdhër arresti, patjetër!

“Sigurisht, zonjë!”, u përgjigj përsëri zëri i parë. Dy të tjerët ishin si automatë.

Ata u larguan të tre. Siva hyri në dhomë. Filloi ta veshë, ai nuk zgjohej. Atëherë filloi të thërriste lehtë.

“Beni!”

Ai u zgjua si për magji.

“Çfarë ke? Pse je çuar?” pyeti.

“Vishu shpejt! Kanë ardhur të arrestojnë!”

Siva i tha këto fjalë me mendimin se ato do të binin mbi të si dush i ftohtë, por koloneli që tanimë ishte zgjuar dhe madje filloi të çapitet duke u kalamendur nëpër dhomë, nuk tha asnjë fjalë. Siva u nervozua, i doli përpara dhe e kapi për këmishe.

“Është e vërtetë, atëherë? Thuamë, është e vërtetë? Ke qenë ti! Përse e bëre?”

“Qetësohu, Silva! Gjithçka do të sqarohet, me kohë!” u përgjigj koloneli dhe, sakaq, doli nga dhoma i veshur me uniformë.

Gjithçka ndodhi shpejt. Ata i vunë prangat. Ishin dy që e mbanin përkrahësh, ndërsa i treti iu afrua Silvës.

“Ku e mban pistoletën?”

“Unë nuk mbaj pistoletë!”

“E kam fjalën për burrin tuaj!”

Silva u kujtua se pistoletën e kishte prekur edhe vetë. Ishte ajo që ia kishte dhënë Ilirit për t’i bërë ekspertizë dhe ky duhet ta kishte vënë në vendin e duhur. Tani do të gjenin në të edhe gjurmët e gishtave të saj, tha me vete dhe ngriu në vend. Pastaj, i dha karar, që nuk ishte ky thelbi. Pistoleta ishte prekur prej saj, prej Ilirit dhe prej ekspertit të balistikës, domosdo, por i përkiste

kolonelit, i cili jo vetëm e kishte prekur, por kishte qëlluar me të. Dhe kjo ishte çështja. Koloneli kishte qëlluar Presidentin dhe prandaj po e arrestonin.

"Duhet ta kisha me vete", tha koloneli i habitur dhe kërkoi poshtë sqetullës ku e mbante zakonisht, në këllëfin e posaçëm. Pastaj i hodhi sytë nga Silva, si për ta pyetur. Kjo gjë Silvën e futi në tokë për së gjalli.

"Do të jetë tek uniforma tjetër", tha përsëri koloneli. "Shikoni, pas derës!"

I treti rrëmoi dhe e gjeti në xhepin e djathtë të xhaketës, nën vështrimin e habitur të kolonelit, që nuk ia ndante sytë Silvës.

Dera u përplas me forcë, ndërsa Silva ra në divan e këputur. Por nuk ndenji gjatë ashtu e dorëzuar. Jashtë kishte aguar, filluan të kujisnin frenat e makinave dhe tek-tuk dëgjohej ndonjë bori.

Inati i Silvës rritej. Tani e kishte larguar gjithçka nga vetja. Ajo nuk kishte faj. Në këtë arrestim, patjetër, kishte dorë Iliri. U ngrit me vrull nga divani dhe shkoi e kapi telefonin fiks.

Ndërkohë, Gegë Toska kishte mbërritur përpara portës kryesore të qytetit. Deri tani kishte mundur të ruante distancën e sigurisë ndaj armikut të tij, 'biondit', duke u ndenjur larg mureve. Me të hyrë brenda, nuk do të mund të kontrollonte asgjë si më parë. Duhet t'i bënte sytë katër. Eci me kujdes nëpër kalldrëmin mijëravjeçar. Nuk pipëtinte asgjë. Heshtja vazhdoi për një kohë, derisa Gegës i kapi veshi ca zhurma të njohura. Nuk kishte më pikë dyshimi. Ishin krisma arme me silenciator. Iu bë se ato erdhën nga zona e amfiteatrit. Shkoi andej me shpejtësi, pa kuptuar se çfarë mund të

kishte ndodhur. Mbase, 'biondi' kishte hequr qafe dikë që e kishte shqetësuar, rastësisht.

U afrua tek dhomat e zhveshjes së aktorëve. Mbështeti kokën pas murit dhe dëgjoi një rënkim të lehtë. Futi pakëz kokën brenda, por nuk shqoi asgjë. Vetëm disa sekonda më vonë, ndërsa ai po mendonte të kontrollonte dhomën ngjitur, nga lart kokës së tij u iu hodh një trup njeriu i veshur me uniformë kaki ushtarake. Iu duk si një thes që i bie papritur shpinës dhe pastaj, shkon e rrokulliset tutje. Ishte gati të qëllonte, por trupi nuk lëvizi më, aty përpara këmbëve të tij. Iu afrua, i kapi flokët dhe ia ktheu fytyrën mbarë. Ishte 'biondi'. Por, ajo që e befasoi më shumë Gegën, ishin dy vrimat që kishin lënë plumbat mbi ballë, si dy miza të mëdha të ulura aty papritur. I erdhi në mend, menjëherë, balli i postëkomandant Kinit, me shenjat e plumbave. I vetmi nga viktimat, që nuk e kishte parë të ekzekutohej nga 'biondi'. E kuptoi, por ishte shumë vonë. Prapa shpine ndjeu frymëmarrje njeriu.

"Hidhe armën Gegë Toska!"

Ishte Bim Hyka, me automatikun e tij të shkurtër gati për të qëlluar.

25

Edhe një herë bashkë

Silva kërkonte me nervozizëm nëpër shtëpi celularin e saj. Nga telefoni fiks nuk arriti të bëjë gjë. Në listën publike të telefonave, ishte vetëm një numër centrali i DPK-së, i cili kalonte menjëherë në një kalvar të gjatë shpjegimesh të automatit, të cilat ia ngrinin nervat me shumë dhe nuk arrinte të dëgjonte deri në fund. Donte të fliste menjëherë me Ilirin, por numrin e tij të celularit e kishte të regjistruar në të vetin. Kërkoi kudo, por nuk gjeti gjë.

Atëherë, u vesh shpejt. Ora kishte shkuar gjashtë e mëngjesit dhe lëvizja në qytet ishte shtuar. Mori makinën e saj dhe u drejtua për tek zyrat e DPK-së, të gjente Ilirin.

Makinën e tij e shqoi së larg, por edhe Ilirin që bëri atë kërcimin e zakonshëm dhe zuri vend në timon. Po i ikte, prandaj Silva i ra fort borisë. Iliri e vuri re dhe e priti. Ajo parkoi ngjitur me të. Iu afrua e vendosur, t'i shkarkonte gjithë pezmin e saj.

“Bravo!” i bërtiti në vend të përshëndetjes. “Nuk durove dot, dërgove menjëherë policët!”

“Silva, hyp dhe sqarohemi duke lëvizur se nuk kam kohë. Përndryshe do të lë në tokë!”

Sakaq, Iliri ingranoi marshin, veprim që e bëri pa kujdesin e duhur dhe kambioja gërviu keq.

Silva zuri vend dhe i hodhi një sy makinës. Iu kujtuan vetëtimthi aventurat e Sektorit, rruga e çuditshme që kishin përshkuar nëpër male. Iliri po i grahte makinës shpejt, duke i zgjedhur rrugët. Nxori edhe një herë hartën dhe i tregoi me gisht Silvës një shenjë që tregonte një vend arkeologjik. Silva i kapi dorën dhe ia largoi.

“Mbaje makinën!”

“Çfarë ke? Mos u tremb, nuk është larg, vetëm tridhjetë kilometra që këtu. Po deshe zbrit, nuk të marr me zor. Vetëm se është urgjente.”

“Lëro këto pallavra! Mjaft!” klithi Silva. Iliri frenoi në vend makinën dhe ndaloi në një vend qëndrimi autobusi. Priti që ajo të zbriste, por më parë iu kujtua që i kishte përmendur policët.

“Për çfarë policësh e kishe fjalën?” e pyeti Iliri.

“Për ata që dërgove t’i në mes të natës!”

“Unë?”

“E kush tjetër?”

“Erdhën e morën Benin, në gjumë!”

Iliri nuk po e merrte veten nga habia dhe Silva e vuri re.

“Çfarë? Nuk i ke dërguar ti policët? Po kush tjetër?”

Silva pyeste, tanimë pa sigurinë e atij që e di përgjigjen.

“Ah, idioti!” i ra Iliri me grusht timonit. “Gjithmonë nxitohet e prish punë!”

“Hë?” iu afrua Silva.

“E mora vesh kush e ka kallëzuar. Eksperti i balistikës, Niko Palushi! Më ka futur në bela edhe herë të tjera!”

“Po tani?” pyeti Silva.

“Tani, duhet të vazhdojmë me hetimet! Nuk kemi zgjidhur asgjë. Pas tre orësh Presidenti duhet të marrë rrugën drejt aeroportit. Dhe unë kam njoftime se Gegë Toska është parë tridhjetë kilometra larg që këtu, me armë në dorë, nja gjysmë ore më parë.”

“Po Beni?”

“Beni, tani për tani është më i sigurtë se kudo.”

“Në burg?!” u habit Silva.

“Mos u shqetëso! Mua do të ma sjellin për ta marrë në pyetje, me siguri. Pastaj, mos harro që, tek e fundit, ai ka qëlluar mbi Presidentin. Mbase unë do të prisja pak, përpara masës së arrestit, por në një farë mënyre koloneli duhej izoluar!”

“Ke të drejtë!” tha Silva.

“Po vazhdojmë, atëherë!” i tha Iliri. “Shkojmë e verifikojmë informacionin mbi Gegë Toskën dhe kthehemi shpejt në zyrë, pastaj!”

Bënë një kthesë të papritur nga stacioni i vjetër i trenit, në pjesën veriore të qytetit, dhe morën një rrugë të panjohur për Silvën. Ishte e shtruar me kalldrëm.

Xhipi filloi të troshitet si ndonjë qerre lufte. Vazhduan për një gjysmë ore, të shoqëruar gati gjithë rrugës nga gërvimat e një teleferiku, vagonët e të cilit sillnin qymyr për një termocentral elektrik, që sapo ishte ndërtuar në kodrat e kryeqytetit.

“Si do t’i vejë filli Benit?” e hapi bisedën Silva.

“Nuk do të humbasim kohë, ki besim. Gjithçka do të sqarohet sot, jam i bindur!”

Iliri pa nga Silva, që ishte veshur çuditërisht përsëri me atë bluzën rozë dhe me xhinse.

“Mund të prisnim edhe një ditë tjetër. Pikërisht, mbrëmë vendosëm të jetojmë përfundimisht bashkë!” tha Silva.

“Kjo nuk ndryshon asgjë!” i tha Iliri.

“Si nuk ndryshon asgjë! Nga këshilltar i Presidentit, në atentator! Dhe ti thua që nuk ka ndryshuar asgjë!”

“Duro edhe pak orë, gjithçka do të sqarohet!”

“Pse di ndonjë gjë ti dhe nuk ma thua?”

Silva e kapi për krahu dhe Iliri e mbajti timonin vetëm me dorën e majtë për disa çaste.

“Edhe dy orë e gjysmë, me saktësi. Vetëm se na duhet të presim duke vepruar, siç po bëjmë në fakt.”

Kaluan minuta të tëra pa folur.

“Ja”, tha Iliri papritur, duke thyer heshtjen. “Është ajo shtëpia atje në kodër, mbi Qytetin Antik. Banon një grua, e mbetur fillikat. Ma kaluan telefonatën e saj mua, sepse këmbëngulte. Dhjetë minuta, përpara se të vije ti, pa vajtur ora gjashtë. Tha se kishte parë një njeri të armatosur që ecte rreth mureve të qytetit të lashtë.”

“Çudi, si nuk ka lajmëruar policinë lokale! Pastaj, përse ka këmbëngulur që të flasë me ty, për një fakt që sot është i rëndomtë. Sa njerëz të armatosur bredhin nëpër rrugë dhe askush nuk ua vë veshin.” tha Silva.

“Jemi bërë personazhe Silva, ti edhe unë. Pas arrestimeve në Sektor dhe çlirimit të familjeve të ngujuara. E di që, nuk të ka shkuar në mend të lexosh gazetat. Ka qenë një javë shumë intensive. Kanë shkruar shumë për atë natë arrestimesh. Shembulli ynë është përcjellë edhe në rrethe të tjera të vendit...”

“Ah, po, diçka kam lexuar!”

Xhipi i ishte afruar shtëpisë së gruas.

Ilirit, tani iu kujtua edhe emri, quhej Margarita.

Nga brenda gruaja, sapo kishte dëgjuar, kishte hapur një kapak në dysheve dhe kishte nxjerrë kallashnikovin. Me të në dorë kishte lëvizur pak perden dhe kishte parë nga xhipi në ngjyrë vishnje. Një burrë dhe një grua që zbresin nga makina. Margarita u kthye shpejt dhe vuri armën në vendin e vet, në pritje.

“A prisni miq!” u dëgjua zëri i inspektor Ilirit.

“Bukë e krypë e zemër!” erdhi zëri i Margaritës nga brenda.

Silva pa një shtëpi në kushtet e një mirëqenieje normale, pa teprime, me të gjitha mobiliet e nevojshme.

“Qenkeni shumë mirë!” i shpëtoi Silvës, tani që kishin dalë në verandë që të tre.

“Ç’mirë e zeza!”, ia ktheu gruaja aty për aty.

Silva u mahnit me peizazhin, qytetin e bardhë poshtë, nga ku dukej amfiteatri dhe përbri një lumë që dilte menjëherë nga toka dhe përhapej në fushë në një shtrat të rregullt. Ishte vërtetë një pamje mahnitëse, tani që mbi ujërat e tij kishin rënë edhe rrezet e para të diellit. Kurrë në jetën e saj nuk kishte parë burimin e një lumi. Habitej, që ai ndodhej vetëm tridhjetë kilometra larg qytetit ku ajo jetonte.

“Si është puna, se nuk kemi kohë”, e nxiti Iliri të fliste.

“Edhe në zonën tonë ka shumë familje në hasmëri, kush me hak e kush pa hak! Kur do të vini këndej me na pà!”

“Më fal zonjë, Margarita quheni, apo jo?”

“Po, Margarita!”

“Keni ndonjë gjë konkrete, apo na keni thirrur vetëm përse ne nuk jemi dukur edhe nga ju. Keni të drejtë, diçka do të bëhet për të gjithë, se kështu nuk mund të vazhdohet. Por, përveç vullnetit të mirë, këto punë duan edhe kohë. E sot, moj motër, ne kemi shumë pak kohë”

“As për një kafe?”

“Më mirë fol si e ke hallin? As për kafe nuk kemi kohë!”, ndërhyri Iliri, edhe pse mendja i shkoi vetvetiu tek një kafe me raki, që do ti shkonte përbukuri këtij mëngjesi në këtë verandë nga ku mund të shikohej një peizazh shumë i larmishëm, që mbyllej me një perspektivë konike, në fund të të cilit dukej edhe deti.

“Banoni vetëm këtu? Nuk keni familje, burrë, fëmijë?” e pyeti Iliri.

“Kam vetëm djalin tani, se burrin ma kanë vrarë, për një gjak të vjetër që nuk e dinte kurrkush. Vjehrri me kunetërit kanë dalë për të marrë hak, nuk flenë në shtëpi. Ma kanë marrë edhe djalin me vete.”

“Sa vjeç është djali?”

“Trembëdhjetë!”

“Ata e kalojnë natën ku të munden. Edhe ditën fshihen. Kanë thënë se nuk kthehen në shtëpi pa marrë hak. Unë u çoj bukë dhe ndërresa në pika të caktuara, që m’i lënë ata me shenjë. Përdorin një bluzë të djalit, presin nga një rrip prej saj dhe ma lidhin nëpër shkurre, këndej rrotull. Unë duhet ta gjej dhe të dërgoj atje bukë.”

“Po djalin nuk e takon?”

“Jo, është me rrezik thonë!”

“Djali e ka humbur këtë vit mësimor, atëherë? Tani kemi hyrë në tremujorin e fundit të shkollës, apo jo?”

“Ata që ngujohen janë për bukuri, u vjen mësuesi tek shtëpia!”

“Çfarë kërkon nga ne, Margarita!” i tha prerë Iliri.

Silva ishte kthyer nga ata me të filluar biseda. Sigurisht, tani nuk i interesonte asgjë tjetër rrotull veç fjalëve të gruas, që duket se kishte moshën e saj.

“Jam tmerruar sot në mëngjes! Mirë se na kanë borxh, më kanë vrarë burrin, kot së koti, por edhe na detyrojnë të marrim malet. Na kanë kërcënuar se do të na shuajnë si shtëpi!”

“Çfarë pe sot në mëngjes?” e pyeti Iliri.

“Ditët e fundit, burrat janë fshehur poshtë, tek Qyteti i Vjetër. I kërcënova se do t’i braktisja të gjithë, po nuk më lanë të takoj djalin. Dhe ata erdhën afër, duke rrezikuar! Kështu, do të kisha ikur, nuk durohet kjo torturë! Po, ja tani jam më mirë, e takoj djalin çdo darkë, poshtë tek qyteti i vjetër.”

“Po sot, çfarë të frikësoi sot?” e ngacmoi Iliri që të mos dilte nga tema.

“Sapo zbardhte, përveçse hëna ndriçonte fort, kur, pashë një njeri të armatosur me atomatik të shkurtër, apo pistoletë, nuk e kuptova mirë, që sillej rrotull mureve të Qytetit të Vjetër. Mendova se ishte hasmi dhe nxora një shenjë në ballkon. Çfarë shenje, do thuash ti? Hiç, valëvita flamurin kombëtar! Këtë shenjë kemi lënë! I pashë që këtu burrat si e lanë qytetin dhe u ngjitën malit dhe u qetësova. Nga ky çast, i ndoqa më e qetë lëvizjet e njeriut të armatosur. Ecte në pozicion luftimi, derisa u afrua tek porta kryesore. Këtu lart duket, ja shiko rrugën nga porta kryesore deri tek amfiteatri. Tamam tek skena e amfiteatrit, pashë dy burra të tjerë, sikur kacafyteshin, pastaj njëri u

zhduk. Njeriu i armatosur, që e unë e kisha kujtuar hasmin shkoi drejt e tek një njeri tjetër, i shtrirë përtokë. Mbase njëri nga burrat që u kacafytën. E këqyri, si duket, me sa mund të kuptoja unë që këtu, pastaj u bë më i vëmendshëm, me armën gati për të qëlluar. Por tjetri po i vinte ngadalë pas shpine. Desha t'i thërrisja që këtu, të kthehej, por nuk më doli zëri. Tjetri nuk i qëlloi, me sa duket. Unë nuk kam dëgjuar asnjë krismë."

"Përdorin silenciator ata?" ndërhyri Iliri.

"Çfarë" tha Margarita.

"I vënë armës një shtesë në tytë për të mbytur zhurmën e të shtënave."

"Jo, jo, këta të dy u larguan bashkë, në këmbë, shëndoshë e mirë. Njëri përpara me duart lart, tjetri mbrapa. Ai i pari do të jetë vrarë me... si ja the fjalën ti.. nejse... Këta lanë qytetin dhe u larguan nga kodrat, bash andej nga ikën edhe burrat e shtëpisë sonë. Po dridhem nga frika, mbase po i ndjekin...!"

"Jo, Margaritë, mos ki frikë, ata janë nisur për tjetërkund!" e siguroi Iliri.

U afrua Silva dhe i tha:

"A e di se kush ta ka vrarë burrin?"

Margarita nuk donte të përgjigjej.

"Mbase e bëra pyetjen gabim. Dëgjo, moj motër. Mos ke ndërmend ta lësh djalin peng, bashkë me ata kaçakët e tjerë, maleve. Dhe ti ta kalosh gjithë jetën, duke u çuar bukë, vend më vend. Ti e mban vetëm gjithë këtë fermë këtu dhe jeta jote është katandisur në një korriere nate. E di, e bën gjithçka për djalin, por edhe për të tjerët, se edhe ata janë në pikë të hallit, njësoj. Djalin, ata ta kanë marrë peng. Duhet ta shpëtojmë, bashkë, që sot. Je e gatshme?!"

Margarita nuk foli.

Silva u ngrit.

“Po që sot”, tha Iliri. “Mbase është një sekret, ti Margaritë le ta mësosh e para. Na the në fillim që nuk kemi ardhur dhe ke të drejtë. Do të vijmë që sot. Na prit. Kurse tani, duhet të na falësh, se jemi me ngut.

U përshëndetën dhe kur shtrënguan duart, Silva i la në grusht numrin e saj të telefonit.

“Është punë orësh për të gjithë, moj motër, na prit!” i tha Silva dhe e përqafoi me lot në sy.

26

Njëri përpara dhe tjetri pas, përgjithmonë!

Gega nuk u kishte besuar veshëve, në fillim, pastaj syve. Ishte pikërisht Bim Hyka që e kishte urdhëruar me një zë të egër që të lëshonte armën. Ai e kishte hedhur pistoletën përtokë, pa hezitim. Bimi në fillim e kishte shkelur armën me këmbë, duke e mbajtur Gegën gjithmonë në shënjestër dhe pastaj e kishte marrë, duke e ngjeshur në brez.

Edhe pasi kishin dalë nga qyteti i lashtë, për disa qindra metra të tjera, kishte qenë i detyruar të ecte me duart lart dhe me Bimin që nuk e ulte armën. Megjithatë, deri atëherë kurrë nuk kishte menduar që Bimi mund ta vriste.

Gjendja do të ndryshonte pas një telefonate që i erdhi Bim Hykës papritur. Nuk zgjati shumë, se atij iu shkarkua bateria, por me sa kuptoi Gega, përmes saj ishte përcjellë një urdhër i qartë e i prerë, ku ishte vendosur fati i tij, vdekja.

Gega ndjeu djersët që i buisën në të gjithë trupin dhe pati të ftohtë, i hipën dridhma dhe filluan t'i kërcëllijnë dhëmbët. E mori veten shpejt.

Duke shfrytëzuar hutimin e Bimit gjatë telefonatës, ia dha vrapit me zig-zage, për t'u ikur të shtënave të mundshme. Bimi nuk i qëlloi, por e ndoqi edhe ai me vrap, duke e ditur epërsinë e tij, jo vetëm të moshës, mbi dhjetë vjet më i ri, por edhe të profesionit, ai ishte një instruktor fizkulture, që vazhdonte të stërviste të tjerët, por edhe vetveten, ndërsa Gega, edhe pse dikur një oficer me përgatitje të shkëlqyer fizike, tani kishte humbur shumë, qoftë nga kalimin i viteve, qoftë nga fakti që nuk merrej më me aktivitet fizik.

Priste nga çasti në çast plumbat pas shpine. E ndjente shtyllën kurrizore si të mpirë, të gatshme për të pësuar atë dëmtimin e pandreqshëm që lënë plumbat, therjen, paralizën, rënien buzë rrugës, me hundë në dhè.

Por ky moment i parë paniku i kaloi. Vrapi, që fillimisht nuk iu duk zgjidhja më e mirë, tani nisi të ketë kuptim. I shkrepi një mendim shpresëdhënës dhe fuqitë iu dyfishuan. Për momentin, as Bimi nuk e përballoi shkëputjen e tij të beftë, u gjend i papërgatitur. Gega, mori majtas dhe ngjiti kodrën me një shpejtësi prej lepuri, mbërriti në majë dhe kërceu fort.

Bimi e pa vonë. Shtiu për herë të parë kundër Gegës, por plumbat shkuan në ajër. Tani e kishte kuptuar qëllimin e Gegës. Pa shkëputjen e tij në lartësi. Nuk ishte vetëvrasje, edhe pse kështu iu duk në çastin e parë, pasi aty ku mbaronte kodra fillonte humnera. Por duart e Gegës, pas kërcimit lart, kapën fort kavon e çeliktë, të cilën Bimi nuk e kishte vënë dot re menjëherë. Gega u ngrit në atë pozicionin e njohur të ushtarëve gjatë kalimit të pengesave ujore, me këmbë e duar lidhur pas kavos dhe filloi të ecë shpejt, deri sa mbërriti njërin nga vagonat e teleferikut që transportonte

qymyr në termocentralin elektrik të periferisë së kryeqytetit.

Edhe Bimi nuk humbi kohë më shumë. Bëri të njëjtin veprim, si kurse Gega, por shumë më ngathët. Këtu epërsia ishte nga ana e kundërshtarit të tij, oficer akademik, i mësuar me stërvitjet e tipit ushtarak. Sidoqoftë, ia doli të kapë kavon, më pas edhe njërin nga vagonët, që për fat të keq nuk vinte menjëherë pas atij të Gegës, por ndërpritej nga një tjetër në mes, i cili i zinte rrezen e shikimit, kur kavoja ishte e tendosur dhe nuk e linte të qëllonte. Por, edhe kur kavoja bëhej më e lakuar, distanca ishte e largët dhe Gega, i paarmatosur, ishte fshehur mirë brenda, pa i lënë mundësi kundërshtarit të qëllonte.

Teleferiku nuk ecte shpejt, por sidoqoftë, shumë më tepër se një këmbësor në marshim, kështu që Gega llogariti, se për rreth një orë, ata do të ishin në zonën e TEC-it, domethënë dhjetë kilometra larg kryeqytetit. Filloi të ketë shpresa se plani i tij për të qenë në rezidencën presidenciale përpara orës nëntë, kishte shanse të realizohej.

Iliri dhe Silva kishin zbritur menjëherë poshtë në Qytetin e Vjetër, siç e kishte quajtur Margarita. Atje kishin gjetur kufomën e Roland Gartherit, vrarë me dy plumba në ballë.

Iliri filloi të hamendësojë një skenar të mundshëm. Mbase, Gega ia kishte dalë ta eliminonte ekspertin e huaj të ndjekjes dhe tani kishte vënë përpara edhe vetë Bim Hykën, me armën tek koka, duke e mbajtur si peng, për të hyrë në presidencë. Situata, dukej jashtë kontrollit, Gegë Toska po përparonte drejt Presidencës.

Bëri një telefonatë për ekspertët ligjorë dhe policinë lokale. Duhej ekzaminuar kufoma dhe transportuar pastaj në morg. Me të do të kishin punë, mund të krijohej ndonjë incident diplomatik, pasi ai ishte edhe qytetar i huaj, kështu që Iliri i mori të gjitha masat e nevojshme, duke bërë edhe një xhiro shtesë telefonatash në kryeqytet.

Morën pastaj rrugën e kthimit, që kalonte fillimisht përmes ca kodrave, e më pas, përgjatë linjës së teleferikut, që e vunë re edhe gjatë ardhjes. Pa ditur, që mbi kokat e tyre, po vozitnin ngadalë, Gegë Toska, i ndjekur dy vagonë më pas nga Bim Hyka.

Bima Hyka nuk arriti ta njihte makinën në kohë. Nga lart, ajo dukej ndryshe, ashtu e zbuluar. Më shumë si një mjet lundrimi, se sa makinë. Dalëngadalë, filloi të përqendrojë shikimin tek njerëzit që ishin brenda. Njohu në fillim Silvën, ish gruan e tij, pastaj edhe inspektor Ilirin. Rrëmbeu automatikun e shkurtër Tomson, por kavoja pati një troshitje të veçantë dhe ai nuk arriti të merrte shenjë. Kur lëvizja e teleferikut u normalizua, makina ishte zhdukur me një shpejtësi të madhe, midis pluhurit që linte pas.

Bim Hyka e ndjeu veten më të pafuqishëm se kurrë ndonjëherë, i futur në atë kazan të hekurt, i zhytur deri në brez në thëngjill. Dëshpërimi, pak a nga pak, ia la vendin lodhjes. Netët pa gjumë kishin lënë gjurmët e tyre.

Kazani brenda ishte i ngrohtë dhe pa e kuptuar fare, Bim Hykën e kishte zënë gjumi, disa qindra metra përpara se të mbërrinin.

Kurse Gega e vuri re në kohë furrën që afrohej. Vagonët shkonin e derdheshin direkt e në grykën

e saj të zjarrtë. Ai bëri një kacavjerrje, llogariti me sy një pjesë të ngritur të terrenit dhe kërceu. Sapo ra përtokë, ngriti kokën lart dhe pa se si barku i vagonit të tij shkoi e u derdh në gojën e zjarrtë të furrës, duke lëshuar disa shkëndija. Të njëjtën gjë, bëri edhe vagoni i dytë.

Në vagonin e tretë, ishte Bimi. Gega nuk mund të priste më, duhet t'ia jepte vrapit. Por diçka e mbajti aty gozhduar. Bimi duhej të kishte dalë, i ngritur në këmbë, madje me duar mbështetur tek doreza. Tani duhej të kishte nxjerrë njërën këmbë jashtë, se nuk kishte më kohë.

Gërvima e vagonit kuiste vajtueshëm, por Bimi nuk po dukej. Gega rrëmbeu një gur dhe qëlloi.

Bimi e dëgjoi tingullin e tij si një kambanë të largët. Po shikonte një ëndërr të shpejtë, të beftë, sikur po lëvizte litarët e një kambane. Në ëndërr, i shkanë këmbët dhe ra. Klithi, tani i zgjuar, por ishte shumë vonë. Vajti e u zhyt me kokë midis flakëve, i veshur i tëri me shtresën e qymyrtë. Momentin e parë ndriçoi pak, pasi qymyri u ndez menjëherë, pastaj u bë njësh me llavën.

Poshtë, Gegë Toskës, iu ngjethën mishtë. Klithma e tij e vonuar, megjithatë i erdhi në veshë, në çastin e fundit. Nuk kishte dëgjuar kurrë në jetën e tij diçka më të lemerishme.

Dikush e tregoi me gisht, të tjerë vrapuan drejt tij, por Gegë Toska nuk priti më. Ra nga pirgu poshtë, me një teknikë rënie, të mësuar dikur gjatë stërvitjeve ushtarake. Kurrë nuk e kishte menduar, kohët e fundit, se do t'i hynin në punë të gjitha këto teknika. E fundit ishte ajo e kërcimit të murit që i doli përpara. Kreu të njëjtin veprim si dikur në kërcimin e tarabës prej druri.

Ndjekësit, mbetën nga ana tjetër.

Gega mori frymë thellë, teshtiu prej pluhurit të qymyrit dhe bëri një kërcim në kanalin vaditës anës rrugës, me gjithë rroba. U fërkua aty mirë e mirë, pastaj doli, hoqi pantallonat, i shtrydhi dhe i veshi përsëri. Më pas, vuri në trup, me një ndjesi krupe, edhe bluzën prej fanellate që kishte pirë nja dhjetë litra ujë.

Ktheu kokën dhe pa një xhip ngjyrë vishnje. Deshi t'i nxirrte dorën, por e vuri re në kohë se ishte vetëm dy vendesh, kështu që e la të ikte në punë të tij. Vuri dorën në xhepin e brendshëm të bluzës së rëndë dhe pa që portofoli ishte ende aty. Kartëmonedhat ishin lagur, por nuk ishin dëmtuar. I nxori dorën një autobusi, por fatorinoja e ndaloi tek dera.

"Nuk ke ku shkon kështu, lali!"

Gega e kuptoi se çfarë duhet të bënte dhe sa më shpejt të ishte e mundur. Hyri në një dyqan rrobash dhe doli që andej, sakaq, i veshur me një kostum të zi, këmishë të bardhë dhe kravatë gri, në ngjyrën e syve. Këpucët i shkëlqenin, por nuk i shpëtoi tundimit të kahershëm, i fërkoi mirë edhe pas pantallonave, duke iu dhënë një lustër verbuese në atë diell të fortë.

Pa orën, funksiononte në rregull, pasi nuk fuste ujë. Shënonte 8 e 45 minuta. Ngriti dorën dhe bëri me shenjë, pastaj thirri me zë.

"Taksi!"

"Për ku zotni?"

"Për në Presidencë!"

27

Në Presidencë

Në zyrat e DPK-së Iliri mbërriti në orën 8 e 43 minuta. Kishte kohë vetëm për t'u hedhur një sy shënimeve që i kishte lënë sekretarja, nëpër ca bileta të verdha. *Gjendje gatishmërie. Nuk është kapur.* I hapte një e nga një dhe në to ishte e njëjti mesazh shkruar në format më të ndryshme. I mori dhe i hodhi të gjitha pusullat në kosh. E dinte, që Gega nuk është kapur, por kjo nuk i mjaftonte, donte të bindej për diçka që tanimë e kishte kuptuar.

Kur po dilte, i zuri syri një faks mbi tavolinë. E njohu që vinte nga major Tomë Keqi, zëvendëskomandant i postës së policisë së sektorit. I qeshën sytë. E mori dhe e futi shuk në xhep.

Zbriti shkallët me shpejtësi dhe hyri në makinën elegante të Silvës. Misioni i xhipit të tij 'Wrangler' kishte përfunduar. Nuk mund të shkonin në Presidencë me një makinë foristradë pa dyer. Por edhe veshja e tyre nuk shkonte për një ceremoni. Iliri hahej disi, se ishte veshur në

stilin qytetar amerikan, xhaketë dhe pantallona xhinsi, kurse Silva xhins, me një bluzë pambuku.

Rrugët e kryeqytetit nga do të kalonte presidenti, të stolisura me flamuj kombëtarë, ishin bllokuar për makinat e tjera.

Gazetat e mëngjesit kishin publikuar me bujë lajmin e nisjes së Presidentit për të nënshkruar ANM-në, shoqëruar me analiza nga më të ndryshmet.

Iliri dhe Silva u detyruan të nxirrnin dokumentet, tre herë, brenda dy kilometrave, që nga DPK-ja deri në Presidencë. Ishin marrë masa të forta sigurie.

Herën e tretë u vonua diçka më shumë, sepse përpara ishte ndalur në një postobllok të improvizuar, një taksi. Ata dëgjuan edhe pjesë të dialogut të shoferit të taksisë me policin e shërbimit rrugor.

"Nuk e dija që ndalohej kalimi edhe për taksitë!" u justifikua shoferi.

"Kalo, kalo, nuk dua të krijoj radhë tani pas teje", i tha polici.

Iliri u afrua dhe filloi të vërejnë me vëmendje pasagjerin e taksisë, por arriti të këqyrte vetëm rrashtin e kokës dhe profilin e tij. Silva dukej e painteresuar.

Iliri nxori shpejt dokumentin, por polici nuk u mjaftua vetëm me kontrollin e tij, kërkoi edhe identifikimin e Silvës. Ajo zu të kërkonte në çantën e saj dokumentin e prokurores, por po humbiste kohë. Në atë çantë, siç ndodh rëndom me gratë, kishte gjithçka. Për fat, i pari që e humbi durimin, ishte vetë polici.

"Kaloni, kaloni, ju lutem!"

Silva që ishte në timon, po ecte me një shpejtësi normale. Iliri pa orën, ishte 8 e 53, mungonin edhe shtatë minuta.

"Ndiqe atë taksinë atje!" i tha Iliri. "Po munde ta kapësh, godite pak me parakolp!"

"Çfarë? Të prish makinën? Je në vete?"

"Po, jam plotësisht në vete. Udhëtari i veshur me kostumin e zi, ka shumë mundësi të jetë vetë Gegë Toska."

"Je i sigurt!"

"Nuk e pashë përballë! Po ti e di, në fotografitë që ka policia, jepet edhe profili. Nofulla e tij e spikatur më kujtoi menjëherë Gegë Toskën!"

Silva i dha gaz dhe makina e saj që kishte një motor të fuqishëm, bëri përpara me një shllafitje gomash që lanë tym në asfalt. Brenda pak çastesh, u gjendën pas taksisë. Silva mbylli sytë dhe u bë gati të godasë makinën përballë.

"Mos!" i bërtiti Iliri.

"Hë dhe ti, vendos, çfarë të bëjmë! Një herë bjeri, një herë mos!"

"Është e kotë Silva. Shikoje mirë makinën, Gega ka zbritur!

"Kur zbriti? Si nuk e pamë?" tha Silva.

"Na ka parë ai, mos u bëj merak! Nga pasqyra e mesit dhe ka zbritur!"

"Po tani, për ku është drejtuar ai?" pyeti Silva e habitur.

"Ai e ka thënë, që prej një jave. Do të shkojë në Presidencë. Tani ka hyrë në park, dhe me siguri po pret kodrën shkurt. Duhet pranuar, qenka shumë i përpiktë me orarin. Kërkon të mbërrijë në orën 9 fiks."

"Po ne, çfarë të bëjmë?" pyeti Silva

"Ecim. Edhe ne për në Presidencë!"

Gjatë atyre qindra metrave që i ndanin deri në Presidencë, inspektor Iliri u kujtua për faksin që i kishte dërguar Toma dhe ai e kishte futur me ngut në xhep përpara se të largohej. E kishte vënë në xhepin e djathtë. E nxori dhe e shpalosi mbi kruskotin e makinës. Fytyra filloi t'i çelej, që në rreshtat e parë. Në atë faks, ishte një pjesë e madhe e së vërtetës. Silva e vuri re heshtjen e tij, por nuk kishte kohë ta pyeste, pasi kishin mbërritur përballë kangjeles së presidencës dhe po jepte e merrte me ushtarin e Gardës. Kryen formalitetet e zakonshme të kontrollit dhe hynë brenda rezidencës presidenciale, e cila ishte vendosur në një park të madh me pemë shumëvjeçare.

Në oborrin e gjerë, shtruar me një kalldrëm të bardhë, ishte rreshtuar banda muzikore, një grusht personalitetesh të ftuara dhe trupat e Gardës së Republikës.

Presidenti doli nga porta kryesore e godinës, që dikur kishte qenë pallat mbretëror. Përshëndeti të pranishmit, por dukej paksa si përhumbur, sikur kërkonte dikë me sy në turmë.

'Ka frikë', mendoi Iliri, ndërsa ndjeu që Silva po e kapte prej xhakete. Iliri ktheu kokën nga ajo i bezdisur pak. E pa me sy të zgurdulluar dhe me gojën hapur si peshk. Do të qeshte fort në një rrethanë tjetër, por e mbajti veten. Silva nuk po nxirrte dot asnjë fjalë, por Iliri u mjaftua të ndiqte shikimin e saj për të kuptuar gjithçka.

Nga turma e të ftuarve u shkëput një zotëri i veshur shik, me kostum të zi dhe i doli përpara Presidentit. Drejtuesit të bandës muzikore i mbeti dora e djathtë, ku mbante baketën e dirigjentit,

lart, pa mundur t'i japë orkestrës sinjalin për të filluar ekzekutimin e himnit kombëtar.

Hapi i Gegë Toskës ishte ushtarak, sikur po paraqiste forcën dhe shumëkush e mendoi pjesë të ceremonisë.

Snajperi i parë i bëri shenjë të dytit, se nuk mund të qëllonte nga ai pozicion, pasi rrezikonte të kapte vetë Presidentin. Qëlloi snajperi i dytë. Pasoi menjëherë një tingull i mprehtë dhe i gjatë tunxhi. Plumbi kishte shpuar oboen, duke lënë një vrimë të vogël.

"Një minutë!" thirri Presidenti.

Filloi një pështjellim i vërtetë ndër të pranishmit, edhe pse ata nuk e kishin kuptuar fare se ishte qëlluar. Zhurma e tunxhit u qe dukur një përplasje e pavëmendshme e instrumentit.

Snajperët ulën armët. Dikush tjetër, po përgatitej të qëllonte, por Iliri nuk ia ndante sytë. I shtyu njerëzit me kujdes dhe e bllokoi pikërisht në çastin kur po fuste dorën në kraharor për të marrë pistoletën. I përdrodhi krahun fort, pa rënë në sy dhe e çarmatosi.

"Prapë ti! Nuk mbaron me kaq, ta dish," i tha tjetri dhe futi dorën që i dhembte në xhepin e xhaketës, pa e dhënë veten.

Iliri shkoi sërish pranë Silvës. I gjithë veprimi i tij ishte dukur si një takim i zakonshëm me dikë që e njihte. Askush nuk mori vesh se këtu bëhej fjalë për një çarmatosje.

"Ju, nuk jeni të informuar, mbase, sa duhet! Ky zotëria është miku im Gegë Toska, babai i dy fëmijëve të vrarë në një pritë të turpshme në qytezën e Sektorit, një javë më parë! T'i urojmë mirëseardhjen!"

Pasuan duartrokitje nga të gjithë të pranishmit e rreshtuar për të përcjellë Presidentin. Gega përshëndeti me kokë dhe me një përkulje të lehtë të trupit, duke vënë dorën në zemër. Pastaj filluan tingujt e bandës muzikore që luante himnin kombëtar dhe të gjithë ndenjën gatitu.

Iliri kishte rast të vrojtonte të pranishmit. Nuk mungonte edhe Prekë Prela, kryetar i Misionit të Pajtimit. Iu afrua ngadalë dhe e përshëndeti me kokë. Tjetri, priti të mbaronin tingujt e bandës muzikore dhe pastaj i pëshpëriti.

"Inspektor, kam nevojë të bisedoj me ju. Po ju kërkoja gjithë mëngjesin, kam qenë edhe në zyrë, por nuk ju gjeta."

"Me të mbaruar ceremonia, shihemi në zyrë!" i tha Iliri dhe depërtoi më tutje, midis të pranishmëve.

Iu afrua një zyrtari që qeshte vesh më vesh dhe bisedonte me gjallëri me të tjerë që e kishin rrethuar.

"Oh, inspektori!"

"Kaloi mirë Dr.Pisha, apo jo?" i tha Iliri.

"Lëre, se kemi hequr një siklet shumë të madh!" tha Dr.Pisha duke u veçuar që të mos dëgjonin të tjerët. "Këtu, duket sikur nuk ka ndodhur asgjë. Veç pranisë së Gegë Toskës, që është e pabesueshme! Nuk di ç'të them, është një mesazh shumë i fortë!"

"A nuk të duket se dikush mungon këtu?" e pyeti Iliri.

"E di, e ke fjalën për kolonel Bardhin. Do sqaruar shpejt puna e tij. Nuk e marr vesh përse ka qëlluar presidentin? Ndonjë zbrazje e pavullnetshme e armës, mbase. Po, janë katër të shtëna, të shkretat! Do hetuar shpejt!"

“Diçka nuhatet, doktor, por duhet pyetur Presidenti më mirë. Besoj është informuar për arrestimin e kolonelit.”

“Jo, presidenti nuk di gjë për arrestimin e tij! E takova para gjysmë ore, në rezidencë dhe më tha se ishte i habitur me mungesën e kolonelit.”

“Po snajperët, kush i vuri atje lart?”

“Unë, si masë të fundit. Dhashë urdhër që nëse shikonin ndonjë njeri të dyshimtë t’i afrohej Presidentit, ata duhet të qëllonin! Çudi që nuk e bënë edhe pse gjithçka shkoi për bukuri!”

“Qëlluan. Ajo zhurma e tunxhit ishte nga plumbi i snajperëve!” i tha Iliri.

“I gjori Gegë, paska shpëtuar kot!” tha Dr.Pisha. “Meqë ra fjala, Gegën, kur do ta marrësh në pyetje? Nuk dimë ç’të bëjmë me të, ta izolojmë, apo ta lëmë të lirë? Ka shumë gjëra pa sqaruar në këtë histori!” vijoi Dr. Pisha.

“Kjo histori sapo ka filluar. Sa për të pyetur, radhën e ka Presidenti, po unë tani e kam të pamundur të afrohem. Janë akoma snajperët atje?” pyeti Iliri.

“I largoj unë”, tha Dr.Pisha dhe nxori një radio të vogël. Ndërkaq, Iliri tentoi t’i afrohej Presidentit, por nuk e lanë rojet personale. Kishte disa minuta që kishte kaluar ora nëntë, e caktuar si kohë për nisjen drejt aeroportit. Presidenti i shtrëngoi dorën fort Gegës, përshëndeti me dorë të pranishmit dhe hyri në makinë. Eskorta presidenciale filloi të gjarpërojë poshtë, duke zbritur kodrën.

Të pranishmit po nxitonin të merrnin makinat për t’u shpërndarë. U mbyll edhe dera e rezidencës presidenciale. Hynë brenda e shoqja e presidentit, Tefta, me dy fëmijët, që nuk i ndaheshin Gegës, që e kishin futur në mes.

Njeriu i fundit që hyri brenda në presidencë ishte ai i turmës, që kishte çarmatosur pak më parë Iliri. Njihej shumë mirë me Gegën.

Inspektori u drodh kur e pa të hynte brenda. Në fillim mendoi të vraponte, pastaj u kujtua se mund të lajmëronte rojet.

Silva e pa ashtu të zbehtë dhe iu afrua.

“Hë Ilir, si është puna?”

“Lëmsh fare! Më keq se në fillim!”

28

‘Zonat e çliruara nga shteti’

Prekë Prela e priste, i ulur i vetëm në vendin e caktuar për qytetarët që kërkonin takim me inspektorin.

Inspektori përshëndeti me një ‘mirëmëngjesi’ dhe i bëri shenjë kryemisionarit të hynte brenda, i ndjekur edhe nga prokurorja Silva Basha.

Inspektor Iliri nuk humbi kohë.

“Hë, si shkojnë ndërtimet për familjet e ngujuara?” e ngacmoi kryemisionarin.

“Zoti inspektor, kam ardhur pikërisht për t’i sqaruar mirë do punë. Kam do informacione të reja nga njerëzit e mi nëpër rrethe, nga misionarë të pajtimit të gjaqeve dhe konflikteve… Nuk e di në mund të flas në prani të zonjës…!”

Preka i hodhi sytë nga Silva, si për të kërkuar ndjesë, por edhe për ta siguruar se atë nuk e bezdis, në vetvete, prania e saj.

“Zonja Silva Basha është prokurore e Krimeve të Rënda dhe ndodhet këtu duke ushtruar detyrën e saj funksionale. Mund të flasësh lirisht dhe me përgjegjësinë e duhur, në të tilla raste.”

Inspektori ia nguli sytë Prekës në pritje që ai të fliste.

"Shkurt muhabeti, një pjesë e njerëzve tanë në terren janë të korruptuar. Ne sinjalizime kemi pasur edhe më parë për marrje ryshfeti në këmbim të ndërmjetësimeve për shuarjen e konflikteve, hasmërive të vjetra e të reja. Nuk po flas këtu për ato raste kur vetë njerëzit e përfshirë, ofrojnë çfarë t'u lejë në zemër, ndonjë dhuratë simbolike, a ku ta di unë çfarë. Jo, nuk e kam për këtë. Ja, kam marrë me vete edhe një dosje me dokumente të sakta, me dëshmi të njerëzve që kanë paguar 'taksën e gjakut'.

"Taksën e gjakut?!" ndërhyri Silva.

"Kështu e quajti dikush... Jam shumë i prekur nga këto gjana që ndodhin, prandaj e ndjeja si detyrë morale të vija të informoja. Më duhet të sqaroj edhe një herë pozicionin tonë si misionarë të vërtetë, nuk kemi lidhje aspak me njerëz të tillë dhe do t'i denoncojmë sa herë që të kemi informacion!"

"Në rregull, zoti Prekë. Kaq kishe, hollësitë gjenden në dosjen që ke sjellë me vete, besoj"

Inspektori ndërhyri për ta nxitur të dilte diku tjetër, pasi e nuhati që ai kishte edhe diçka më konkrete për ti thënë.

"Jo nuk kam mbaruar. Desha të shtoj diçka në lidhje me deputetin Gjetani, besoj e njihni?"

"Po, urdhëroni e flisni!" e grishi inspektori.

Silva lëvizi menjëherë nga karrigia dhe u bë sy e veshë.

"Tani nuk di si të them. Nuk kam fakte konkrete, se deri në çfarë shkalle është i përfshirë në këtë punën e vjeljes së 'taksës së gjakut' deputeti Nosh Gjetani, vetëmse gjatë kësaj jave po flitet shumë. Unë kam diçka tjetër. Më ka bà një

propozim që të krijojmë një organizatë politike, si punë partie, me marrë pjesë edhe në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Diçka i ka dalë era kësaj pune, edhe ma parë. Më ka thanë se e ka gati një grup deputetësh, nga të dy partitë e mëdha që duan të krijojnë, disa muaj para zgjedhjeve, një lëvizje politike për të propaganduar kanunin. Më ka ndihmu ai me shtyp kanunin, besa në po aq kopje sa mund të jetë shtyp edhe bibla. Edhe ato projektet për shtëpi ngujimi, ai m'i ka sugjeru, ai i ka gjetë arkitektët, inxhinierët. Më thotë shpesh, se duhet të veprojmë në terren. Sektorin, për shembull, e ka quajt 'zonë të lirë nga shteti', vetëm se i plasi kjo puna e fëmijëve. Ai donte me vepru pa bujë."

"E di ti, se kush është i dyshuari kryesor për vrasjen e fëmijëve?" ia preu fjalën me qëllim inspektori.

"E kam marrë vesh, flasin njerëzit. Bash, Palokë Lleshi, që hiqej si misionar, po na paska qenë një ndërmjetës i fëlliqur... Thonë, i lidhur me Nosh Gjetanin, edhe ai. Tashti thonë, se unë vetë nuk kam ndonjë fakt, ta thashë edhe ma parë.

"Po, si ishte puna e asaj 'zonës së lirë nga shteti'?" ndërhyri Silva.

"Tani si koncept, unë nuk po di me e shtjellu si duhet, pyetni deputet Noshin më mirë."

Silva i hodhi një vështrim të befasishëm Ilirit. Ajo u ngrit pastaj në këmbë dhe iu afrua, duke i thënë në vesh, e alarmuar.

"Deputetin Gjetani e pashë të hynte në rezidencën presidenciale, Ilir! Kjo është e rrezikshme, sidomos për Gegën."

Iliri i bëri me shenjë të qetësohej. U kthye pastaj nga Preka, i dha dorën dhe e falënderoi. Të

njëjtën gjë bëri edhe Silva, por me një çehre të përhumbur.

"E kam çarmatosur!" iu drejtua Iliri Silvës, sapo u mbyll dera. "Dhe, sa për trup me trup, Gjetani as që do ta provonte një ndeshje me Gegë Toskën. Rri e qetë!"

"Ka motiv të fortë për ta eliminuar, për të zhdukur bashkë me të, edhe provat! E kupton?!" i tha Silva shumë e shqetësuar.

"E di, e di. Nuk duhet lënë të trashet më kjo punë! Po, më thuaj me kë të merremi më parë, tani? Arbeni është në gjendje arresti, Gega në rrezik! Nga, t'ia mbajmë?"

"Nga Gega, kuptohet! Arbeni e ka me hak, ka qëlluar mbi makinën presidenciale!" i tha Silva, si për të parë reagimin e tij.

"Në rregull, atëherë po shkojmë në Presidencë."

Gegë Toska bisedonte lirisht me deputetin Gjetani, duke i lënë atij të kuptonte, pa dashur, se ai vetë nuk kishte pikë dyshimi mbi të. Fytyra e tij sa vinte e ndriçohej nga drita që shtohej nga dritaret, të cilat muratorët po i kthenin në gjendjen e mëparshme.

Dhe ia përmendi të gjitha, duke filluar me krimet e 'biondit', përplasjen e tij të parë me Bim Hykën, pastaj takimin me të dhe vazhdimin e marshimit së bashku, vrasjen prej tij të 'biondit', Roland Garther-it në Qytetin e Vjetër, duke e mbyllur me fundin e tij tragjik në furrën e qymyrit. Gega nuk e vuri re as çlirimin e tij, sidomos kur mori vesh se Bim Hyka nuk jetonte më. Vetë, i vinte keq, pasi gjithë veprimin e Bimit, ai e kuptonte si normal në rrethanat në të cilat ai ishte ndodhur. Sipas Gegës, Bim Hyka kishte vepruar në përputhje me kërkesat e detyrës.

Deputeti Gjetani, kërkoi leje, u përshëndet me Teftën, Gegën dhe fëmijët dhe u largua.

Fëmijët e Presidentit po përgatiteshin të shkonin në shkollë, edhe pse mësimi duhej të kishte filluar prej kohësh, pasi ora kishte shkuar dhjetë.

"Lëreni sot, është vonë! Shkolla ka disiplinë!" u thoshte Tefta, e ëma.

"Mami, po është e premte. Nesër nuk ka shkollë. Çfarë, të presim deri të hënën, ne pastaj?" kundërshtonte Vesa.

"Lëri të shkojnë" i tha Gega, që nuk ua ndante sytë tek rregullonin çantat e shpinës. Tefta zu ta shikonte, si me dyshim. 'Iku edhe Noshi, e më la vetëm!'

"Po të duash, i shoqëroj unë deri në shkollë" tha Gega.

"Çfarë?!"

"I shoqëroj unë, thashë", përsëriti Gega.

"Jo, nuk ka nevojë! Janë rojet, për këtë punë paguhen!"

Gega nuk e bëri qejfin qeder nga fjalët e Teftës. Vazhdonte të ndiqte fëmijët, deri në lëvizjet e tyre më të vogla. I pa Vesës lidhëset e këpucëve të zgjidhura dhe u përkul t'ia lidhte.

Tefta nuk arrinte të kujtohej atë çast që Gega kishte humbur dy fëmijët e tij një javë më parë, për ta gjetur aty edhe motivin e sjelljes së tij. E kishte mbërthyer një terror i pashpjegueshëm. Kush ishte ky Gega, në fund të fundit! Po, vërtet, ajo e kishte takuar një herë në Kuvendin e Logut të Zanave, dy vjet më parë. Kishin shkëmbyer edhe ndonjë bisedë të shkurtër. Dhe kaq! Më shumë fliste me kolonel Arben Bardhin. Me të po, njiheshin prej kohësh. Vetëm tani, Tefta i ra në të

përse Gega nuk po kujtohej të ikte. Mbase po priste të takonte kolonelin.

Fëmijët erdhi e i mori një makinë ushtarake, ku përveç shoferit me uniformë, në vendin tjetër përpara, rrinte edhe një ushtar i Gardës së Republikës.

Tefta, harroi t'i përshëndeste, por jo Gega, që i ndoqi edhe më pas me sy, deri sa zbritën kodrën poshtë. Ndërkohë, në ngjitje u shfaq një veturë. Gegës nuk ia tërhoqi fare vëmendjen, ndërsa Tefta e njohu makinën e prokurores.

"Po pret kolonelin?" e pyeti Tefta, më në fund Gegën.

"Po, të them të drejtën më ka marrë malli. U bën dy vjet që nuk e kam parë, që nga Kuvendi i Logut të Zanave, të kujtohet besoj."

"Po, më kujtohet."

"I kam thënë me kohë kolonelit, se ditën që Presidenti do të nisej për të nënshkruar ANM-në, do të vija patjetër. Është festë e madhe, sidomos për ne si ushtarakë!"

Gega kishte marrë një pamje prej ëndërrimtari.

"Nuk vjen koloneli, mos e prit kot!" i tha Tefta.

"Është nisur me Presidentin? Nuk ma zuri syri!" tha Gega.

"Jo, po si ta them... E kanë arrestuar!"

"Çfarë?!"

Fytyra e Gegës ndryshoi papritur. U bë i verdhë, dyllë. E humbi si me magji të gjithë atë sigurinë e mëparshme. Dhe, si për ta ngatërruar më keq situatën, në ato çaste, përpara këmbëve të tij, frenoi makina e prokurores.

"Inspektor Ilir Martini! u paraqit i pari.

"Silva Basha, prokurore e Krimeve të Rënda," u paraqit gruaja që më parë po i grahte makinës.

“Gegë Toska, oficer i liruar nga reforma!” tha Gega me një zë të mekur, ku megjithatë dallohej qartë ironia. “Mirë që erdhët! Më dërgoni edhe mua tek kolonel Bardhi, se për të kam ardhur. E kam mik dhe dua ta takoj, kudo që të jetë!”

Hynë të tre në makinë, ndërsa Tefta mbeti me dorën lart, duke përshëndetur krejt e çliruar.

29

Ngjallen dyshimet për komplot

E lanë Gegën poshtë dhe vetë u ngjitën lart në zyrat e DPK-së. Ai u habit se si e lanë ashtu të lirë. Ai mund të ikte kur të donte. Biseda që kishin zhvilluar rrugës, nga rezidenca presidenciale, deri këtu në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Krimeve, kishte qenë në fakt, një marrje në pyetje.

Po ai nuk e kishte në mend t'u ikte dhe ata e kishin kuptuar. Ai kishte ardhur për të takuar mikun e tij të vjetër, kolonel Arben Bardhin. Tani që kishte marrë vesh se e kishin arrestuar, kishte edhe një arsye më shumë për ta parë, që të merrte vesh si qëndronte puna. I dukej diçka e pabesueshme. Në ditën e tij më të gëzueshme, kur duhet të ishte përkrah Presidentit në atë ceremoni të shumëpritur, kolonel Arben Bardhi, ndodhej në burg. Duhet të kishte ndonjë keqkuptim të madh, në këtë mes.

Gega pa inspektorin dhe prokuroren duke zbritur. Dukeshin shumë të qeshur. Silva mbante në dorë një zarf që e tundte në erë.

‘Eh, ku u rreh këtyre, e ku më rreh mua!’ mendoi Gega. ‘E di që nuk më çojnë në të njëjtin burg me të. Kushedi çfarë do të sajohet si akuzë, komplot, grusht shteti! E marr me mend unë! Këtu ka një keqkuptim të hatashëm! Arben Bardhi në burg, e paimagjinueshme!’

Gega nuk i la të flisnin ata të parët.

“Më çoni tek koloneli, se ua tregoj unë të gjitha, fije e për pe. Komplotin e kemi bërë bashkë!” iu drejtua Gega të dyve.

“Komplotin?! Pyeti Silva, që nuk po i jepte dum ironisë së tij.

“Është grusht shteti!” tha Gega me të njëjtin ton.

Nuk po qeshte më askush, për çudi.

“Po, ne kemi një urdhër për lirimin e tij. E ka lënë Presidenti me shkrim, përpara se të largohej,” tha inspektor Iliri me një ton neutral.

Silva ishte e përqendruar në timon, sikur nuk kishte lidhje fare me bisedën që zhvillohej në makinë. Mori kthesën djathtas, duke u futur në një rrugë të sapo sistemuar, me katër korsi. Më pas u shfaq një tabelë në të cilën shkruhej, ‘Burgu i Sigurisë së Lartë 219’

Ishte e zhytur në një pështjellim të skajshëm, saqë nuk arriti ta dëgjojë pyetjen e Gegës.

“Po me mua, çfarë keni ndërmend të bëni?”

E dëgjoi Iliri dhe i tha:

“Tani, po të çojmë të takosh kolonelin, pastaj shohim e bëjmë!”

Nuk pritën gjatë, pasi burgu ishte lajmëruar me kohë.

Koloneli dilte nga qelia pas pesë orësh, katër prej të cilave ishte marrë në pyetje.

Silva, sërish e shqetësuar, foli me Ilirin, pak përpara se të hynin në hollin e pritjes.

“Atëherë, Benin e ka falur Presidenti! E ka këtë kompetencë! Sa turp, e ka mëshiruar!”

Iliri, tani e mori vesh që Silva ishte e pikëlluar.

“Nuk paske marrë vesh gjë prej gjëje! Megjithatë, ja tek e kemi Benin dhe e pyesim si është puna.”

Në fillim koloneli u përqafua me Gegën.

“Erdhe, o Gegë! E mbajte fjalën, edhe pas asaj që të ndodhi!”

“I kam parë edhe unë gazetat, se fjeta një natë në Liqene! Një javë luftë e ke bërë edhe ti!. Qindra fëmijë të liruar! Të lumtë!”

“Po, mor Gegë, apo Toskë, si e do emrin! Të kujtohet kur të çonin në mësim. Herë thoshin të vijë në mësim Toska, herë tjetër, të vijë Gega!”

Silva filloi të kuptonte, ndërsa inspektor Iliri të vërtetonte hamendjet e tij. Me sa duket, kolonel Bardhi, me të marrë vesh vrasjen e fëmijëve të Gegës në Sektor, duke e njohur edhe natyrën shumë të prekshme të Presidentit, kishin kërkuar të vepronin, duke dashur të lëshojnë edhe një mesazh për të gjithë.

“Po, ka qenë një inskenim! Një shfryrje dufi!” filloi të tregojë koloneli, ulur prapa me Gegën. Silva ngiste makinën, kurse Iliri ishte ulur në vendin e parë.

“Gegë, më vinte zor të dilja përpara për ngushëllim! Desha të bëja diçka më ndryshe, më të fortë se një fjalë ngushëlluese.”

“E kam kuptuar, që në fillim. Po kur mora vesh se të kishin arrestuar, aty nuk po i jepja më dum!”

Iliri nuk kishte më pyetje për të bërë. Silva dukej e çliruar dhe nuk donte t’u përzihej atyre në bisedë. Po vinte vakti i drekës dhe të gjithë mendonin se do të gjenin më në fund një restorant.

Pas pak minutash, makina kishte dalë nga kryeqyteti, por nuk po ndalej në restorantet që dukeshin, aty-këtu. Periferia ishte e mbushur plot me pika agroturizmi, ku gatuheshin prodhime vendi, duke filluar me mishin, zarzavatet, e deri tek salca e kosit.

Iliri e njohu i pari rrugën, sapo dëgjoi troshitjet e para.

Pastaj u shfaq TEC-i, teleferiku dhe i pari që foli ishte Gega.

"Këtu vdiq i ndjeri, një punonjës i forcave të sigurisë, Bim Hyka, quhej."

Gega filloi të tregojë, sikur fliste me vete, pa e ditur që ai emër njihej nga të gjithë në atë makinë.

"U përpoqa ta shpëtoja, por e kishte zënë gjumi në kazanin e qymyrit. Më ndiqte mua! Vajti drejt e tek gryka e furrës! Na panë edhe ca punëtorë!"

Askush nuk po pyeste Silvën se për ku ishte drejtuar. Foli ajo vetë.

"Jemi të gjithë të armatosur, apo jo?" tha Silva.

"Unë, nuk e kam më pistoletën, ka shkuar në furrë bashkë me Bimin e gjorë! tha Gega.

"Të tjerët në rregull?" vijoi Silva.

"Po, edhe mua ma kthyen pistoletën"

"Është ajo me të cilën qëllove mbi presidentin?" pyeti Iliri.

"Ajo është!"

Gega pa nga koloneli i habitur.

"Po, pra Gegë, e thamë tani. Unë i qëllova makinës së blinduar të Presidentit dhe kuptohet, theva vetëm xhamat. Ky, u interpretua si veprim ndëshkues mbi Presidentin që kishte thyer rregullat e ngujimit. Informatorët i sollën menjëherë fjalët që ti the përpara se të largoheshe, "*Po shkoj tek Presidenti!*", për ta vrarë, se ai e ka

fajin për këtë që ndodh në këtë vend. Dhe në fakt, Presidenti ndjehej vërtet fajtor, më besoni?"

Koloneli heshti një çast, pastaj u kujtua të pyesë.

"Silva, ç'hyjnë në punë armët tani?"

"Beni, më lër kohë edhe pak minuta, se arritëm! Ja, tek ajo shtëpia atje në kodër, do të ndalemi."

Margarita i kishte vënë re që larg, nga veranda.

Kur mbërritën në oborr, nuk u besoi syve.

"Nuk ma mori mendja se do të ktheheshit sot. Është kohë dreke, ia keni bërë shumë mirë. Një qengj në hell, pastaj çfarë të ketë shtëpia. Nuk keni për të lujtë vendit!"

Ata u rehatuan të gjithë në verandë duke soditur peizazhin e mahnitshëm, poshtë, ku shtrihej Qyteti i Vjetër, lumi dhe në sfond një vijë e hollë blu e detit.

"Ky është njeriu i armatosur që ke parë sot në mëngjes, nën dritën e hënës!" i tha Silva Margaritës.

"A sak, a? E kujtova hasmin e pata frikë për djalin!"

"Tamam, e ke moj motër!" i ktheu Silva. "Dëgjo, tani na i mblidh të gjithë!"

"Çfarë?" u habit Margarita.

"Na i thirr burrat e shtëpisë, se kanë ardhur miq!" përsëriti Silva e vendosur. Të tjerët e shikonin të heshtur.

Ajo hyri brenda dhe nxori një flamur, të cilin e vari në ballkon. Kaluan vetëm pak çaste dhe poshtë në Qytetin e Vjetër u dukën ca hije të zeza. Margarita bëri disa valëvitje, me të cilat lajmëronte rrezikun. Pastaj, u kujtua dhe u kthye nga të pranishmit.

"Nuk besoj, se keni ardhur t'i arrestoni!"

“Jo, moj motër, jo. Duam vetëm të bisedojmë!” foli përsëri Silva.

Burrat mbërritën pas një çerek ore. Më i moshuari në fillim, me mjekër krejt të bardhë, pastaj dy djemtë e tij, xhajat e më të voglit, Jetmirit, që i kishin vrarë babanë. Djaloshi dukej se ishte në moshë të re, por jeta jashtë ia kishte ashpërsuar lëkurën dhe në faqe i ishte rritur një push i verdhë.

“Kanë ardhë miq, o baca Ndue” i foli Margarita vjehrrit.

U takua me të gjithë, pasaj përqafoi djalin.

“Ne jemi të shtetit, unë i policisë, zotërinjtë të ushtrisë, kurse kjo zonja është prokurore”, foli inspektor Iliri. “Jemi të informuar nga organet përkatëse, për hallin që iu ka gjetë dhe kemi ardhë të bisedojmë!”

“Mirë se keni ardhë!” u përgjigj baca. Të tjerët dëgjonin.

“Tani, ne e kuptojmë, ju keni vendosë me u mbrojtë nga e keqja, se një djalë ta kanë vra, ke dy djemtë dhe nipin. Kurse nusen, sipas kanunit, nuk e prek kush. Kështu?” e vazhdoi bisedën Iliri.

“Po, besa. Na kanë vra e na vrasin prap, nuk i dihet kësaj pune! Duhet me qenë gati!”

“Dakord! Po ne jemi shteti dhe kena ardhë me ju thanë që të ktheheni në shtëpi. Ju jeni me fat, se po ju paralajmërojmë më parë, se këto ditë këtu do të vijë ushtria. Besoj ke dëgju, se tani një pjesë e ushtrisë do të rrijë në vend, një pjesë tjetër do të dalë nëpër botë për të vu rregull ku ka nevojë”

“Po, kena marrë vesh, se shumë fëmijë janë liru nga ngujimi dhe kanë shkua në shkollë.”

“Aty më rri bacë. Këtë nipin tënd me e lanë te shtëpia, se është ende i mitur! Ju vetë bani si të

doni! Ushtria do të bëj edhe ajo detyrën e vet! U kuptuem?" i tha Iliri.

"Po, besa! Po ne për nipin kena dalë!"

"Kthejeni nipin në shtëpi dhe lëreni nusen në punë të vet! Nuk është burrnore, me lanë nusen vetëm në shtëpi, duke bà të gjitha punët, nga më të rëndat, si punimi i tokës me traktor, bagëtitë, pulat dhe pastaj buka për ju, të gjithë..."

"A ju ka folë nusja, asht anku?" pyeti plaku.

"Jo, nuk ka qenë nevoja. Na lajmëroi se ju ishit në rrezik, sot në mëngjes. Kishte parë njerëz të armatosur, pastaj përleshje tek Qytetit i Vjetër dhe kërkoi ndihmë. Kaq!"

Baca Ndue i hodhi një vështrim së resë dhe mori miratimin e saj me sy.

"Shtroni rakinë, tani! U baftë më e mira!"

"Zotëria këtu, është këshilltari i Presidentit. Ka ardhë me iu thanë, kthehuni në shtëpi, se do të vijë ushtria t'u mbrojë ju dhe të arrestojë hasmin. Kini besim!" vijoi bisedën inspektor Iliri, ndërsa koloneli pohonte me kokë. "Hidhini armët, sa më shpejt! Do ta marrë në dorë shteti këtë punë, o bacë!"

Baca Ndue tundte kokën jo shumë i bindur. Ndërkohë, tavolina ishte shtruar, me qengjin në mes dhe pjatat shoqëruese rrotull, bashkë me të gjitha takëmet e të ngrënit që shkëlqenin nga pastërtia.

Margarita i thirri disa herë Jetmirit. Ai vazhdonte të luante me kompjuter, që kur kishte ardhur, sikur donte të kompensonte muaj të tërë të një jete të egër.

Vetëm kur zuri vend ai, baca Ndue uroi mirëseardhjen, lëvdoi të madhin zot dhe më pas u dëgjuan vetëm thikat dhe pirunët në veprim. Armët, këtë radhë nuk kishin hyrë në punë.

30

Seancë në Parlament

Silva nuk kishte preferuar të vinte në seancën e parlamentit, që u mblodh menjëherë të hënën. Do të ulej në llozhat ku rrinin zakonisht të ftuarit, siç kishte bërë tani Iliri. Ai e kishte ftuar të merrte pjesë, duke e ditur që ajo kishte një motiv mjaft të vlefshëm për të qenë aty. 'Nuk hipi më në xhipin tënd!' i kishte thënë me shaka. 'Nuk dihet se ku mund të përfundoj këtë radhë!'

Marrëdhënia me Silvën kishte qenë e veçantë, duke kaluar nga një njohje e rastësishme pune, pastaj në një afrim në rrethanat e rrezikut të përbashkët, në një miqësi deri në pragun e dashurisë, të cilën nuk kishin pasur kohë, mbase, ta perceptonin, nga rrokullisja e shpejtë e ngjarjeve, derisa ishte konsoliduar në një lidhje thuajse familjare, çuditërisht. Kur kujtonte tani Silvën, nuk i vinte më në mend femra që e turbullonte, siç mund t'i kishte ndodhur në fillim. Në këtë rrjedhë, kishte ndikuar fort edhe figura e kolonelit, tani e Gegës, por mbi të gjitha serioziteti

i rrethanave në të cilat ishte zhvilluar kjo marrëdhënie.

I ulur i vetëm në llozhën e Parlamentit, për një çast u trishtua nga mendimi se njohja me Silvën, sidoqoftë, ishte frenuar këtu. E dinte, që puna e tij ishte e pamëshirshme ndaj njohjeve të reja. Me t'u mbyllur një çështje, Iliri shkëputej dhunshëm edhe nga njerëzit me të cilët kishte të bënte, në ato rrethana. Nuk ishte krejt shaka thënia e Silvës, se nuk do të hipte më në xhipin e tij. Pati një trishtim të vërtetë tani, kur kujtoi të qeshurën e saj të fundit.

Iliri priste që në sallën e parlamentit të luhej akti i fundit i kësaj historie. Gjithçka ishte përgatitur më parë dhe ishte rënë dakord. Në rendin e ditës, kishte hyrë më në fund aprovimi i FSK-së, Forcës së Sigurisë Kombëtare, që do të ishte një strukturë ushtarake që do të fillonte të vepronte në të gjithë territorin e vendit, menjëherë pas aprovimit në Parlament, për të ofruar siguri për qytetarët, në këmbim të çarmatimit të tyre të plotë dhe kthimit në jetën normale. Java e fundit e kishte treguar se sa e domosdoshme ishte kjo forcë sigurie.

Iliri priste të vinte kolonel Bardhi, të paktën, autor, bashkë me presidentin, i kësaj nisme ligjore. Por, ndërsa deputetët kishin zënë vendet, spikeri i parlamentit hapi seancën, duke paraqitur menjëherë rendin e ditës, askush tjetër nuk po dukej të zinte vend në vendet e të ftuarve.

'E pse të vijë koloneli?' tha me vete Iliri. Kësaj radhe nuk i shkoi në mend vetëm Silva, por edhe Gega, i cili kishte ndenjur si mysafir tek miku i tij i vjetër, këtë fundjavë. Mbase nisej sot drejt Sektorit.

“Me leje!” u dëgjua fort në sallën e Parlamentit një zë që Iliri e njohu, edhe pse e kishte dëgjuar rrallë, më shumë në ndonjë regjistrim seance parlamentare kur kthehej natën vonë në shtëpi.

Po, ishte zëri i deputetit Nosh Gjetani!

Ilirit iu ngritën qimet e kokës përpjetë. Silva kishte dorëzuar në Kuvend një dosje të plotë, që mbështeste një kërkesë të qartë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda për heqjen e imunitetit të deputetit Nosh Gjetani, për të hapur pastaj rrugë hetimeve. Kishin punuar bashkë, të premten dhe të shtunën, të ndihmuar edhe nga disa informacione shtesë me policitë e rajonit, që hidhnin dritë mbi fakte të reja dhe të vjetra trafiqesh në të cilat ishte përfshirë me kohë deputeti. Gjatë konflikteve të armatosura në rajon, një dekadë më parë, ishte marrë me kontrabandën e karburanteve, duke furnizuar makinerinë e luftës në kundërshtim me embargon e vendeve të tjera. Këto fakte, në një masë të madhe, ishin depozituar me kohë, por asnjëherë nuk kishin mundur të mbërrinin deri në Parlament, si tani. Mirëpo, rrethana që e gozhdonte përfundimisht deputetin Gjetani kishte të bënte me ngjarjet e javës së fundit. Dhe nuk ishte fjala për vjeljen e ‘taksës së gjakut’, siç u kishte referuar Prekë Prela, edhe pse ajo nuk përjashtohej si mundësi. Vetë Ministria e Brendshme kishte marrë urdhër të përgjonte telefonatat e deputetit dhe në dosje tani ishin depozituar edhe bisedat e tij me Bim Hykën, urdhrat e dala prej tij për të eliminuar ‘biondin’, pseudoekspertin e sigurisë, i ardhur këtu me emrin Roland Garther, pas një pagese të majme po prej deputetit Gjetani. Në dosje ishte përmendur edhe rrezikshmëria e veprimtarisë së tij politike antikushtetuese, idetë për ‘zonat e lira

nga shteti'. Dosja mbështetëse e kërkesës për heqjen e imunitetit, ishte e plotë.

Ra një heshtje e thellë në sallë. 'Për çfarë mund të fliste tani, deputeti Gjetani?'

Inspektori nuk po u besonte veshëve. Ishte vetë deputeti Gjetani që po paraqiste në Kuvend Ligjin mbi formimin e Forcës së Sigurisë Kombëtare. Bëri një koment hyrës, mbi rëndësinë e kësaj force sigurie, pastaj lexoi fjalë për fjalë preambulën e ligjit.

Ilirin nuk e mbante më vendi. Deshi të braktiste llozhën e të ftuarve menjëherë, por një forcë tjetër e kundërt, shprese, e mbajti të mbërthyer pas karriges.

Ligji u aprovua nen për nen, pa diskutime të gjata, pasi ishte rënë dakord më parë në mbledhjet e grupeve parlamentare.

Iliri po e përjetonte gjithçka si një torturë të vërtetë. Zëri i zvargët i spikerit që lexonte nenet, pastaj një 'aprovohet' e tij që përsëritej, i solli një marrje mendsh. Salla e Kuvendit po i vinte rrotull. U çua dhe zbriti shkallët, ra poshtë drejt e tek bari i Kuvendit, i zbehur në fytyrë. Mori një lëng limoni, e piu ngadalë, me bërrylat e mbështetur në banak. E ndjeu veten më mirë dhe u ngjit përsëri në llozhën e tij.

"Pika e dytë e rendit të ditës" u dëgjua sërish zëri i spikerit. "Na ka ardhur një kërkesë për heqje të imunitetit të deputetit Nosh Gjetani!"

Në sallë filluan pëshpërima, të cilat shpejt u kthyen në zhurma.

"Sekretaret të shpërndajnë materialin e përmbledhur që mbështet kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda!"

Iliri u hodh përpjetë nga emocioni, por askush nuk e vuri re, se në sallë kishte një pështjellim të

vërtetë. Gjithçka ishte mbajtur sekret deri në çastin e fundit.

Nuk duroi dot më, ishte tepër i emocionuar. U ngrit nga karrigia dhe doli jashtë. Nuk kishte përse të rrinte më aty. Tani ishte i sigurtë se gjithçka do të shkonte në drejtimin e duhur. Provat kundër deputetit ishin të pakundërshtueshme!

Iliri doli dhe i telefonoi Silvës, kolonelit Bardhit dhe Gegës.

Në vendparkimin e Kuvendit, ai vuri re edhe dy makina të policisë. E mori me mend që kishin ardhur për të arrestuar deputetin, menjëherë pas heqjes së imunitetit.

31

Befasia e fundit

Gegë Toska mori autobusin e linjës nga kryeqyteti për në Sektor. Po kthehej në shtëpi, pas një jave të jashtëzakonshme të jetës së tij.

Kishte humbur dy fëmijët, Antonin dhe Donikën, por në shtëpi kishte lënë gruan, Lezen. Duhej filluar edhe një herë nga e para. I shkoi mendja edhe tek mësuesi, Çun Matoshi, të cilin e kishte lënë në shtëpi kur ishte larguar.

Që kur zbriti nga autobusi, në sheshin përpara bashkisë, sapo e vinin re, të gjithë ndaleshin dhe e përshëndetnin, dikush me fjalë, dikush thjesht me kokë, duke i uruar mirëseardhjen.

Gegë Toska ishte kthyer. Ky ishte një lajm i mirë për të gjithë ata që jetonin dhe do ta vazhdonin të jetonin në këtë qytezë.

Hyri në rrugën e lagjes së tij. Ndaloi pranë vendit ku i kishin vrarë fëmijët. Një muranë e lartë me gurë dhe lule të freskëta, mbi lule të tjera të thara. Ndenji aty për disa minuta, me sytë mbyllur, pastaj vazhdoi rrugën drejt shtëpisë.

Lezja e kishte marrë vesh se ishte kthyer. Fjala kishte ardhur më parë. E priste aty në prag. E përqafoi pa mundur dot të shkëputej prej tij. Gega e kapi pastaj për dore dhe u futën brenda.

"Je lodhë, Gegë! A ta bëj një kafe?"

"Edhe një gotë raki!" shtoi Gega.

Ishte kohë dreke, nga kuzhina vinte një aromë e mirë gjelle. Gega e kuptoi që kishte uri. 'Do të hamë vetëm ne të dy, pas kaq shumë kohësh! Sa e rëndë!' mendoi. E megjithatë, harroi fare dhe deshi të ngjitej lart, ku rrinin zakonisht fëmijët duke luajtur. Ai shkonte e i thërriste dhe ata nuk shkëputeshin nga loja, derisa shkonte Lezja e i merrte me zor.

"Po Çuni, mësuesi?" u kujtua Gega.

"Hiç, ka mbetur pa punë! I kanë liru të gjithë fëmijët e ngujuem!" u përgjigj Lezja.

"Ta marrim tek dyqani!" u kujtua Gega. "Unë, nga oficer u bana tregtar. Çfarë ka mangut mësuesi, edhe ai mund të bahet!"

"Mirë, të ka shku mendja! Të paktën, ta ndihmojmë sa për fillim, se më vonë mbase gjen punë si mësues. Ku i dihet?" tha Lezja.

Hëngrën dhe pastaj ranë për të fjetur.

U zgjuan nga të trokitura.

Menduan se do të ishte mësuesi. E kishte marrë vesh se ishte kthyer Gega dhe kishte ardhur t'u bënte një vizitë.

Lezja zgjati kokën nga dritarja dhe u kthye nga Gega që vazhdonte të rrinte shtrirë, i dremitur.

"Gegë, çohu shpejt! Nuk është mësuesi! Është policia!"

"Policia? Çfarë kërkon policia këtu?" reagoi Gega shkujdesur.

"Çfarë ke bà, Gegë, një javë larg shtëpisë? Mos ke vra njeri?" e pyeti Lezja e shqetësuar.

“Kërkend nuk kam vrà, mos ki merak! Prit të marrim vesh njëherë, çfarë duan.”

Zbriti Lezja dhe u ngjit shpejt.

“Ty të duan, Gegë. Ti e di vetë, po ke bà gjà mos shko. Dil nga arkapija, mbrapa!”

Gega nuk u përgjigj, por filloi të vishej ngadalë, me atë kostumin shik që kishte blerë në dyqanin e modës në kryeqytet. Lidhi mirë kollaren, u pa dhe në pasqyrë, duke kaluar gishtat tek mjekra. Ishte rruar tek shtëpia e kolonel Bardhit, rreth gjashtë orë më parë dhe nuk dukej keq.

“Mos shko, Gegë!”

“Do të kthehem shpejt! Mos u mërzit!”

Gega i zbriti ngadalë shkallët e drunjta.

Doli në derë dhe u përshëndet me policët. Nuk i kishte parë kurrë më parë.

Ishin dy, e futën në mes, por nuk ia vunë pranga.

Lezja i ndoqi me sy deri tek kthesa. Pastaj ata u zhdukën.

Në polici e ngjitën menjëherë lart në zyrën e Tomë Keqit, zëvendës komandant i postës së policisë së Sektorit që pas vrasjes se Kin Uldedës.

“Mirëserdhe Gegë! Po ta them me plot gojën, se kjo është hera e fundit që të drejtohem në këtë mënyrë!” e nisi bisedën major Toma.

Gega dyshoi se mund t’i kishte punët keq, por nuk i vinte në mend asgjë.

“Ke bërë një aplikim përpara disa vitesh për të punuar në polici” vijoi majori.

“Po, ç’të keqe ka këtu?” ia priti shkurt Gega.

“Asgjë të keqe nuk ka. Vetëm se dua të komunikoj që kërkesa jote është shqyrtuar, pas dymbëdhjetë vjetësh, rrumbullak!”

“Nuk të kuptoj, zoti major!” ndërhyri Gega.

“Më ka ardhur një faks nga Ministria e Brendshme, në të cilin komunikohet se pranohet kërkesa jote për të punuar në radhët e policisë!”

“Kjo është shaka!”

“Ta thashë që në fillim, që sot e tutje nuk mund të drejtohem më me emër. Në faksin e ministrisë thuhet gjithashtu se jeni emëruar komandant i postës së policisë së Sektorit. Mirëserdhe, pra, zoti komandant!”

Gega tani nuk u duk më shumë i befasuar. U ngrit në këmbë dhe i dha dorën majorit dhe i tha:

“Donin të më mbanin në kryeqytet! Më ofruan një post në drejtimin e Forcës së re të Sigurisë Kombëtare, që është aprovuar sot paradite nga Parlamenti. Por, unë nuk mund të shkëputem dot nga Sektori. Hë, për hë, se ushtria e policia kanë rregullat e veta, nuk të pyesin fort.”

Majori i shtrëngoi dorën edhe një herë, pastaj i ra telefonit të oficerit roje duke i dhënë urdhër të grumbullojë gjithë personelin, sepse do të prezantonte komandantin e ri.